

NEWS BOMB.al



**REZULTATET E PRITSHME
NË BASHKITË KU MBAHEN
ZGJEDHJET E PJESSHME
VENDORE. SURPRIZAT
E SHKODRËS, GARA E
LUSHNJES, DHE ÇFARË PO
NDODH NË DURRËS**



**CILI NGA UDHËHEQËSIT
E TIRANËS DO TË
THËRRASË "FITORE", MË
7 MARS. REPORTAZH NGA
SHKODRA E "ZJARRIT":
KUSH DO QEVERISË
"KALANË E ROZAFËS"**



**PENGU I VALENTINA
DUKËS: GABIMI MË I
MADH NË JETË, KUR I
THASHË "PO" LULZIM
BASHËS PËR TË
KANDIDUAR SI DEPUTETE
NË QARKUN KORÇË**

**SONDAZHI
EKSKLUZIV**

KUSH E FITON BETEJËN

6^e MARSIT?!



**GYLENISTËT,
HALLI I MADH
I EDI RAMËS**

**TURQIA NXJERR HARTËN
E "FETO" NË SHQIPËRI.
PSE PËRPLASEN
HOXHALLARË E IMAMË**



**PRINCI QË
NGATËRROI
BALLKANIN**

**ESHTRAT E SHËN
JOAN VLADIMIRIT
DHE GOJËDHËNAT PËR
HISTORINË E SHENJIT**

**FINALJA E "CONFERENCE LEAGUE"
MIJËRA TURISTË NË TIRANË,
MILIONA EURO TË ARDHURA**

ROBERT RADOJA

**RRËFIMI
I KOMPOZITORIT: SI E
SHOH FESTIVALIN**



FESTONI PLOT DASHURI NË SHTËPINË TUAJ TË RE ♥



Shaping life!



SHTËPIA KU DUA TË JETOJ!

DON BOSKO, **TIRANË**



+355 69 20 73 531



SHITJET@MATRIXKONSTRUKSION.COM



WWW.MATRIXKONSTRUKSION.COM



PËR NJË QASJE REALISTE TË MARRËDHËNIEVE SHQIPËRI-TURQI

Është bërë thujtë normë që sa herë ka shkëmbime vizitash të nivelit të lartë mes Shqipërisë dhe Turqisë, rishfaqet në skenë debati rreth peshës të kësaj marrëdhënie, duke u përqendruar më shumë tek emrat e përveçëm dhe lidhja me politikën e ditës, sesa tek dimensionit i marrëdhënies mes shteteve dhe popujve tanë.

Shqipëria dhe Turqia janë vende mike me një histori të ndërlidhur mes tyre dhe raporte njerëzore të gërshtuara. Turqia është një partner strategjik rajonal për Shqipërinë, jo vetëm për shkak të historisë mes dy popujve tanë, por edhe për projektimin e fuqisë që ka Turqia, si anëtare e NATO-s, G-20, në Ballkan e Mesdhe. Është kjo arsyeja që në 2013-ën, Turqinë, e përfshim në listën e partnerëve strategjik në rajon, në programin tonë qeverisës. Asokohe ky vendim shkaktoi jo pak keqkuptime. Por, edhe sot, me gjithë forcën që më lejon të kem njohja e kësaj lënde, mendoj që vendimi ynë ishte i drejtë.

Investimet turke zënë një peshë të konsiderueshme të investimeve të huaja në Shqipëri. Turqia është një prej partnerëve kryesor tregtar, ndonëse deficitit tregtar është i thellë, sa i takon eksporteve tona drejt Turqisë. E vlefshme ka rezultuar edhe asistencat turke për modernizimin e forcave të armatosura dhe rritjen e kapaciteteve të sigurisë gjatë këtyre tre dekadave.

Në veçanti, angazhimi i Turqisë spikat në ditë të vështira për Shqipërinë, si ngjarjet tragjike të 1997-ës; ndihma për përballimin e krizës humanitare si pasojë e luftës në Kosovë, gjatë viteve 1998-1999; ndihma në përballimin e emergjencës dhe pasojave shkatërrimtare të tërmetit të 2019-ës; ndihma shëndetësore gjatë pandemisë COVID-19, sikundër kontributi i çmuar në procesin e rindërtimit, duke i dhënë një vlerë të shtuar miqësisë mes dy popujve tanë.

Nga sa më sipër, mund të thuhet se formalizimi i partneritetit tonë strategjik me Turqinë është akt i vonuar. Mjafton të kujtojmë këtu faktin se Turqia ka krijuar një rrjet bashkëpunimi të thelluar me 27 shtete të ndryshme të botës, në pëputhje me profilin e saj si vend transkontinental. Partneriteti strategjik nuk do të thotë linjëzim vizionesh apo shuarje dallimesh, por nënkupton nevojën për t'u përfshirë në procese më të strukturuar dialogu ku shqyrtohen dhe jetësohen interesat e palëve. Për shembull, ekziston një Këshill i Nivelit të Lartë mes Turqisë dhe Greqisë prej 2010-ës, ndërkohë që diferencat mes këtyre shteteve janë të njohura.

Pavarësisht marrëdhënies strategjike, Shqipëria dhe Turqia nuk janë të linjizuara për të gjitha çështjet në politikën e jashtme dhe të sigurisë. Në jo pak raste në arenën ndërkombëtare, Shqipëria dhe

Turqia kanë ndarë qëndrime të ndryshme. Është i mirënjohur fakti se vendimarrja e Shqipërisë është gjithnjë e linjizuar me atë të BE-së dhe e orientuar prej angazhimeve ndërkombëtare. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për diferencat kulturore mes nesh që përthihen në raportet shtet-fe-komb-ideologji politike. Ndaj, nga njëra anë, na duhet të tregojmë mirënjohje për mbështetjen që na ka dhënë Turqia, por nga ana tjetër, duhet të jemi të kujdesshëm për të mos lejuar transferimin e ndikimit të politikës së brendshme në marrëdhëniet ndërshtetërore.

Kritikët e angazhimit të Turqisë në rajon e vendosin atë gabimisht në të njëjtën shportë me angazhimin e fuqive të huaja, të cilat ndjekin agjendë përçarëse në rajonin tonë. Gjeografikisht, një pjesë e territorit të Turqisë, me ndikim të jashtëzakonshëm politik, është pjesë e Ballkanit. Nuk duhet harruar se Turqia dhe Ballkani ndajnë përvojën e modernizimit, europianizimit, kombit dhe shtetndërtimit, e cila është shoqëruar me paqartësi dhe trauma. Ballkani ka qenë thelbësor për ndërveprimin e Perandorisë Osmane me Perëndimin dhe përpjekjet për modernizim. Pas krijimit të shteteve komb në Ballkan që shoqëruan rënien e Perandorisë Osmane, Turqia vijoi angazhimin dypalësh dhe shumëpalësh në rajon, pavarësisht dallgëve të geopolitikës.

Si anëtare e NATO-s, kandidate për anëtarësim në BE dhe mbi të gjitha palë e Bashkimit Doganor me BE-në, Turqia e sheh me interes anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në

BE, edhe si mundësi për zgjerim tregesh. Rumania, Bullgaria dhe Greqia, tre vende anëtare të BE-së dhe pjesë e Ballkanit, e kanë Turqinë një nga importuesit kryesor.

Marrëdhëniet e komplikuar me Perëndimin, ngrirja e procesit të anëtarësimit në BE dhe zhvillimet dramatike rreth e qark Turqisë, në mënyrë të natyrshme kanë rrizguar impulset perandorake të kësaj të fundit. Rastësi ose jo, ngrirja e procesit të europianizimit të Turqisë tanimë përkon edhe me ngrirjen e procesit të europianizimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Pavarësisht nga efekti i tendencave të mësipërme mbi Turqinë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, ndërveprimi institucional, marrëdhëniet politike dhe shkëmbimet ekonomike me BE-në mbeten të forta. Kjo krijon hapësirë për një ndërveprim më të madh mes BE-së dhe Turqisë edhe në rajonin tonë, duke e konsideruar rolin e saj përplotësues me atë të BE-së.

Vështruar në këtë kontekst, marrëdhëniet tona dypalëshe duhet t'i shohim të çliuar nga emocionet e politikës së ditës, pasi kjo marrëdhënie shëndoshet më tej nëse mbështetet në interesin dhe ekzistencat e ndërsjellta, duke konsoliduar përkatësisë tonë europiane dhe laicitetin, si ADN-ja e kombit tonë.



Nga DITMIR BUSHATI



Valentina Duka: GABIMI MË I MADH NË JETË KUR I THASHE "PO" LULZIM BASHES

Nga ANTA MUÇAKU

16

24 GYLENISTËT, HALLI I MADH I EDI RAMËS

Nga Newsbomb.al

28 IMAMË E HOXHALLARË SI JANË NDARË GYLENISTËT DHE ERDOGANISTËT NË SHQIPËRI

Nga NIKOLETA KOVAÇI

34 KOSOVË-SHQIPËRI TREGTI E PENGUAR, INVESTIME TË BLOKUARA

Nga FATOS ÇOÇOLI

38 NAFTA VETËM "NGRIHET", NUK "NGRIN"

Nga FATOS ÇOÇOLI



42

SKËNDERBEU

KALORËSI FISNIK I KRISHTERË,
"PUSHTOI" EVROPËN ME BËMAT E TIJ

Nga DR. DORIAN KOÇI





SONDAZHI I NEWSBOMB: SI NDAHEN VOTAT NË SHKODËR, DURRËS DHE LUSHNJË

ME PËRKUFIZIM, SONDAZHET
S'JANË INSTRUMENTE PRECISE

Nga EDUARD ZALOSHNIJA

08



BETEJA E SHKODRËS KUSH DO TA MARRË ROZAFËN MË 6 MARS ?

Nga NEWSBOMB.AL

13



48

PRINCI QË NGATËRROI BALLKANIN

Nga LUELA MYFTARI

58 KONTRABANDA E AR-IT SI DOLËN JASHTË VENDIT NAPOLONAT E FLORIRIT

Nga NGA ERGYS ALUSHI /VLORË

64 ROBERT RADOJA, SOT DHE DJE!

Nga SUADA DACI

68 PREKJE/ GRUAJA HYJNORE ME NGJYRA SI YJËSI QË VIBRON

70 NJË NDESHJE PËR KORNIZË 30 MIJË TIPOZË QINDRA SPONSOR, MILIONA SY NGA "AIR ALBANIA"

Nga RETIN TOKA

74 SHKURT E SAKTË

Nga SUADA DACI

76 QUIZ BOMB

Nga KADRI VOKOPOLA

NEWSBOMB.al

SHKURT
2022



ABONOHU!

POSTA SHQIPTARE:

+355 68 50 80 753

Redaksia Newsbombal:

+355 69 67 32 020

abonime@newsbomb.al

ADRESA:

Rruga: "Emin Duraku",
Hyrja 1, Apartamenti 14, Tiranë

Mobile: +355 69 922 2201 | +355 69 922 2202

E-mail: info@newsbomb.al

NEWSBOMB SHPK
NIPT: L42417011Q



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ANILA BASHA

BASHKËPUNUAN

DITMIR BUSHATI

EDUARD ZALOSHINJA

FATOS ÇOÇOLI

ANTA MUÇAKU

LUELA MYFTARI

NIKOLETA KOVAÇI

DORIAN KOÇI

ERGYS ALUSHI

RETIN TOKA

LINDA GURI

SUADA DACI

KADRI VOKOPOLA

GRAPHIC DESIGN

ALTIN ALIAJ



**SHPALLET KOMPANIA MË BESNIKE
E KONSUMATORIT SHQIPTAR
2022**

Me një traditë 30 vjeçare në prodhimin dhe përpunimin e qumështit dhe nënprodukteve të tij, Erzeni, është kurorëzuar me çmimin "Kompania më besnike ndaj konsumatorit në Shqipëri."

Çmimi iu dorëzua drejtorit ekzekutiv, Erzen Begaj, gjatë mbrëmjes gala të ÇIT Aëards, e organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë me mbështetjen e Bashkisë së Tiranës. Ky event i rëndësishëm, që u mbajt me rastin e 125 vjetorit të Dhomës së Tregtisë mbledhi personalitete të njohur në fushën e prodhimit, infrastrukturës, teknologjisë, financës, farmaceutikës, ndërtimit, prodhimit vendas nga Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova.

"Jemi krenarë për këtë çmim pasi është fryt i 30 viteve punë intensive, e bërë me përkushtim, dashuri dhe respekt për konsumatorin", - tha Begaj, gjatë fjalimit të tij. Erzeni, është kompania e parë në Shqipëri e prodhimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar në treg. Investimet e saj në ruajtjen e cilësisë së produkteve të freskëta, pa bërë kompromise, arrijnë deri në 20 milionë euro. Megjithatë, investimet shkojnë krah më krah me fermerët me të cilët Erzeni bashkëpunon çdo ditë, për të sjellë në tryezën e konsumatorit, produkte të freskëta e cilësore.

"Fermerët shqiptarë, me shumë mund dhe përkushtim, arrijnë të plotësojnë nevojat për qumësht të freskët, në mënyrë që konsumatorët të përfitojnë produkte sa më cilësore dhe të sigurta", - shtoi Begaj, duke shprehur mirënjohje për bashkëpunëtorët nga 50 fshatra të Shqipërisë, të cilët çdo ditë, sjellin në fabrikë qumësht të cilësisë së parë.

TRADITA E FAMILJES, NJË HISTORI SUKSESE

Pasioni i kompanisë Erzeni për bulmetin ka nisur që nga viti 1992. Asokohe, familja Begaj ishte e njohur në komunitetin e Sematicës, Fier, si besnike ndaj cilësisë pa kompromis. Fjala mori dhenë dhe kërkesa u rrit. Në një treg kaotik sa i përket cilësisë, kërkesa e lartë për produktet Erzeni nxiti një seri investimesh të mëdha, falë të cilave, kompania arriti të mirëpritet në çdo familje shqiptare. Edhe sot e kësaj dite, i gjithë procesi i prodhimit të një produkti Erzeni deri tek mbërritja në dyqane, kryhet jo më vonë se 24 orë nga tërheqja e qumështit nga fermerët. Qumështi i nënshtrohet plot 20 analizave fiziko-kimike, toksikologjike dhe mikrobiologjike, që garantojnë cilësinë maksimale, me dëshirën e vetme që çdo konsumator shqiptar të ushqehet mirë dhe i sigurtë. Kjo, për kompaninë Erzeni, është fitorja më e madhe.



SI DO TË VOTONIN DURRSAKËT
E VENDOSUR TRE JAVË PARA 6 MARSIT
(Maksimumi i gabimit statistikor +/-3.5%)

KANDIDATEN
E RAMËS

49.7%

KANDIDATIN E
BËRISHËS-LSI ETJ

26.5%

KANDIDATIN
E BASHËS

23.8%

NË SHKODËR KRYESON KANDIDATI
I SHTËPISË SË LIRISË

NË BASHKITË E TJERA KRYESOJNË
KANDIDATËT E PS-së

KANDIDATËT E PD-së ZYRTARE TË TRETËT,
POR AFËR VENDEVE TË DYTA
(përveç Shkodrës, ku janë larg)



Newsbomb angazhoi sondazhistin e mirënjohur Eduard Zalosnjaja, për të zhvilluar një sondazh rreth zgjedhjeve të pjesshme të bashkive Durrës, Shkodër, Lushnjë, Dibër, Vorë, e Rrogozhinë. Sondazhi u krye më 12 shkurt, duke shpërndarë në këto bashki 2700 SMS të rastësishme, në përpjestim me numrin e banorëve të tyre (shkalla përfaqësimit statistikor: 1 SMS për çdo 133 banorë të rritur). Nga 2700 banorët e rastësishëm të këtyre bashkive që morën SMS, ishin të vendosur të votonin 1895 prej tyre.

Pyetja kryesore në sondazh ishte "Për cilin kandidat do të votonit, nëse zgjedhjet në bashkinë tuaj do të zhvilloheshin sot?" Gjithashtu, të anketuarit u pyetën për gjininë, moshën, vendbanimin (urban-rural), bashkinë ku banonin dhe për votën e tyre të 25 prillit 2021. Në këtë mënyrë, u krijua mundësia për të kontrolluar nëse kampioni statistikor ishte i balancuar gjeografikisht, demografikisht dhe politikisht. Në fakt, kampioni rezultoi disi i zbalancuar, dhe për këtë arsye, u ripeshua statistikisht, për ta përfaqësuar sa më mirë elektoratin e këtyre bashkive.

BASHKIA DURRËS

Meqënëse 775 të anketuar durrsakë rezultuan të vendosur të votonin ditën e sondazhit, u bë e mundur që të llogaritej statistikisht shpërndarja e votave mes kandidatëve në Durrës, me maksimum marzhi të gabimit statistikor plus/minus 3.5%. Duke ndjekur procedurat statistikore të përshkruara më sipër, rezultoi se kandidatja e Ramës do të kishte marrë 49.7%

SONDAZH I

NEWSBOMB:


SI NDAHEN
VOTAT

NË SHKODËR
DURRËS
DHE LUSHNJË

GRAFIKU 2:


SI DO TË VOTONIN SHKODRANËT E VENDOSUR TRE JAVË PARA 6 MARSIT
(Maksimumi i gabimit statistikor +/-4.6%)

Shkodra


GRAFIKU 4:

SI DO TË VOTOHEJ TRE JAVË PARA 6 MARSIT
Maksimumi i gabimit statistikor +/-2.8%

(Pesë bashki së bashku, pa Shkodrën)




të votave, i Berishës+LSI etj. 26.5%, dhe i Bashës 23.8% (**shihni Grafikon 1**).

Nga ekstrapolimi i përafërt i përgjigjeve të të anketuarve (të ndarë sipas gjinisë, moshës, e votimit të vjetshëm), rezultoi që nëse zgjedhjet do të ishin zhvilluar ditën e sondazhit, do të votonin rreth 67% e zgjedhësve që aktualisht banojnë në këtë bashki, ose rreth 94 mijë banorë të rritur të Bashkisë Durrës. Ndryshe, mund të thuhet se rreth 36% e zgjedhësve në lista do të kishin votuar ditën e sondazhit. (Shënim: rreth 47% e

GRAFIKU 3:

SI DO TË VOTONIN LUSHNJARËT E VENDOSUR TRE JAVË PARA 6 MARSIT
(Maksimumi i gabimit statistikor +/-5.3%)

Lushnja



zgjedhësve të tjerë të listës janë në emigracion.) Siç shihet në Tabelën 1, numri i pjesëmarrësve do të kishte qenë rreth 15 mijë më i ulët se sa në 25 prillin e vjetshëm.

BASHKIA SHKODËR

Meqënëse 461 të anketuar shkodranë rezultuan të vendosur të votonin ditën e sondazhit, u bë e mundur që të llogaritej statistikisht shpërndarja e votave mes kandidatëve në Shkodër, me maksimum marzhi të gabimit statistikor plus/minus 4.6%. Duke ndjekur procedurat statistikore të përshkruara më sipër, rezultoi se kandidati i Berishës+LSI etj. do të kishte marrë 46.5% të votave, e Ramës 39%, dhe i Bashës 14.5% (**shihni Grafikon 2**).

Nga ekstrapolimi i përafërt i përgjigjeve të të anketuarve (të ndarë sipas gjinisë, moshës, e votimit të vjetshëm), rezultoi që nëse zgjedhjet do të ishin zhvilluar ditën e sondazhit, do të votonin rreth 71% e zgjedhësve që aktualisht banojnë në këtë bashki, ose rreth 62 mijë banorë të rritur të Bashkisë Shkodër. Ndryshe, mund të thuhet se rreth 37% e zgjedhësve në lista do të kishin votuar ditën e sondazhit. (Shënim: rreth 49% e zgjedhësve të tjerë të listës janë në emigracion.) Siç shihet në Tabelën 2, numri i pjesëmarrësve do të kishte qenë rreth 7 mijë më i ulët se sa në 25 prillin e vjetshëm.

BASHKIA LUSHNJE

Meqënëse 340 të anketuar lushnjarë rezultuan të vendosur të votonin ditën e sondazhit, u bë e mundur që të llogaritej statistikisht shpërndarja e votave mes kandidatëve në Lushnje, me maksimum marzhi të gabimit statistikor plus/minus 5.3%. Duke ndjekur procedurat statistikore të përshkruara më sipër, rezultoi se kandidatja e Ramës do të kishte marrë 53.8% të votave, i Berishës+LSI etj. 24.7%, dhe i Bashës 21.5% (**shihni Grafikon 3**).

Nga ekstrapolimi i përafërt i përgjigjeve të të anketuarve (të ndarë sipas gjinisë, moshës, e votimit të vjetshëm), rezultoi që nëse zgjedhjet

TABELA 1. VOTAT E SOTME TË ATYRE QË MË 25 PRILL VOTUAN PËR PS+PSD VS. PËR PARTITË OPOZITARE
(EKSTRAPOLIM I PËRAFËRT I VOTAVE NË BASHKINË DURRËS)

Kandidatët	Sot	Votat më 25 prill të partive mbështetëse*	Firoja
Kandidatin e Berishës-LSI etj.	24,800	53,100	-6,000
Kandidatin e Bashës	22,300		
Kandidaten e Ramës	46,500	55,400	-8,900
Total	93,600	108,500	-14,900

*Votat që u plotësuan gabim më 25 prill u janë shtuar votave të vlefshme të partive, duke presupozuar shpërndarje gabimi proporcional të fletëve të pavlefshme.

NEWS
BOMB

POLITIKË

do të ishin zhvilluar ditën e sondazhit, do të votonin rreth 71% e zgjedhësve që aktualisht banojnë në këtë bashki, ose rreth 43 mijë banorë të rritur të Bashkisë Lushnje. Ndryshe, mund të thuhet se rreth 41% e zgjedhësve në lista do të kishin votuar ditën e sondazhit. (Shënim: rreth 42% e zgjedhësve të tjerë të listës janë në emigracion.) Siç shihet në Tabelën 3, numri i pjesëmarrësve do të kishte qenë rreth 5 mijë më i ulët se sa në 25 prillin e vjetshëm.

SI VOTOJNË GRUPMOSHA TË NDRYSHME NË GJASHTË BASHKITË SË BASHKU

Ndër të anketuarit tashmë të vendosur për të votuar, përkrahësit e kandidatëve të Bashës kishin moshën mesatare më të ulët.

Përkrahësit e kandidatëve të Ramës e të Berishës+LSI etj. dominonin tek grupmosha 50-64 vjeç, dhe sidomos tek grupmosha 65 vjeç e sipër. Ndërsa përkrahësit e kandidatëve të Bashës dominonin tek grupmosha 35-49 vjeç (**Shihni Tabelën 4**)

SI VOTOHET NË PESË BASHKITË PËRVEÇ SHKODRËS

Meqënëse Shkodra nuk është bashki tipike nga pikëpamja e përçarjes brenda opozitës, është interesante të shihet sesi votojnë banorët e pesë bashkive të tjera (të marra së bashku). Në këtë mënyrë, mund të bëhet një përafrim domethënës statistikisht mes situatës së fraksioneve brenda opozitës në këto pesë bashki dhe asaj të të gjithë vendit në përgjithësi. Grafiku 4 jep tablonë e shpërndarjes së votave në pesë bashkitë së bashku, përveç Shkodrës.

TABELA 4. SHPËRNDARJA MOSHORE E VOTUESVE TË VENDOSUR TË SECILËS PALË NË GJASHTË BASHKITË SË BASHKU

	18-34	35-49	50-64	65+	Total
Kandidatin e Berishës-LSI etj.	29%	22%	27%	22%	100%
Kandidatin e Bashës	30%	32%	23%	15%	100%
Kandidaten e Ramës	30%	21%	27%	22%	100%
Banorët e 6 bashkive	33%	23%	25%	19%	100%

TABELA 2. VOTAT E SOTME TË ATYRE QË MË 25 PRILL VOTUAN PËR PS+PSD VS. PËR PARTITË OPOZITARE (EKSTRAPOIM I PËRAFËRT I VOTAVE NË BASHKINË SHKODËR)

Kandidatët	Sot	Votat më 25 prill të partive mbështetëse*	Firoja
Kandidatin e Berishës-LSI etj.	28,600	41,300	-3,800
Kandidatin e Bashës	8,900		
Kandidaten e Ramës	24,000	26,950	-2,950
Total	61,500	68,250	-6,750

*Votat që u plotësuan gabim më 25 prill u janë shtuar votave të vlefshme të partive, duke presupozuar shpërndarje gabimi proporcional të fletëve të pavlefshme.

TABELA 3. VOTAT E SOTME TË ATYRE QË MË 25 PRILL VOTUAN PËR PS+PSD VS. PËR PARTITË OPOZITARE (EKSTRAPOIM I PËRAFËRT I VOTAVE NË BASHKINË LUSHNJË)

Kandidatët	Sot	Votat më 25 prill të partive mbështetëse*	Firoja
Kandidatin e Berishës-LSI etj.	10,700	21,550	-1,550
Kandidatin e Bashës	9,300		
Kandidaten e Ramës	23,200	26,300	-3,100
Total	43,200	47,850	-4,650

*Votat që u plotësuan gabim më 25 prill u janë shtuar votave të vlefshme të partive, duke presupozuar shpërndarje gabimi proporcional të fletëve të pavlefshme.

SQARIM STATISTIKOR

Intervali i marzhit të gabimit statistikor të rezultateve në përqindje është në vartësi të madhësisë së kampionit statistikor, popullsisë së sonduar, dhe distancës së rezultatit nga pika e mesit (50%). Sa më i madh të jetë kampioni statistikor dhe sa më e vogël popullsia e sonduar, aq më i vogël është intervali i gabimit statistikor. Në të njëjtën mënyrë, sa më larg pikës së mesit (50%) të jetë një rezultat në përqindje, aq më i vogël është intervali i gabimit statistikor.

Kështu për shembull, në kampionin statistikor të pesë bashkive së bashku (pa Shkodrën), kandidatët e Ramës rezultojnë me 50.9% të votave dhe me marzh gabimi statistikor +/-2.8%. Ndërsa kandidatët e Bashës rezultojnë me 22% të votave dhe me marzh gabimi statistikor +/-1.6% (interval i gabimit statistikor është më i vogël, ngaqë rezultati i kandidatëve të Bashës është larg mesit 50-përqindësh).

Nga ana tjetër, në kampionin statistikor të Bashkisë Durrës, kandidatët e Ramës rezultojnë me 49.7% të votave dhe me marzh gabimi statistikor +/-3.5%. Rezultati i kandidatës së Ramës përsëri është pranë mesit 50-përqindësh, por intervali i gabimit statistikor është më i madh se sa më sipër, ngaqë kampioni i Durrësit është më i vogël se sa i pesë bashkive së bashku.



VOTIMI NË 5 BASHKI (PA PËRFSHIRË SHKODRËN): MOSTËR STATISTIKORE IDEALE PËR TË PËRFAQËSUAR GJITHË ELEKTORATIN SHQIPTAR

Sondazhet e opinionit bëhen zakonisht me 1000-2000 të anketuar, të përzgjedhur në mënyrë të tillë që ta përfaqësojnë sa më mirë popullsinë (brenda një marzhi gabimi statistikor). Kjo vlen si për një vend me 330 milionë banorë, si SHBA, edhe për një vend me 2.8 milionë banorë, si Shqipëria – sondazhet bazohen në të njëjtat ligje të teorisë së probabilitetit.

Në zgjedhjet e pjesshme të 6 marsit në Shqipëri, në pesë bashki (pa përfshirë Shkodrën) do të thirren për votim rreth 275 mijë banorë të rritur. Është mostra më e madhe statistikore që mund të ëndërrojë çdo sondazhist! Por a e përfaqëson statistika kjo mostër të gjithë elektoratin shqiptar?

Nga pikëpamja demografike, këta 275 mijë banorët e rritur përbëjnë një pasqyrë pothuaj perfekte të elektoratit shqiptar. Raporti i meshkuj-femra është praktikisht identik me të të gjithë popullsisë. Raporti mes grup-moshave është praktikisht identik me të të gjithë popullsisë. Raporti i urban-rural është pothuaj identik me të të gjithë popullsisë.

Nga pikëpamja gjeografike, kemi një bashki veriore, dy të Shqipërisë së Mesme, një gjysëm jugore, dhe një jugore. Për më tepër, Durrësi e Vora janë bashki me shumë banorë të shpërngulur nga të gjitha krahinat e vendit.

Nga pikëpamja politike, në pesë bashkitë të marra së bashku, ndarja e përqindjeve të votave të 25 prillit të vjetshëm mes dy kampeve (PS+PSD vs. Partitë e tjera) ishte praktikisht identike me atë kombëtare.

TABELA 5. NDARJA E VOTAVE MË 25 PRILL 2021

Bashkitë	PS+PSD	Partitë e tjera
Durrës	50.6%	49.4%
Shkodër	43.4%	56.6%
Lushnje	54.2%	45.8%
Dibër	41.4%	58.6%
Vorë	56.3%	43.7%
Rrogozhinë	54.8%	45.2%

SI U NDANË NË PËRQINDJE VOTAT E 25 PRILLIT TË VJETSHËM NË SECILËN NG BASHKITË E 6 MARSIT

Në katër nga bashkitë e 6 marsit (Durrës, Lushnje, Vorë e Rrogozhinë), partitë e mazhorancës patën epërsi në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit. Në dy të tjerat (Shkodër e Dibër), ato ishin ndjeshëm poshtë 50-përqindëshit (*shihni Tabelën 5*).



POLITIKË

ME PËRKUFIZIM, SONDAZHET S'JANË INSTRUMENTE PRECISE

I Nga EDUARD ZALOSHNIJA

Këto javë priten të publikohen disa sondazhe rreth zgjedhjeve të pjesshme të 6 marsit. Si zakonisht, pritet të bëhen shumë komente e citime të rezultateve të këtyre sondazheve.

Dhe si zakonisht, në komentet e citimet, me gjasa, do të harrohet një detaj shumë i rëndësishëm i sondazheve, marzhi i gabimit statistikor të tyre. Duke harruar kështu se, me përkufizim, sondazhet s'janë instrumente precise, çdo sondazh ka një marzh të gabimit statistikor.

Kur diskutohet në media apo nëpër kafene se, bazuar në filan sondazh, kandidati fistek ka sot X% të votave, rrallë përmendet që marzhi i gabimit statistikor të kësaj përqindjeje është plus/minus Y%. Dhe jo në pak raste, diferenca mes kandidatit fistek dhe konkurentit të tij mund të jetë brenda intervalit të gabimit statistikor, pra nuk mund të thuhet me siguri se cili është realisht në epërsi ndaj tjetrit...

POR PËRSE SONDAZHET KANË MARZH GABIMI STATISTIKOR?

Përgjigjia mund të gjehet tek Ligji i Numrave të Mëdhenj, nga më të rëndësishmit e teorisë së probabilitetit. Dikush mund të hedhë 100 monedha të njëjta e t'i bien 44% kokë, ose (në ekstremin tjetër) 56% kokë. Po ta përsërisë ky dikush këtë eksperiment me 1 mijë monedha, intervali i rënies kokë pothuaj me siguri do të jetë nga 47% deri në 53%; goxha më afër probabilitetit real 50%. Ndërsa po të hedhë 100 mijë monedha, intervali i rënies kokë do të jetë shumë, shumë më i ngushtë: 49.9% deri në 50.1%.

Me fjalë të tjera (duke u kthyer tek sondazhet), sa më shumë të anketuar të rastësishëm të përfshihen në kampionin statistikor të një sondazhi, aq më shumë i afrohe-mi përqindjes reale të përkrahjes ndaj një kandidati. Por kostoja e anketimit të 100 mijë qytetarëve të rastësishëm është tejet e lartë. Prandaj sondazhistët mjaftohen me kampione relativisht të vogla, që zakonisht prodhojnë marzhe gabimi statistikore plus/minus 3%.

Dhe kur përqindjet e dy kandidatëve kanë një diferencë që përfshihet brenda

E PAZAKONTË

BASHA NUK PREZANTON ASNJË KANDIDAT

Nuk ndodh shpesh që kryetari i partisë në opozitë, të mos prezantojë vetë kandidatët për kryetar bashkie, qoftë edhe në zgjedhje të pjesshme vendore. Çdo sfidë elektorale meriton të vlerësohet, mbi të mund të ndërtohet një fabul dhe mesazh. Por për këtë garë elektorale të 6 marsit, është vënë re që Lulzim Basha, nuk ka prezantuar asnjërin prej pretendetëve të tij, për Shkodrën, Durrësin, Lushnjën, Rrogozhinën, Vorën dhe Dibrën. Si rregull, kreu i partisë, i shton pikë kandidatit kur shfaqet atje, e prezanton, promovon dhe fton qytetarët ta votojnë. Kjo nuk ka ndodhur me Bashën. Ideja që krijohet është se ndoshta ai pret rezultat jo të mirë, pas krisjes që ka ndodhur mes demokratëve, dhe kërkon që 6 marsi të duket si një ngjarje jo e rëndësishme. Me profil të ulët. Mirëpo, ndryshe ka ndodhur më parë. Mjafton të kujtojmë zgjedhjet e parakohshme vendore të Dibrës në vitin 2016, në një bashki vetëm, kur Basha u instalua në Peshkopi me gjithë stafin e tij për një muaj me radhë. Ç'ka do të thotë se qoftë edhe një njësi e vogël elektorale vlen politikisht në çdo kohë. Kësaj radhe, kemi vëmë re se kandidatët e PD zyrtarë janë paraqitur në publik nga nënkryetarët dhe Sekretari i Përgjithshëm. A është kjo një shenjë e një disfatë të pritshme për Bashën? Nuk dihet se si mund të shkojnë gjërat në kohën e mbetur, por deri më tani, siç tregon edhe sondazhi i Newsbomb, shifrat flasin më mirë për liderin historik, dhe lëvizjen e tij.

intervalit të gabimit statistikor të sondazhit, thjesht mund të thuhet se ata janë statistikisht rrotë-më-rrotë. Sepse mund të qëllojë që në një garë dyshe, një sondazhisti t'i rezultojë kandidati filan me 47% (me marzh gabimi +/- 3%) dhe kandidati fistek me 53% (me marzh gabimi +/- 3%), ndërsa një sondazhisti tjetër (në të njëjtën kohë e me të njëjtën metodologji) mund t'i rezultojë bash e anasjelltë. Në një rast të tillë, as njëri e as tjetri s'janë gabim. Si në rastin e hedhjes së 1000 monedhave, dy kandidatët thjesht mund të jenë në një garë të barabartë 50% me 50%...

PO PËRSE ATËHERË VLEN TË BËHEN SONDAZHE PARAZGJEDHORE?

Në qoftë se në një garë dyshe, kandidati filan rezulton me 55% (me marzh gabimi +/- 3%) dhe kandidati fistek rezulton me 45% (me marzh gabimi +/- 3%), mund të thuhet me siguri statistikore se filani ka epërsi ndaj fistekut. Në rastin më të keq për filanin, ai ka përkrahje 52% (55% minus 3%), ndërsa konkurenti vetëm 48%.



BETEJA E SHKODRËS

KUSH DO TA MARRË ROZAFËN MË

6 MARS?

| Nga NEWSBOMB.AL

Kur i afroresh Shkodrës, nisin e shquhen totemet për të cilat banorët e qytetit kanë krenari e mburrje, një pjesë jo e pakët edhe pa shkak. Ja ku vjen e plotë kalaja Rozafa. Një kështjellë që ka në gurët e saj shumë shenja rezistence. E fundit që ra në duart e otomanëve, e fundit që iu nënshtrua ko-

Beteja për qendrën më të madhe të Veriut, është më e zjarrita e 6 marsit. Sepse aty janë kreditet e udhëheqësve të Tiranës. Pse ky qytet është kaq i rëndësishëm për Edi Ramën, Sali Berishën, dhe Lulzim Bashën në këto zgjedhje të pjesshme vendore...



munistëve, e vetmja që nuk u mor dot nga socialistët dhe nga rilindasit.

Me 6 mars, vendoset fati i një beteje të pahasur më parë në qytet, për ta fituar qendrën më të rëndësishme të Veriut. Kësaj radhe, pretenduesit janë më shumë se zakonisht.

Është sërish Edi Rama që tenton mullë të ndaluar. Më anë tjetër, janë dy palët demokratike. Ata të Lulzim Bashës dhe Sali Berishës mes të cilëve do të bëhet lufta e përgjakshme politike, për të treguar se kujt do t'i flasë bastioni. Kujt do t'i thotë "njatjeta", dega dhe qyteti më i rëndësishëm për PD-në.

Kë do të njohë djepi i demokratëve si të parë. Kreun e PD, apo ish-kreun që synon ta largojë drejtuesin, të cilin në fakt as nuk e njeh, e konsideron të shkarkuar me 18 dhjetor, dhe e stigmatizon si Lul Brava i marrë peng nga Rama.

Zgjedhjet e pjesshme vendore të javës së parë të marsit, do të zhvillohen në 6 bashki. E Shkodrës, është gara që ka jo vetëm vëmendjen më të madhe publike, por duket se edhe investimin maksimal të liderëve.

Është e qartë se këto nuk janë aspak zgjedhje vendore. Pasiqë kushdo që të vijë në krye, bëhet fjalë për një mandat 300 ditësh, derisa të vijë vota e përgjithshme e 2023 për gjithë bashkitë e vendit. Këto janë zgjedhje politike për kreditet e bosëve në Tiranë.

Kush merr Shkodrën, duket se do të quhet fituesi i kësaj përplasje, aspak të zakonshme, në një mot të acartë partiak.

SPAHIA

**MJEKU
QË TENTON
BASHKINË**



Bardh Spahia është një personalitet i rritur në PD mund të thuhet. Që i ri i angazhuar me forumin, më tej ka patur detyra të rëndësishme në Tiranë si zv-ministër shëndetësie, dhe po ashtu deputet në legjislaturën e vitit 2017. Pikat e forta janë grinta që paraqet dhe ambicia e fortë politike. Spahia ka ruajtur kontaktet me strukturat e PD, e sidomos me të rinjtë. Ai ka dhe trashëgiminë e mirë që ka lënë i ati, Ali Spahia, mjaft i njohur në Shkodër. Spahia është mjek në profesion. Në këto zgjedhje, Bardh Spahia është propozuar nga grupi i rithemelimit të PD-së dhe garon nën siglën e koalicionit "Shtëpia e Lirisë". Dhe nuk është e pakuptimtë, në të gjitha zgjedhjet e fundit, edhe në parti, Bardh Spahia, njeriu i kontributeve të mëdha në dekadën e fundit në PD, u la në harresë nga kryetari i PD, Lulzim Basha.

BUSHATI

**BIZNESMENI
ME
REPUTACION
TË MIRË**



Xhemal Bushati gëzon po ashtu një reputacion të mirë në qytet. Ai ka qenë një lojtar lokal, por aktiv. Vjen nga një derë e madhe e qytetit dhe në përgjithësi është marrë me biznes, por nga viti 2007 ka qenë edhe pjesë e pushtetit vendor, një herë si këshilltar, e më tej si kryetar i Këshillit Bashkiak. Me profesion ekonomist, Bushati duket se do të përqendrohet tek njohjet personale, më shumë se sa tek një fushatë e zjarrtë. Një pikë e dobët për të, është se strukturat e PD në Shkodër janë dëmtuar rëndë, pasi Berisha nisi foltoren, duke kaluar pjesa më e madhe me liderin historik. Xhemal Bushati është përzgjedhja e Lulzim Bashës për të marrë bashkinë e Shkodrës por që ka edhe dy pika të forta kundër: Largimin nga drejtimi i qarkut të deputetit Helidon Bushati dhe emërimin në vend të tij të Enkelejd Alibeajt, si dhe votën kundër të kryebashkiakes së deritanishme Voltana Ademi.

ANGONI

**VAJZA E
JUBANËVE
DHE MASKAVE
VENECIANE**



Majlinda Angoni, vjen nga një familje e njohur në Shkodër, që janë Jubanët. Ajo është një e majtë në orientim politik, por nuk ka qenë pjesë e strukturave të PS, derisa Rama e emëroi Prefekte. Para kësaj detyre, ka qenë aktiviste në shoqërinë civile. Ekonomiste me profesion, ka spikatur në sipërmarrjen për maskat veneciane. Angoni ka në favor mbështetjen e madhe shtetërore, dhe shpreson se përçarja e demokratëve do të bëjë të mundur që ndoshta për herë të parë që nga ardhja e pluralizmit, zgjedhjet në Shkodër t'i fitojë e majta. Madje, edhe pse mendon se nuk është një sfidë e thjeshtë, do të shfrytëzojë mbiemrin e saj të vajzërisë dhe impenjimin e strukturave të qeverisë për të fituar për herë të parë një bashki si Shkodra, që duhet thënë se nuk është qeverisur ndonjëherë nga e majta.

ATMOSFERA

Deri nga mesi i Shkurtit, asnjë shenjë në qytet nuk tregonte se ka zgjedhje. Sot temperatura elektorale është rritur, dhe sigurisht për këtë kanë ndikuar edhe udhëheqësit e mbërritur nga Tirana, sidomos Sali Berisha.

Vetëm një ditë më parë, me 19 shkurt, është çelur zyrtarisht fushata dhe kanë nisur të mbi-jnë posterat e kandidatëve nëpër pikat kyçe të rrugëve kryesore. Por asnjëherë më parë, afatet dhe datat e KQZ nuk i kanë penguar kandidatët të bëjnë fushatë. Nuk i kanë ndaluar sheshet dhe kthinat të ziejnë.

Deri më tani, mëtuesit kanë kryer takime të ngushta, dhe janë shfaqur më së shumti në faqet e tyre në rrjetet sociale.

"Një fushatë shumë e vakët, njerëzit janë totalisht indiferentë. Nuk kam parë ndonjë herë më parë si kjo. Ngjan pak me atmosferën e zgjedhjeve njëpartiake të qershorit të 2019.

Parashikoj një pjesëmarrje të ulët në votime", thotë për Newsbomb.al, Simon Shkreli, një prej gazetarëve veteranë të Shkodrës, korespondent i mediave qendrore të Tiranës.

Vilsoni, 36 vjeç, ka një biznes të vogël që merret me furnizimin e njësive të ndryshme me makineri kafeje. Ai hyn dhe del në shumë ambjente çdo ditë në Shkodër dhe takon shumë njerëz.

Vilsoni shprehet se nuk flitet shumë për këto zgjedhje. Edhe në lokalit e lagjes ku ai pi kafën zakonisht, nuk ka mbërritur ende fushata, dhe ndonjë prej njerëzve të kandidatëve akoma nuk është shfaqur për të kërkuar mbështetje ose votën.

Niku është kamarier në një bar të lezetshëm të zonës historike të pedonales në qytet. Kur e pyet nëse do të votojë me 6 mars, pasi dallohet që e ka mbushur moshën, thotë se nuk preferon të merret me politikë.

Na sugjeron të flasim me shokun e tij banakier, pasi ai i ka qejf këto gjëra. Aldi, është banakieri.

ZGJEDHJET
PARLAMENTARE

2021



PS 15.848 vota



PD 29.893 vota



PSD 9.808 vota



LSI 7.880 vota

ZGJEDHJET
VENDORE

2019

(VOTA PËR PARTINË)



PS 12.335 vota



PD 2.638 vota



PSD BOJKOT

ZGJEDHJET
PARLAMENTARE

2017



PS 20.195 vota



PD 25.559 vota



LSI 8.891 vota



PSD 7.930 vota

ZGJEDHJET
VENDORE

2015

(VOTA PËR PARTINË)



PS 10.884 vota



PD 25,353 vota



LSI 11.790 vota



PR 2.273 vota

SHKODRA ME HALLET E VETA

Shkodra në këto ditë shkurti ngjan e zënë me hallet e veta, me kokën ulur në përditshmërinë e saj me lëvizjet kaotike në qytet. Dallon nga larg se kemi të bëjmë me një popull që nuk jeton në luks, dhe rreket të sigurojë fundin e muajit pa rënë në gropa të mëdha borxhi. Si gjithnjë, nuk mungon vargu i gjatë i grave me biçikleta që feks si gjerdani i përhershëm i metropolit të Veriut. Baret përcjellin atmosferën e kafe-rakisë, e të batutave hidh e prit që prodhojnë të qeshura pareshtur. Në Tiranë e duan shumë kësaj radhe pushtetin e kufizuar lokal të kësaj bashkie. Sikur të fitonte Rama, ai do të kishte më në fund të realizuar një ambicie të shpallur prej kohësh, dhe me gjasë do të ishte rasti që ai të nisë me ato projektet që ka patur gjithnjë në mendje. Po të ndodhë që të triumfojë kandidati i Berishës, do të ishte një tërmet jo i vogël, duke qenë se i kontestuari i madh merr një mbështetje popullore, e veçanërisht nga e djathta historike e vendit. Basha nga ana tjetër, nëse ngadhënjën njeriu i tij, do të konfirmohej në kursin që ka nisur pas 9 shtatorit, do të merrte kohë dhe kredite të fuqishme për të vijuar atë që e ka pagëzuar si luftën ndaj trekëndëshit të Bermudës. Duket kjo arsyeja ndoshta, pse shkodranët nuk janë zhytur kësaj radhe me pasionin që i karakterizon në këtë sherrnajë. Sepse interesat e mëdha janë tjetër kundë, janë në kryeqytet. Kjo përshtypje të qendron si më e konsoliduara në kokë, teksa lë pas Urën e Drinit ku një tabelë shkruan emrat e qyteteve të rëndësishme të kontinentit të vjetër, si Berlin, Vjenë, Pragë, Grac,. Një tabelë kryeneqe e mendjemadhe, që sikur rreket të dëshmojë se në të djathtë të asaj krahine shtrihet Europa, të cilës ky qytet i përket.

Ai thotë se nuk ka dalluar fushatë kësaj radhe. Pa zhurmë, pa energji, pa tension. Megjithatë, 27 vjeçari është i bindur se sidoqë që të shkojë puna, njëra prej palëve të PD e fiton bashkinë, duke e konsideruar se PS vazhdon të mbetet në minorancë në këtë qytet.

MATEMATIKA

Nëse bëjmë një rrumbullakosje të shifrave elektorale të 4 zgjedhjeve të fundit në Shkodër, del se PD ka të paktën dyfishin e votave në krahasim me PS. Pra nëse me një pjesëmarrje të mirë, PD shkon në 30 mijë vota, PS merr 15 mijë. Me llogjikë, poqese ruhet ky trend historik, i bie që secili kandidat nga dy palët në PD që merr një votë më shumë, del fitues automatikisht.

Kjo duke marrë në konsideratë faktin që PSD e Tom Doshit, dhe LSI, në një farë mënyre marrin pak a shumë sasi të përafërt votash, duke i mbajtur ekuilibrat siç janë. Dhe ka dyshime nëse angazhimi i këtyre aktorëve do të jetë maksimal në këto zgjedhje të 6 marsit. Kjo sepse nuk luhet drejtpërdrejt për ta.



POLITIKË



Valentina Duka:

GABIMI MË I MADH NË JETË KUR I THASHË “PO” LULZIM BASHËS

Nga ANTA MUÇAKU

Një jetë dedikuar historisë dhe studentëve të saj. Aqsa është e vështirë të ndërmendësh Fakultetin e Historisë dhe të mos thuash fill pas tij emrin e Valentina Dukës.

Për 30 vite me radhë nuk ju nda auditorit, pa llogaritur këtu 17 muajt kur vendosi papritur të futej në politikë.

Sot, atë vendim e quan gabimin më të madh të jetës. Por si shumëkush, pas çdo gabimi, ka mësuar. Valentina Duka është tërhequr njëherë e përgjithmonë nga politika dhe ndoshta kjo është hera e fundit që flet për të.

Në këtë intervistë ekskluzive për revistën Newsbomb, ish-deputetja e PD, tashmë si një qytetare që e ndjek nga jashtë politikën, ka folur për gjithçka; ftesën e Bashës, mungesën e lirisë brenda partisë, djegien e mandateve, vrapin menjëherë të nesërmen për t'u rikthyer në Fakultet, përplasjen Basha-Berisha, si e

sheh ajo të ardhmen e PD por edhe rishkrimin e historisë, si një çështje me ndjeshmëri të lartë publike.

Një jetë në Fakultet, mësimdhënie... Sa vite u bënë fiks?

Vitin që vjen 30 vjet. Dhe sivjet 40 vjet në punë. Por 10 vjet kam punuar në institutin e Historisë. Fatmirësisht atë vit që mbarova unë, konsiderohesha te studentët e 5%-shit, që ishin më të mirët e Universitetit. Dhe këta student, ose mbaheshin pedagogë nëpër Universitete, ose punonjës shkencorë në Institucionet Akademike. Unë u emërova në Akademinë e Shkencave, Instituti i Historisë si punonjëse Akademike, 10 vjet. Aty njoha dhe bashkëshortin. Në 1993 më thërret drejtori i Institutit të Historisë dhe më thotë: “do ikësh në Fakultet për të riorganizuar Departamentin. E vetmja

Dolëm nga parlamenti dhe mbledheshim nëpër hotele; Brenda partisë nuk kishim liri debati, PD e tanishme ishte me mungesë lirie, ndryshe nga PD e '93, kur diskutonim plot pasion dhe me kundërshti. Një lider duhet të ikë kur nuk fiton zgjedhjet... Tani e shoh çdo gjë nga jashtë. Jam fokusuar te historia e qeverisë së Ismail Qemalit. Kam në dorë shumë dokumente dhe do ta rishkruaj të plotë, jo vetëm bardh e zi.

je ti që mund të kontribuosh në depolitizimin edhe të përmbajtjes, edhe të formës në atë institucion”.

Nuk e pritja aq mirë se do ndahesha nga kolegët e mi, por ishte zgjedhja më e mirë e jetës. Erdha në Fakultet dhe ja ku jam që nga '93 me përjashtim të 17 muajve lëvizje, lëvizja e parë dhe e fundit.

Nuk mund të mos ndalem këtu, sepse shumëkush u habit që pas gjithë këtyre viteve në lëmin e historisë dhe studimeve, ju futët politikës si drejtuese e qarkut të Korçës në zgjedhjet e 2017. Pse ajo kthesë, nga mësimdhënia në politikë, çfarë ndodhi?

Nëse do t'u kthehesha intervistave të para vitit 2017, mua kur më pyesnin nëse kisha dëshirë të bëja diçka tjetër, përgjigjesha: never (kurrë), sepse jam shumë e lidhur me

Fakultetin dhe studentët. Ishte një ftesë e kryetarit të PD në një moment ndoshta edhe të vështirë për mua, (sepse isha dekanë e atij Fakulteti dhe e bëja atë punë me shumë qejf) por më tha: “do marrësh një detyrë të rëndësishme, do drejtosh qarkun e Korçës”. E dyta, nuk dija nga brenda se çfarë statusi e roli kishte deputeti. Dhe kur s’e di, njeriu kërkon edhe të provojë diçka të re. Në fakt, po ta dija, nuk do ta kisha provuar.

Pra, sot jeni penduar?

Sot jam penduar. Kam bërë gabimin e jetës. Sot jam totalisht jashtë politikës, nuk më intereson, sepse jam shumë e lumtur me profesionin që bëj.

Pse jeni penduar? Çfarë ju bëri të pendoheshit kaq thellësisht, ta quani “gabimin e jetës?”

Më bëri të pendohesha statusi real i deputetit, jo ajo që shkruhet në ligjin për deputetin, por çfarë statusi ka deputeti i një partie politike në Shqipëri. Për mua humb dinjitetin, humb lirinë me të cilën unë isha mësuar të jetoja. Lirinë e të shprehurit, e marrjes së një vendimi, sepse aty mësova se isha e detyruar të respektoja disa rregulla të brendshme të partisë ku isha dhe ndoshta, ashtu funksionojnë dhe partitë jashtë, këtë nuk e di se nuk kam qenë ndonjëherë deputete diku tjetër. Por edhe në trajnimet që kemi bërë nga CDU-ja, mësoja që vendimet politike duheshin respektuar dhe duke menduar këtë respektova një vendim që sot them ishte totalisht i gabuar, lënia e mandateve.

E kam respektuar, unë nuk kam qenë pro, por kur ne na u kërkuar mendim, kryetari i partisë e kishte shpallur në televizor që “do lemë mandatet”. Nëse ne do e kishim kundërshtuar, të nesërmen partia do ishte shpërbërë dhe këtë ta them me bindje të plotë sepse ai e kishte shpallur.

E mori këtë vendim pa asnjë konsultim, pa pyetur?

E shpalli një natë më parë pas një mitingu dhe të nesërmen u kërkuar mendimi ynë, pasi që shpallur. Ndoshta ai e shpalli, sepse e dinte që mund të kishte probleme por ndodhi që ai e shpalli dhe pastaj na kërkoj mendim. Pati zëra kundër brenda grupit. Nuk ia vlen të përmend emra, por duke e parë ftohtë sot, ishte një nga gabimet më të mëdha që ka bërë elita politike e asaj partie, pjesë e atij gabimi jam unë.

Folët për ndërhyrje, mungesë lirie, mendimi, shprehjeje... Kush i bënte këto ndërhyrje?

Partia merrte vendime për çështjet që do diskutoheshin në Parlament, ndryshe nga ligjet që do diskutoheshin atë ditë, sepse ajo konsiderohej strategjia e partisë me të cilën jo

gjithnjë isha dakord. Psh, nëse do diskutohej ligji për trashëgiminë ne do flisnim për një çështje tjetër, për të cilën unë me bindje nuk isha dakord, por isha e detyruar t'i bindesha vendimit politik të partisë. Kur hyra aty, e kuptova që i takoj një institucioni ku duhet të respektoja një vendim edhe kur s'isha dakord.

KUR DOGJËM MANDATET, VRAPOVA NË REKTORAT

Pas djegies së mandateve ju u tërhoqet...

Pasi u mor vendimi për djegien e mandateve, unë vrapova të nesërmen te rektorati i Universitetit të Tiranës, sepse në bazë të ligjit të deputetit, mua më ruhej vendi i punës dhe i kërkova rektorit që kontrata të zbatohet që atë ditë. Atë ditë ishte një nga ditët më të lumtura të jetës sime, më dukej sikur më ishte rikthyer qetësia në jetë dhe kënaqësia në punë. Vendosa të mos kthehesha më kurrë në politikë.

Dhe këtë ia bëra të ditur kryetarit, jo atë ditë sepse nuk më kërkoi mendim. Kur filloi fushata për zgjedhjet e vitit 2021, seleksionimi i kandidatëve, i dërgova një shkresë zyrtare të mos e konsideronin emrin tim, sepse kisha dhënë totalisht dorëheqjen.

Dhe nga ai moment nuk keni pasur asnjë komunikim me zotin Basha?

Asnjë komunikim përveç urimeve apo ngushëllimeve të ndërsjellta familjare.

Zoti Berisha u shpall "non grata". Ç'mendoni për këtë gjë që ndryshoi tërësisht rrjedhën e zhvillimeve në PD?

Si një person që ka kontribuar për atë parti prej 30 vitesh, sigurisht ndjej keqardhje të madhe për ndarjen më dysh të saj, zyrtarisht, apo jo. Shoh bashkëpunëtorët e mi që mendojnë ndryshe tani, disa janë pozicionuar pro drejtuesit historik të PD-së dhe disa me drejtuesin aktual.

Mendoni se Basha duhej të kishte mbledhur organet e partisë për të vendosur përjashtimin e Berishës?

Sigurisht që e mendoj dhe jo vetëm për Berishën, por edhe për çështje të tjera. Unë kam qenë anëtare e KK të PD-së edhe në vitet e para, '93 -'94. Në ato vite ziente debati, tjetër gjë se çfarë vendimi merrej në fund. Njerëzit ishin të lirë të ngriheshin, kundërshtonin, aprovinin... Kam gjetur një Këshill Kombëtar ku nuk kishte zëra kundër.

Po thoni që PD-ja sot është më keq se PD-ja e '94-ës?

Nuk e di sot, por kur isha unë së fundmi, në

Pasi u mor vendimi për djegien e mandateve, unë vrapova të nesërmen te rektorati i Universitetit të Tiranës, sepse në bazë të ligjit të deputetit, mua më ruhej vendi i punës dhe i kërkova rektorit që kontrata të zbatohet që atë ditë

Këshill Kombëtar nuk kishte debat. Në Këshillin Kombëtar të asaj partie ka kualitete që elita e partisë duhet t'i marrë mendim për vendime më të pjekura.

Megjithatë u bënë zgjedhjet e brendshme, Basha u zgjodh kryetar dhe zoti Berisha nuk pati kundërshti për rizgjedhjen e tij në krye të partisë, derisa pastaj Basha mori vendimin që mori për të. Si i keni parë zgjedhjet e brendshme?

I kam parë nga jashtë. Në Kuvendin e korrikut ka pasur diskutime shumë interesante që kërkonin të zgjonin nga brenda PD, atë parti që përmbys komunizmin, që realisht ka pasur debate e demokraci të brendshme, megjithë zig-zag-et e veta. Sigurisht që pas humbjeve të mëdha, unë mendoj që kryetarët duhet të hapin krahun dhe t'u lenë vendin njerëzve të rinj për ta çuar partinë në fitore. Por ai ishte një vendim i Kuvendit dhe unë nuk mund të diskutoj vendimin e atij Kuvendi.

Kemi një lëvizje të zotit Berisha, një protestë të dhunshme, cilësuar e tillë dhe nga ndërkombëtarët tashmë, në selinë e PD-së. Si e komentoni këtë tentativë të tij, për ta rithemeluar siç thotë ai, partinë?

Berisha është në të drejtën e vet. Sigurisht nuk do doja ta shihja kurrë partinë siç e pashë në 8 janar. Fajtor janë të dy palët për atë ç'ka pashë dhe kam shumë frikë se PD do ndahet. Dhe po u nda, ndoshta e ardhmja mund të mos jetë aq e ndarë për të.

Një PD e ndarë çfarë do të thotë për opozitën, shoqërinë, demokracinë?

Për demokracinë mund të jetë më mirë, sepse çdonjeri reflekton sipas asaj që mendon. Për opozitën do jetë një dëm i madh, një dëm edhe më i madh për Shqipërinë, sepse një vend që kërkon të funksionojë sipas rregullave të demokracisë, pa një opozitë të fortë nuk mund të funksionojë siç duhet. Dhe nëse kjo parti do të ndahet...

E ndarë duket. Po shkojnë veç në zgjedhje!

De fakto është. Gjë që mua më mërzi, edhe si shqiptare, sepse një opozitë e fortë e çon Shqipërinë në një funksionim më normal në rrugën e demokracisë dhe kontribuon në cilësinë e jetës së shqiptarëve. Sa më shumë të grinden poli-



Arkitekturë neoklasike - Ndjenjë unike e trashëgimisë, bukurisë dhe elegancës!



Rolling Hills 2 – Luxury Residences është projektuar enkas për ju dhe të dashurit tuaj, për një jetesë autentike dhe të shëndetshme në ajër të pastër. Vilat rezidenciale janë të dizenuara në harmoni me relievin natyror dhe ofrojnë pamje të mrekullueshme të lindjes dhe perëndimit të diellit.

NA KONTAKTONI:

+355 69 801 4999 | sales@balfinrealestate.al | www.balfinrealestate.al



tikanët shqiptarë, e sidomos brenda opozitës, kjo nuk është në të mirë të vendit.

Nga Berisha keni patur një ftesë për t'u bërë pjesë e lëvizjes së tij?

Jo, jo. Unë jam jashtë politike tani. Është një vendim i pakthyeshëm.

Si do e portretizonit me një fjalë zotin Basha?

Basha është një politikan i ri, personi që më ftoi të isha deputete në PD. Është një drejtues që sipas meje i mungon dimensionin social në marrëdhënie me bashkëpunëtorët e tij dhe anëtarët e partisë.

Po thoni që nuk di të krijojë apo ruajë marrëdhënie njerëzore?

I mungon dimensionin social. Këtë mendoj.

Po zoti Berisha?

Berisha e ka dimensionin social, e ka angazhimin e tij politik, ka iniciativën për vendimet që merr por çështja e madhe tani për të është "non grata". Kjo e dëmton. I shpallur "non grata" nga SHBA me të cilën bashkëpunimi i Shqipërisë është shumë i rëndësishëm, është partneri ynë strategjik...

Është një betejë e humbur?

Atë nuk e di. Ai po e ndjek juridikisht këtë punë, por tani për tani është në ngërç.

Në betejën Basha-Berisha, ka vend për një lider të tretë?

Sigurisht që ka. Nuk mund të them me emra, por në Këshill Kombëtar ka politikanë të djathtë shumë të mirë që mund të ngrihen mbi armiqësitë e dy palëve dhe të bashkojnë partinë.

"E DJATHTA DUHET TË FITOJË SHKODRËN"

Jemi prag zgjedhjeve lokale. Si e parashikoni garën me një PD të ndarë. Ku e shikoni betejën më të fortë?

Opozita sigurisht duhet të aspirojë Shkodrën. E kam të vështirë të them kush do fitojë se s'di perceptimin e qytetit, por do doja që Shkodra t'u mbetej të djathtëve. Sa më shumë drejtues lokale të ketë opozita, aq më mirë është për

Politikanët shqiptarë por edhe në Ballkan, e përdorin historinë edhe për ngjarjet e ditës. Megjithatë, sot historianët shqiptarë i kanë të gjitha mundësitë, lirinë akademike, dokumentat mbi tavolinë, hapësirat, edhe financiare, por edhe institucionale për kërkime edhe në arkivat e tjera, për ta shkruar siç duhet historinë e Shqipërisë

Shqipërinë e ekulibrin politik.

Kampet kanë një ndarje shumë të madhe. Por kurrë nuk mund të themi kurrë. Ndoshta një faktor i tretë nesër, mund t'i bashkojë të gjitha palët dhe kjo do ishte dëshira ime.

Kush do ishte faktori i tretë? Kë keni parasysh?

Një kandidat i tretë, këtë kam parasysh.

E ka PD-ja mendoni?

Nuk shoh në terren që mund ta ketë, por kjo nuk do të thotë që mund të mos ndodhë, sepse gjithmonë ka dhe lëvizje qytetare që mund të ushqejnë njërin apo tjetrin palë të ndarë në PD. Ne kemi parasysh edhe çfarë ka ndodhur në Greqi, Itali, edhe me partitë e tyre tradicionale, shumëvjeçare. Në rrethana të veçanta u ndanë por lindën parti të reja, qoftë dhe me mbështetjen e partive të vjetra që dolën dhe fituese. Dhe Shqipëria ka nevojë për rotacione politike, përndryshe qeverisja mund të jetë më autokratike.

Të ndalemi te qeverisja.... Si e shikoni Ramën përballë "dyluftimit" Basha-Berisha?

Ramën e shoh në pozitën më të mirë të mundshme. Edhe në zgjedhjet e 6 marsit e shoh komod, sepse opozita shkon e përçarë. Por këto janë zgjedhje lokale, votohet për kandidatët dhe shqiptarët kanë treguar që edhe befasojnë. Edhe pse sigurisht, befasia lidhet edhe me siglën e partisë.

Flitet shumë për bashkëpunim e negociata, edhe pse në sy të publikut e kamerave, nuk kemi parë të negociohet. A mendoni se Basha po bashkëpunon me Ramën?

Thashethemet politike në Shqipëri janë shumë të mëdha, retorika është shumë e ashpër. Jashtë retorikës, opozita dhe pozita për çështje me rëndësi, duhet të bashkëpunojnë. Reforma territoriale është shumë e rëndësishme. Unë e pashë në terren gjatë zgjedhjeve, ajo reformë çon shumë vota te partia në pushtet. Nuk jam dakord të rikthehem te ndarja e vjetër me

komuna, por dhe kjo nuk ishte zgjidhja e duhur. Ky ishte një gabim tjetër i PD që nuk mori pjesë në debatet për reformën. Duke menduar që e braktisi, mendoi se ajo nuk do realizohej. Ata i kishin votat dhe e realizuan.

Braktisja e reformës territoriale, lënia e mandateve dhe mosmarrja pjesë në zgjedhjet lokale janë tre nga gabimet më të mëdha që bëri PD dhe i ka mbi supe sot.

Të ndërrojmë kapitull, për t'u kthyer në fushën tuaj. Në tekstet e historisë së Shqipërisë, ngjarjet më të rëndësishme kalojnë si statistika, informacionet janë shumë të cunguara. Thujse nuk ka asgjë për krimet e komunizimit. Janë përpjekur studiues e historianë përmes botimeve, auditoreve, medimeve të ndryshme por reflektimi i vërtetë nis nga tekstet shkollore. Rishkrimi i historisë. A duhet?

Unë kam shkruar për historinë e Shqipërisë edhe para '90, edhe pas. Para '90-ës, segmenti ku ndërhynte më shumë politika shqiptare ishte periudha e luftës dhe komunizmi. Segmenti ku historianët shqiptarë ishin më të lirë të ngriheshin mbi dogmën ishte histori e lashtë e Shqipërisë, historia e mesjetës. Edhe pas '90-ës përpjekjet më të mëdha të historianëve për ta rishkruar, për t'u ngritur mbi shumë teza dogmatike të detyruar për të qenë të tillë, ishin sidomos lufta dhe komunizmi. Nuk ka qenë e lehtë për shume arsye. Vetë historianët shqiptarë ishin pjesë e dogmës; e dyta, opinionin publik kishte shumë presion mbi ta, se fundja ata nuk vijnë nga qielli, janë pjesë e këtij opinionin, dhe e treta duhej të precipitonte ngjarja për ta analizuar, flas për luftën dhe komunizimin. Sot pas 30 vjetëve, historiografia shqiptare s'është si në 90-ën. Edhe pushteti i pas '90-ës nuk ka qenë fare i akullt te historishkrimi. Ka pasur ndikim. Sepse politikanët shqiptarë por edhe në Ballkan, e përdorin historinë edhe për ngjarjet e ditës. Megjithatë, sot historianët shqiptarë i kanë të gjitha mundësitë, lirinë akademike, dokumentat mbi tavolinë, hapësirat, edhe financiare, por edhe institucionale për kërkime edhe në arkivat e tjera, për ta shkruar siç duhet historinë e Shqipërisë.

Edhe në Evropë, në Amerikë flitet për shkrim dhe rishkrim të historisë. Dhe kjo nuk do thotë të grisen apo hidhen poshtë të gjitha hipotezat apo tezat që kanë shkruar paraardhësit tanë. Përkundrazi, mund të debatohet me to, mund të rishikohen të gjitha por jo domosdoshmërisht të gjitha. Mund të kalohet nga teza të gabuara, te teza që i qasen më shumë objektivës. Historiografia nuk është shkencë ekzakte 2+2 bëjnë

INTERVISTA

4, por është shkencë që ka rregullat e veta. A duhet rishikuar? Unë jam nga ata historianë që them se duhet.

Ju jeni ftuar në tryezën ku po shkruhet historia?

Jo. Kështu e kanë parë të arsyeshme grupi organizues. Unë kam bashkëshortin aty (Ferit Duka) që për mua është historian shumë i mirë i periudhës së historisë së mesme të Shqipërisë, pjesë e grupit të punës. Nëse ky grup do ia arrijë qëllimit të prodhojë një produkt me teza të argumentuara apo jo, këtë do e tregojë produkti, por historianët që janë angazhuar janë të gjithë profesionistë.

“NUK KA NEVOJË PËR NJË LIGJ DEKOMUNISTIZIMI”

Një ligj për dekomunistizimin. Nuk u bë kurrë, megjithë nismat e PD-së. Ju ndiheni përgjegjëse për këtë? Çfarë ndodhi?

Kur isha unë, në mbledhjet e grupit Parlamentar u diskutua më shumë se njëherë. Ndodhën ato ngjarje, ne ishim shumë pak në Parlament. Më shumë ishim jashtë Parlamentit, sesa brenda. Më shumë politikë bënim në ambientet e hoteleve ku mblidhej grupi ynë Parlamentar dhe i LSI, sesa në Parlament. Prevaluan çështje të tjera.

Por mendimi im, jashtë ligjit të dekomunistizimit, duke e parë çështjen pas 30 vitesh dhe pas një eksperience edhe nga takimet me specialistë gjermanë ku jemi pyetur qoftë dhe për njerëzit që dalin ditën e Çlirimit me foton e diktatorit, mendoj që nëse do kalohet në pengesa ligjore, do ta çojmë shoqërinë në reagime të dhunshme. Nuk ndihem mirë kur i shoh ata, por ndihem mirë që ata janë shumë pak, një përqindje totalisht e papërfillshme.

Nuk është i domosdoshëm një ligj?

Unë kështu e mendoj sot. Dhe një drejtues i lartë i “Konrad Adenauer” këtë përgjigje ka dhënë kur është pyetur: Pengesat ligjore do çojnë në reagime të dhunshme edhe në përmasa më të mëdha, sesa janë reagimet tani. Por mund të shihet edhe eksperiencia e vendeve të tjera. Edhe vendet ish-komuniste janë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra.

Komunizmi shqiptar ishte unik. Ky ligj do ishte mirë të ishte bërë në vitet e para post-komuniste dhe mund të kishte dhënë frytet e veta.

Ndërkaq, nuk kemi asnjë të dënuar për krimet e komunizmit...

Këto janë gabimet sidomos të elitës politike të djathtë shqiptare. Në këto 30 vjet, pjesa më e madhe e atyre që kanë qenë persekutorë realë mund të ishin gjallë në ‘90-ën, tani ndoshta janë nipërit e tyre dhe nuk e dimë çfarë angazhimi

“Këto janë gabimet sidomos të elitës politike të djathtë shqiptare. Në këto 30 vjet, pjesa më e madhe e atyre që kanë qenë persekutorë realë mund të ishin gjallë në ‘90-ën, tani ndoshta janë nipërit e tyre dhe nuk e dimë çfarë angazhimi kanë në shoqëri”

kanë në shoqëri. Tani janë përzierë, partitë politike nuk janë të pastra, të majta dhe të djathta.

Nuk ka më as shpresë me hapjen e dosjeve?

Tani shoqëria është më e akullt në hapjen e dosjeve. Këtë perceptim kanë edhe kolegë që kanë punuar tek “Shtëpia me Gjethe”, kolegë që kanë punuar edhe tek pavionet e Muzeut Kombëtar që lidheshin me persekutimin komunist. Shoqëria shqiptare ka qenë e përzier mes njerëzve që i kanë shërbyer komunizmit të fshehtë, apo të hapur. Ndal dhe hapja e dosjeve në fillim të viteve ‘90 është diskutuar shumë në forumet politike dhe mediatike të asaj kohe. Vetë elita politike nuk donte një luftë edhe brenda familjeve shqiptare, se do dilnin gjëra që...

Tani mendoj që shoqëria është më e akullt, rinia më e lirë, ndryshe reagonin atëherë studentët, tani janë më të akullt në gjykim, më të ftohtë edhe në reagim. Disa gjëra do i vendosë në vend vetë shoqëria.

Çfarë po studioni apo shkruani në këtë periudhë?

Kërkimet e mia të thella i bëj në historinë e Shqipërisë, sidomos në vitet 1912-1920. Po merrem me qeverinë e Vlorës që e kam shumë përzemër, jo se s’është shkruar, por po e shoh nga perspektiva e dokumentave shqiptare dhe të huaja. Kam në dorë dokumentat angleze, austro-hungareze, dokumenta edhe franceze. Kam mundësi ta shkruaj Pavarësinë e Shqipërisë dhe figurën e Ismail Qemalit jo bardh e zi.

Kur do e keni gati?

Ndoshta në 2023-shin. Pandemia na vuri përballë ekzistencës dhe punës dhe sigurisht në këtë betejë prevalon jeta. U angazhuam shumë dhe me përshtatjen me mësimin online për t’u dhënë studentëve më të mirën e mundshme. Kjo na mori shumë kohë fizike. Sjellje të reja, rregulla të reja... Edhe librin e ri kur e fusja brenda, thoja: të rrijë 5 ditë jashtë pastaj ta prek me dorë. Këtë vazhdoj ta kem edhe sot.

Edhe revistën tuaj kur e sjell korrieri, i them: nuk e hap 5 ditë sa të mbarojë karantinimin!



MIELLI ASSOS



MIELLI I PARË SHQIPTAR BIO





GYLENISTËT

halli i madh

i EDI RAMËS

| Nga NEWSBOMB.AL

Ishte mesdita e 4 dhjetorit 2019, kur 27 drejtuesit më të lartë të shteteve anëtare të NATO-s prisnin tre liderë. Ata ishin vendosur për të bërë foton familjare në hotelin Grove në Watford, një zonë në Lodër, ku po zhvillohej samiti Britani – NATO.

Kancelarja gjermane Angela Merkel, dhe presidenti francez Emanuel Macron, madje edhe mikpritësi Boris Jonson, ishin mes atyre që prisnin për një foto.

Tre anëtarë të aleancës, nuk kishin mbërritur akoma. Bëhej fjalë për drejtuesit e dy superfuqive, dhe një kryeministri të një vendi të vogël. Donald Trump, ish-Presidenti i SHBA, Taip Erdogan, president i Turqisë, dhe Edi Rama, kryeministër i Shqipërisë, erdhën gjysëm ore me vonesë për foton familjare që ju dokumentua gjithë botës nga ai samiti i NATO-s.

Dhe siç duket qartazi në foto, i pari hyn Erdogan, pas tij, Trump e në fund Edi Rama.

Po çfarë i ngjau kryeministrit të Shqipërisë që u fut me vonesë në atë foto familjare? Përveç fotos që u servir nga gjithë mediat ndërkombëtare pakgjë u fol në kohën që u shkrep foto.

Ka një të vërtetë të madhe: Rama ishte në takimin që Donal Trump, president i Amerikës, zhvilloi me presidentin e Turqisë Taip Erdogan.

Ishin muajt e ethshëm kur Trump kishte tërhequr trupat nga Siria dhe një muaj më vonë, në nëntor 2019, priti në Shtëpinë e Bardhë presidentin Turk, për të cilin atëkohë tha se ishte një “fans i madh” i tij, siç u shpreh publikisht.

Vetëm një muaj më vonë, në dritën e këtyre zhvillimeve, Trump dhe Erdogan u takuan sërish, këtë herë në Londër, e në takimin e të dyve, ishte edhe kryeministri i Shqipërisë Edi Rama.

* * *

Nuk është sekret se kryeministri Edi Rama është mik me presidentin Erdogan. Dhe nuk është e para miqësi turko-shqiptare.

Në vitin 2004, ish-Kryeministri Fatos

Në 2019, liderët botërorë të NATO-s pritën gjysëm ore që Trump e Erdogan të vinin për foton familjare. Kur ata hynë në sallë, u pa të shoqëroheshin nga Edi Rama. Dhe ai, siç duket, në rolin e ndërmjetësuesit për shkak të miqësisë së madhe me Erdogan. Po cilat janë bizneset gjeniste në Shqipëri? Kë duhet të tradhëtojë Edi Rama për Erdogan? Një gazetë turke nxjerr hartën e tyre në Shqipëri, vetëm pesë ditë pas vizitës së presidentit Turk në Tiranë...



Nano dhe ish-kryeministri Italian Silvio Berlusconi ishin dëshmitarë në martesën e djalit të kryeministrit turk atëkohë, përpara se të merrte pozicionin e presidentit të Turqisë. Pas firmës simbolike familjare, erdhën shumë investime turke në Shqipëri, një prej të cilave, Albtelekom.

Më vonë, pas 2005, edhe pse Berisha deklaroi se do rishikonte kontratën me turqit për Albtelekom, nuk arriti të bënte dot gjë. Përkundrazi,

koncesionin më të madh, ndërtimin e rrugës së kombit, ia dha firmave turke, pas vizitës së parë jashtë vendit që bëri si kryeministër, e që ishte në Turqi me ftesën e kryeministrit Erdogan. Koha e artë e marrëdhënieve vazhdoi, aq sa kryeministri Sali Berisha, për habi të të gjithëve e ftoi kryeministrin Erdogan të vinte në 100 vjetorin e festimeve të pavarësisë së Shqipërisë... nga Turqia.

Ardhja e Ramës në krye të qeverisë në 2013, nuk e ndryshoi kursin e marrëdhënieve dypalëshe. Madje, sikurse paraardhësi i tij socialist, Fatos Nano, Edi Rama ishte dëshmitar në martesën e vajzës së kryeministrit Erdogan në 13 maj 2016, në një ceremoni me 6000 të ftuar dhe nën masa të rrepta sigurie. Sikurse vetë Rama deklaroi në takimin e fundit që kishte me Erdogan paraditen e 17 janarit 2022, ata janë takuar fillimisht kur Rama ishte ende kryetar i opozitës.

“Të them të drejtën unë isha i ndrojtur pasi e kisha parë nga televizori dhe nuk dukej shumë i qeshur. Dhe kur u takuam më shikonte, por nuk buzëqeshte. Dhe unë akoma nuk isha bërë Kryeministër dhe më thotë dëgjo këtu “Shqipëria dhe Kosova janë në zemrën time, shqiptarët janë në zemrën e popullit turk dhe unë dëshiroj të jesh vëllai im dhe unë do të të them vëlla kur t’i si kryeministër të fitosh respektin e popullit tënd”, kujtoi Edi Rama nga ai takim i parë.

Ka një lloj magjepsjeje mes dy liderëve. Rama deklaroi se e ka shumë mik presidentin Erdogan. Të njëjtën gjë thotë dhe ky i fundit. Por ndërsa pjesa e marrëdhënieve miqësore ecën në shinat që Ramës i besohet të ndërhyjë te Erdogan edhe për konflikte ndërkombëtare, në aspektin e brendshëm, Erdogan ia tha troç se nuk i pëlqen që Gjenistët në Shqipëri kanë fituar terren.

Tej kësaj, diplomatët thonë se të tjera çështje janë në lojë. Acarimi i marrëdhënieve të NATO-s me Rusinë muaj e fundit, po rrit valencën e Turqisë për të mbajtur Ballkanin larg këtyre zhvillimeve. Ndërsa për pabindjen e Erdogan në shumë çështje, gjendet “ilaçi”: Edi Rama mund të jetë një interlokutor i jashtëzakonshëm mes tij dhe liderëve perëndimorë. Madje edhe për kancelaren gjermane Angela Merkel, vitaliteti i Ramës për të negociuar me Erdoganin që i linte pa karrige zyrtarët evropianë, ishte një zgjidhje.

E ndërkohë që Ramës i pëlqen pozicioni ndërmjetësues që ka marrë në arenën ndërkombëtare për shkak të raportit miqësor me Erdogan, këtu brenda vendit, presidenti turk ishte i qartë dhe i prerë sesi donte të evolonin çështjet.

“Në takimet tona nënvizuam luftën tonë kundër organizatës terroriste FETO, që tentoi në 2015 një grusht shteti që donte të rrëzonte demokracinë tonë. Është e qartë që kjo strukturë e cila i ka duart e lyera me gjakun e të pafajshmëve përbën kërcënim jo vetëm për Turqinë, por edhe vendet ku është e pranishme. Fakti që FETO është ende në gjendje të gjejë fushë veprimi në

vendin mik e vëlla, e lëndon thellë vendin tonë. Pritshmëria jonë është që të ndërmerren hapa më të shpejtë dhe më konkretë kundër FETO-s në Shqipëri”, tha Erdogan në 17 janar 2022.

KUSH JANË GYLENISTËT?

A ka dalë ndonjëherë ndonjë listë të gylenistëve që pretendohet se operojnë në vendin tonë? Zyrtarisht, asnjëherë nuk është bërë publike. Një listë e tillë mund të vërtitet në zyrat e qeveritarëve, apo në listat e kërkesave të ambasadës turke në Tiranë drejt qeverisë, por gjithmonë nën dorë.

Vetëm 5 ditë pas vizitës së liderit Erdogan në Shqipëri, në 22 janar 2022, një gazetë proqeveritare në Turqi, “Dirilis Postasi” nxjerr një hartë të bazave të lëvizjes FETO në Shqipëri, të shkollave të mbështetura nga lëvizja Gyleniste, por edhe biznese dhe OJQ që Turqia beson se janë të sponzorizuara nga lëvizja FETO.

E VËRTETA E MADHE

Sipas raportimit të medias turke në datën 22 janar 2022, vetëm pesë ditë pas vizitës së Erdogan në Shqipëri, panorama bëhet më e qartë për ata që Turqia kërkon të mos fitojnë terren në Shqipëri. E bëhet fjalë për biznese të mëdha, për Komunitetin Mysliman Shqiptar, për Universitete e kolegje që operojnë gjerësisht në Shqipëri, dhe për fondacione që sipas Turqisë ushqehen me paratë e lëvizjes gyleniste.

Këtu, kryeministri Edi Rama ndodhet vërtet në hall. Në fund të fundit, të gjithë të përmendurit nga Erdogan, edhe pse jo nominalisht me emra, janë biznese të konsoliduara në Shqipëri. Universitetet kanë shumë studentë, staf akademik profesional dhe zgjerim edhe më të madh sesa universitetet shtetërore.


Po kështu edhe kolegjet: ato arrijnë të thithin gjithmonë e më shumë fëmijë për shkak të rregullave strikte të mësimdhënies e disiplinës.

Për të mos folur për spitalin Amerikan që është një ndër bizneset më të fuqishme në Shqipëri, ku mjekët e punësuar janë ajka e elitës shëndetësore në vend, e ku shërbimet e këtij spitali privat, i marrin jo vetëm qytetarët e thjeshtë, por edhe qeveritarët.

Komuniteti Mysliman është një çështje më vete. Aty, gjithçka ndodh me votë dhe të zgjedhurit në të, dalin nga komuniteti i imamëve dhe hoxhallarëve.

Të gjithë këto institucione janë ngritur dhe konsoliduar. Nuk mund të besohet asesi që Edi Rama dhe qeveria shqiptare të arrijë t'i mbyllë ato me një të rënë të lapsit.

Si do të garantohet Turqia që këto institucione të fuqishme financiare të mos krye-



jnë aktivitetin e tyre normalisht. Shkollat dhe universitetet janë të licensuara dhe përmbushin standartet. Po kështu, edhe bizneset e tjera të supozuara si të sponzorizuara nga gylenistët.

STRUKTURA PARALELE

Turqia e ka të qartë se historia e mbylljes së shkollave të kërkuara në listë si gyleniste, nuk është e lehtë. Për këtë arsye, në vitin 2016, në betejën e vërtetë për arsimin, krijoi fondacionin “Maarif” që të merrte administrimin e shkollave ekzistuese që sipas Turqisë, ishin nën ndikimin e FETO.

14 INSTITUCIONE ME NDIKIM GYLENIST NË SHQIPËRI

Pas diktaturës së Enver Hoxhës, organizata FETO që kërkon të ndërmarrë avantazh në vakumin edukativ dhe fetar në Shqipëri, u vendos në vend që në vitin 1990.

U shfrytëzua dashuria e shqiptarëve për Turqinë dhe turqit dhe u rrit kërkesa për hapjen e shkollave nga organizata FETO. Shqiptarët shkuan në këto shkolla, jo se ishin fansa të FETO, por për shkak të besnikërisë ndaj Turqisë.

Megjithatë, pas grushtit të shtetit të 15 korrikut 2015, shqiptarët reagues menjëherë. Shumë fëmijë ikën nga këto shkolla. Edhe qeveria e Shqipërisë dha mesazhin se kushdo që është armik për Turqinë, është armik edhe për ne. Edhe pse institucionet e FETO nuk janë aq popullore sa ç'kanë qenë më parë, ato vazhdojnë të jenë ende shumë aktive.

Anëtarët e FETO që hynë në vend së bashku me Fondacionin Gylen, në vitin 1993, hapën "Mehmet Akif College" në kryeqytet; po në të njëjtin vit hapën kolegjin "Turgut Ozal" dhe "Draç" në 1997. Në vitin 2001 në Shkodër hapën kolegjin "Hasan Riza Pasha".

Po në vitin 2001 u hap nga FETO-istët "Memorial International School Tirana" (MIST) ku shkonin fëmijët e shtresave më të pasura, që influencojnë në bizneset kryesore, qarqet politiko-ekonomike të vendit.

Një nga liderët e FETO, Mustafa Ozcan, një kriptom-enaxher në Turqi dhe Ballkan dhe Noman Gulen, nipi i liderit të FETO, Fetullah Gylen ishin mes menaxherëve të këtyre institucioneve.

Në vitin 1994, u krijua fondacioni SEMA po nga anëtarët e organizatës FETO.

Anëtarë të komunitetit FETO janë edhe tek Komuniteti Mysliman shqiptar, duke përfshirë edhe strukturat e tij dhe administratën që kur kanë filluar të operojnë në vend. FETO mori mederresetë e KMSH në qytetet e Kavajës, Korçës, Beratit, Elbasanit, Tiranës, nën organizatën Sema. U hap një dritare e re e mbledhjes së të ardhurave si donacione. FETO u bë shumë aktive në KMSH, duke siguruar që edhe një person që nuk ishte teolog të zgjidhej president i KMSH në zgjedhjet e brendshme.

14 ORGANIZATAT JANË NË OPERIM

Sot ka 14 organizata aktive në Shqipëri, duke përfshirë dy universitete, "Beder" dhe "Epoka"; pesë kolegje (parashkollor dhe parauniversitar), 5 medrese, dhe 2 kurse gjuhësh. Ka 7 mijë studentë që po rriten në këto institucione të drejtuara nga FETO, ku 2 mijë prej tyre janë në edukimin e lartë.

Fondacioni arriti të marrë Universitetin New York Tirana, gjimnazet New York High School dhe "IMSA High School Elbasan" dhe institucione të tjera mësimore. Në një rrjet që deri tani vlerësohet me 1500 nxënës.

TIKA, Agjencia Turke për Zhvillim dhe Kordinim është një tjetër instrument që përdor Turqia për ekspansion në Shqipëri. Sipas ambasadorit Murat Ahmet Yoruk, TIKA që

Disa nga kompanitë dhe institucionet me të cilat FETO operon në Shqipëri janë:

1. ORGANIZATA JO-QEVERITARE

a) Horizontet e reja: Anëtarët e FETO e krijuan atë në 2005. Përdoret për të organizuar dhe mbledhur së bashku njerëz, për t'i lidhur së bashku dhe për të pasur informacion edhe për jetët e tyre.

b) ACITAD: ky institucion që është krijuar nga njerëzit e FETO është quajtur prej tyre edhe si "Dhoma e tregtisë" për shkak të shumë kompanive që erdhën në Shqipëri nga Turqia për biznes. ACITAD, që filloi të shohë për gjëra të reja pas grushtit të shtetit të 15 korrikut, parashikon mbështetje për financat e organizatës duke kapur investitorë lokalë që besojnë tek FETO, si bashkëpunimi me rajonet ku jetojnë shqiptarë, duke investuar te rinia shqiptare.

c) Fondacioni SEMA, është një tjetër organizatë e fortë që operon në Shqipëri. Financën medresetë dhe Universitetin Beder. Fondacioni i Edukimit Gylenist vepron si një ombrellë për shkolla të tjera dhe për t'i financuar ato.

2. SEKTORI PRIVAT

Turgut Ozal Sh.a.: Kjo kompani që është një nga organizatat ombrella për shkollat FETO në Shqipëri, përfshin universitetin "Epoka", kolegjin në Tiranë "Turgut Ozal", kolegjin "Turgut Ozal" në Durrës dhe Shkollën Internacionale Memorial.

Spitali amerikan: kjo strukturë që është spitali privat më i madh në Shqipëri ka mbështetje të fuqishme financiare.

Të tjerë: Në vijim të këtyre dy bizneseve të mëdha në Shqipëri ka shumë kompani dhe biznese të tjera që parashikojnë financime për organizatën.

3. MEDIA

Anëtarët e FETO kanë infiltruar në media ashtu si në çdo sektor tjetër dhe njerëzit e tyre i kanë vendosur në pozicione shumë të rëndësishme. Platforma online Albeu operon nën drejtimin e organizatës. Ata kontrollojnë dhe Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Tiranës dhe dominojnë në media duke punësuar figura shumë influente në Universitete shtetërore dhe në universitetet e tyre.

4. PUBLIKIME DHE LIBRA

Shtëpia botuese "Prizmi" vazhdon punon në mënyrë aktive në Shqipëri në mënyrë që të përdorë dhe të shpërndajë librat që i përkasin liderit të FETO, Fetullah Gylen. Ka dhe një website shqiptar që i përket FETO. Në këto website përveç përkthimeve dhe shkrimeve të Gylen, ka edhe fjalime të tij të përjavshme.

(Ky është artikulli botuar në revistën turke, "Dirilis Postasi")

nga viti 1996 ka realizuar mbi 546 projekte në Shqipëri që kapin shifrën e 20 milionë eurove. E fundit, ishte restaurimi i Xhamisë kryesore në kryeqytet e inauguruar pak ditë më parë nga Presidenti Erdogan dhe kryeministri Edi Rama por pa prezencën e asnjë imami, apo përfaqësuesi të komunitetit mysliman, për shkak të dyshimeve që ka Turqia për lidhjet e tyre me gylenistët.



Komuniteti Mysliman Shqiptar



INVESTIGIMI

IMAMË E HOXHALLARË SI JANË NDARË GYLENISTËT DHE ERDOGANISTËT NË SHQIPËRI

| Nga NIKOLETA KOVAÇI

“Kur ngjitët shkallët dhe mbërritët deri tek unë, patë ndokund ndonjë turk nëpër ambientet tona?”... Kështu nisi biseda me një zyrtar të Komunitetit Mysliman, i cili me bindje përfaqëson dhe deklamon idenë se zhvillimet e fundit nuk meritojnë koment në opinionin publik!

“Ne e dimë se kush jemi, se çfarë principesh e lirish mbartim e demonstrojmë”, - vijon arsyetimin zyrtari i Komunitetit, ndërsa refuzon të identifikohet për të ruajtur balancën e heshtjes që ka vendosur Komuniteti për këtë rast të shumë diskutueshëm.

Për çështjen më të debatuar të mungesës së përfaqësuesve të Komunitetit Mysliman në ceremoninë e inaugurimit të Xhamisë së Et'hem Beut në qendër të Tiranës nga ana e Presidentit turk Erdogan dhe kryeministrit Edi Rama, ai na thotë se “nuk kishin ftesë,... mbase për shkak se xhamia është objekt kulture dhe protokollin për atë pjesëmarrje ndoshta e ka patur Ministria e Kulturës”.

Por kundër KMSH-së dhe qasjes së tyre kah idetë dhe filozofia gyleniste, janë ngritur edhe hoxhallarë, të cilët kanë dalë publikisht prej kohësh kundër ‘kapjes’ sipas tyre të KMSH nga rrymat gyleniste! Përballja brenda llojit në të dy kampet argumentohet sipas fakteve dhe ideve që kanë, ndërsa ‘gylenistët’ në Shqipëri duket se janë veç shtetas shqiptarë!

HISTORIANI DISKRET

TREGON GYLENIZMIN NË SHQIPËRI

Një historian, njohës shumë i mirë i historisë turke dhe evoluimit të rrymave të ndryshme në Turqi, tregon se gylenizmi ka hyrë herët në Shqipëri. Daton diku mes viteve ‘93-‘94! Sipas tij, themelet janë hedhur nga shqiptarët e shkolluar në Turqi që më pas janë rikthyer. Kanë ardhur me investime, kryesisht në shkolla e spitale. Sipas tij, gylenizmi operon me rrjet, me elementë të caktuar në çdo fushë, kryesisht në ato që kapet më shpejt impakti publik!



SI SHPËTOI MËSUESI I GJEOGRAFISË

Në 8 tetor 2017 në portin e Durrësit u ndalua shtetasi turk Muhammed Yasir Aydogmus me profesion mësues gjeografie, së bashku me familjen e tij, në tentativë për t'u larguar nga Shqipëria me pasaporta falso. Në 11 tetor, shtetasi turk doli përpara gjykatës së Durrësit që e liroi atë. Menjëherë reagoi ambasada turke që e konsideroi vendimin skandaloz. Nëpërmjet një deklarate, ambasada turke tha se gjykata liroi një individ që i përket organizatës terroriste FETO. "Ne ofruam të gjitha dokumentet dhe pritëm që Shqipëria ta mbante të ndaluar për 40 ditë në bazë të konventës" tha ambasada në deklaratë. Pasi gjykata vendosi për të detyrim paraqitje, kjo nuk ndodhi. Për shtetasin turk nuk pati asnjë të dhënë.

"FETO nuk është organizatë terroriste, tjetër punë që ata ta minojnë pushtetin nga brenda. Ata, kudo në botë, kanë funksionuar me të njëjtin mekanizëm, krejt të njohur, ashtu siç edhe sollën Erdoganin në pushtet! Zakonisht, aty ku investojnë, presin të marrin edhe rezultate, veçse jo të menjëherë. Kanë aftësinë të presin, për shkak të ecjes me ritme të sigurta!

Përsëmbull, vëmendjen, shumë kohë, e kanë përqendruar në Ushtri dhe Polici! Janë dy shtetorët ku investimet e tyre janë të rregullta e për pasojë pati edhe gylenistë që gjendeshin në krye të institucioneve të rëndësishme turke në momentin e grushtit të shtetit. Pak a shumë kështu ka ndodhur edhe në politikën dhe biznesin tonë. Ata drejtojnë bizneset e tyre këtu, i futën rrugës së politikës dhe më pas mbërrijnë deri në qeveri. Ka patur deputetë e ministra në të gjitha qeveritë që janë konsideruar gylenistë. Ndonëse të tanët, nuk janë dhe aq parimor, fjala bie, siç është një zyrtar gylenist në Turqi. Por ama, ata kanë qenë dhe janë

pjesë. Siç janë disa medrese, kolegje, kampuse universitare dhe një sërë spitalesh!"

Historiani nuk do të identifikohet, se thotë që gylenizmi në vendin tonë është i fuqishëm ekonomikisht dhe me interesa të forta që lidhen me të gjitha pushtetet. Ai flet me emra ministrash e deputetësh që kanë gjeneruar në disa qeveri. Tregon se në disa katedra universitetesh, gjithë drejtuesit janë gylenistë!

E këtu ndalet e fikson: "Shteti i di, SHISH i di, prokuroria dhe policia, po e po. Ka emra që mbeten gjithnjë në krye me çdo pushtet! Ata dihet që përfaqësojnë më shumë sesa një forcë politike në vendin tonë. Edi Rama, pra kryeministri jonë, bën gabim që nuk i përgjigjet publikisht, sepse krijon imazh të gabuar duke e anashkaluar këtë fakt. Që dikush të thotë se ti ke brenda vendit tënd një organizatë terroriste të vendit tim dhe duhet të m'i sjellësh mua, kjo krijon panik, sepse masa nuk e di se çfarë përfaqësojnë këta njerëz në instanca të shumta tonat. Terrorizmi është term i shpikur nga Erdogan për t'i bërë këta njerëz të duken armiqësor kudo ku operojnë. Por në fakt, ata janë thjeshtë të fuqishëm ekonomikisht, të pushtetshëm dhe shpeshherë edhe të paprekshëm! Në vendin tonë, ata nuk gjenden në formën e terroristëve, as të vrasësve, por si ministra, deputetë, drejtues nëpër institucione të ndryshme deri edhe në media!"

E, kur i parashtrohet faktin se përse u anashkalua Komuniteti Musliman nga takimi për inagurimin e xhamisë, historiani e ka të qartë dyshimin: "Komuniteti Musliman edhe mund të përçojë ide të kësaj rryme. Në fakt ata janë perëndimorë dhe sigurisht që nuk i rrinë përshat filozofisë së Erdogan. Por nuk janë në nivele shqetësuese. Fundja investimet që janë të kësaj rryme në Medrese dhe Kolegje janë të njohura, ndryshe atyre që operojnë me biznese të tjera, si spitale, media, apo universitete shtetërore. Ndaj Komuniteti Musliman nuk duhet të shqetësojë askënd përse kohë ata nuk cenojnë për asnjë moment harmoninë mes komuniteteve! Përkundrazi janë një katalizator perfekt i kësaj marrëdhënieje unike mes besimeve që ka shoqëria jonë!"

HOXHA QË IDENTIFIKON DHE AKUZON...

Justinian Topulli është një hoxhë që flet me emër, pa dorashka, nuk fshihet dhe ka vendosur që betejën e tij kundër Komunitetit Musliman ta bëjë hapur. Po kaq hapur akuzon dhe identifikon gylenizmin jo vetëm në KMSH-së, por edhe në shëndetësi, arsim, media dhe biznes. Si një zë publik, ai nuk ngurron të përgjigjet dhe të tregojë gjithçka të kapur nga gylenistët, së pari, në komunitetin fetar ku ai bën pjesë. Pyetjes në lidhje me akuzat e tij për kapjen e KMSH nga gylenistët, ai i përgjigjet gjatë e pa asnjë pengesë:

"Kapja në mënyrë ilegjitime e KMSH-së nga gylenistët ka ndodhur më së shumti në mënyrë të heshtur, hap pas hapi, për më shumë se dhjetë vjet përmes metodës së tyre të infiltrimit të

pazëshëm në administratën e KMSH dhe, në veçanti, në kryesinë e saj, e cila praktikisht është organi i vetëm që vendos për gjithçka. Ata kanë përdorur ndikimin ekonomik, politik dhe lidhjet që kanë pasur me disa nga drejtuesit e dikurshëm të KMSH, duke i mbështetur ata, apo duke heshtur ndaj abuzimeve të tyre, në këmbim të vendosjes së njerëzve të tyre në poste të rëndësishme në KMSH. Ata, gjithashtu kanë përfutur në këtë situatë në mjaft raste edhe nga indiferenca e imamëve dhe frika që këta të fundit kanë për vendin e punës”!

Hyrjen e ‘gülenistëve’ në radhët e KMSH-së, Topulli e identifikon aty rreth viteve 2000. Në parashtrimet e tij të rritjes së kësaj rryme brenda komunitetit, ai jep idenë se si në fakt operojnë përfaqësuesit e gülenizmit, paçka se ai e ka fokusin vetëm brenda institucionit të cilit i përket.

“Në vitet 2000, lindi nevoja e shtimit të të rinjve, intelektualëve dhe e klerikëve të diplomuar në vendet e botës islame në drejtimin e KMSH, si kërkesë e besimtarëve. Mes tyre kishte edhe ndonjë gülenist, të cilët u punësuan që herët në zyrat e KMSH, por pa pasur ndonjë post të rëndësishëm dhe pa u ndjerë asnjëherë zëri i tyre. Në dallim me këta të fundit, të cilët i përkasin një grupi tepër të strukturuar dhe organizuar hierarkik, të tjerët ishin mjaft të ndryshëm mes tyre dhe të pa organizuar, megjithatë, ata arritën të përçonin një lloj larmie dhe demokracie të brendshme brenda KMSH për një farë kohe, duke krijuar kështu një hapësirë debati në të, për disa nga çështjet më të nxehta në atë kohë, siç ishte çështja e administrimit të pronave vakëf të KMSH...etj”.

Topulli ndalet dhe analizon situatën që karakterizohej nga një frymë konflikti latent mes brezit të ri dhe pjesës së vjetër për mënyrën sesi zhvillohej aktiviteti fetar i KMSH, që në dukje ishte konflikti brezash, por për të ishte shumëherë më tepër sesa aq.

“Në këtë situatë, deri diku kaotike brenda KMSH, gülenistët përfutuan duke u afëruar me kryesinë dhe kryetarin e atëhershëm, duke mos hapur gojën kurrë kundër shkeljeve që bëheshin si dhe duke përfutur nga imazhi se ata ishin tolerant, sepse kishin studiuar në Turqi, apo nuk mbanin mjekër etj. Përveç kësaj ata kishin siguruar edhe lidhje interesash dhe favoresh me disa nga drejtuesit e lartë të KMSH, duke i bërë ata borxhli karshi tyre. Fillimisht gülenistët morën nga KMSH administrimin e shumicës së medreseve, dhe duke pasur përvojë në arsim, ata i kthyen ato në modele koleg-

jesh, çka u pa dhe trumbetua si sukses. Në vitin 2010, pati një konflikt në kryesinë e KMSH mes dy grupimeve që kryesoheshin nga njerëz të diplomuar në Turqi, njëri tërësisht gülenist, tjetri i përzier. Grupi gülenist arriti të sigurojë mbështetjen e kryetarit të atëhershëm, por edhe me mbështetjen e shtetit, arriti të vendosë nën kontroll gjithë kryesinë e KMSH dhe të largojë pas kësaj me ritme të shpejta të gjithë elementët që nuk i përkisnin grupit të tyre”.

Sipas tij nga pozitat drejtuese të kryesisë, ata i kanë detyruar në mjaft raste myftinjët e rretheve që të vendosin si anëtarë përfaqësues “të zgjedhur” nga besimtarët e zonës përkatëse vetëm njerëz të besuar apo të pranuar nga gülenistët, këta të fundit shpesh të panjohur nga radhët e besimtarëve. Ndërkohë që duke i mëshuar rrymës që ka kapur KMSH, ai thekson faktin se në mjaft myftini, as që zhvillohen zgjedhjet për përfaqësuesit e zonave, por edhe atje ku ato bëhen, zhvillohen në mënyrë fiktive dhe manipulohen në mënyrë të turpshme, duke përfutur nga fakti se myftinjët dhe imamët janë të emëruar dhe kanë frikë të kundërshtojnë presionin e kryesisë të KMSH. Sipas Hoxhës, Këshilli i Përgjithshëm i KMSH, që supozohet të zgjedhë gjithë drejtuesit e KMSH, është një organ fiktiv, praktikisht pothuajse i gjithi i emëruar nga kryesia e KMSH në shkelje flagrante të statutit dhe moralit të besimit.

Po cilët janë gülenistët sipas Topullit, kryesisht në KMSH dhe jo vetëm? Ai shpjegon: “Gülenistët janë një grupim okult, hermetik të cilët janë përjashtues, edhe pse në radhët e muslimanëve praktikantë ata janë një pakicë, megjithatë, përmes metodave të tyre makiaveliste ata kanë kapur përfaqësinë e KMSH dhe e mbajnë atë në mënyrë ilegjitime. Ata nuk pranojnë de fakto të respektojnë statutin e KMSH, nuk pranojnë në Këshillin e Përgjithshëm dhe drejtimin e KMSH

“Në vitet 2000, lindi nevoja e shtimit të të rinjve, intelektualëve dhe e klerikëve të diplomuar në vendet e botës islame në drejtimin e KMSH, si kërkesë e besimtarëve. Mes tyre kishte edhe ndonjë gülenist, të cilët u punësuan që herët në zyrat e KMSH, por pa pasur ndonjë post të rëndësishëm dhe pa u ndjerë asnjëherë zëri i tyre.”

gjithëpërfshirjen, përfaqësimin e denjë demokratik, pra legjitimitetin që parashikon statuti, dhe as nuk ndjekin kriteret e meritës në përzgjedhjen e njerëzve, por vetëm kriteret sektare. Përveç kësaj, për mbi dhjetë vjet ata nuk kanë përmirësuar gjendjen e mjerë të imamëve të xhamive, të cilëve u fillojnë rrogat nga 50 mijë lekë të vjetra në muaj dhe shumica e tyre as nuk kanë kontratë të rregullt pune dhe as siguracione edhe pse mund të kenë me vite në detyrë. Sigurisht që kanë edhe probleme fetare, por kryesorja është se ata nuk mund t'i imponohen besimtarëve muslimanë si përfaqësues të tyre, ndërkohë që nuk janë zgjedhur prej tyre, duke shkaktuar madje edhe probleme të tilla si ajo me shtetin turk. P.sh. populli dhe shteti turk kanë investuar për ndërtimin e xhamisë së madhe të Namazgjasë, por ata nuk duan t'ia dorëzojnë atë KMSH aktuale, e cila përbëhet nga gylenistë, njerëz që ata i konsiderojnë të lidhur me një grup që akuzohet për puçin ushtarak të 2016-s në Turqi”.

Hoxha “rebel” i praktikave të ndjekura në Komunitetin Mysliman thotë se përbërja gyleniste e KMSH paracakton zgjedhjen e kryetarit të këtij komuniteti. Vijon argumentin duke thënë se kjo situatë është e qartë dhe e njohur nga imamët dhe myftinjë. “Vetëm një i jashtëm dhe i painformuar mund ta mohojë, ose një i pamoralshëm, siç janë në këtë rast gylenistët”.

Për investimet gyleniste në vend ai thotë atë që flitet kudo. “Duke u nisur nga personat dhe fondacionet gyleniste që i zotërojnë, investimet janë të shtrira në arsim, nga ai fillor e deri tek arsimit i lartë, dhe që përbën investimin e tyre më të madh në vend. Kanë investime në median elektronike dhe atë televizive, në mjekësi dhe disa biznese të tjera. Në disa nga këto biznese ata janë pronarë të vetëm dhe në disa të tjera me ortakë vendas ose të huaj”.

DILEMAT GYLENISTE TË ERDOGAN

Kur kanë kaluar 6 vite nga ‘grushti i shtetit’ që gylenistët i bënë sistemit të Erdoganit nën petkun e opozitës, kur janë lëshuar me qindra e mijëra urdhër-arreste në të gjithë botën për ‘armiqtë’ e pushtetit të Erdogan, kur në vende si Shqipëria dhe Kosova ai vijon të vërë kushte për gjetjen dhe dorëzimin e ‘terroristëve gylenistë’, kur gylenistët, ata që mundën të shpëtonin nga kthetrat e dhunës shtetërore kanë kërkuar strehime politike nëpër vende të ndryshme, kur shtete si ky i joni bëjnë be dhe rrufe që brenda kufijve tanë nuk ka asnjë terrorist-gylenist, atëherë lindin dilemat e mëdha mbi kërkesat e Erdogan: A mos i do mbrapsht gjithë investimet që mbajnë gylenizmin në themele të binzeseve në vendin tonë? A mos ka një listë individësh apo biznesesh që ua ka lënë autoriteve tona në duar dhe këta nuk e



MËSUESI QË U DEPORTUA NË TURQI

Harun Çelik, mësuesi 42 vjeçar pati një fat të ndryshëm nga mësuesi i gjeografisë. Ai u arrestua ndërsa hynte në Shqipëri nga Turqia me një vizë false kanadeze në 8 korrik 2019. Me gjykim të shkurtuar u dënua me 8 muaj e 20 ditë burg dhe doli nga burgu në 1 janar 2020. Por sapo la qelinë e burgut, u deportua menjëherë. Informacionet janë se menjëherë pas lirimit nga burgu ai u ndalua nga shërbimi sekret turk që e mori me avion të posaçëm menjëherë për ta deportuar drejt Turqisë. Avokati mbrojtës i mësuesit nuk dinte gjë dhe deklaroi se Çelik kishte aplikuar për azil. Por, mësuesi nuk e pati këtë fat. U deportua në Turqi ku akuzohet si pjesëmarrës në një organizatë terroriste.

kanë zbatuar? Sa seriozisht e ka betejën edhe brenda vendit të tij, me anëtarët e deklaruar të kësaj lëvizjeje?

Për të gjitha këto dyshime jep përgjigje të qartë biseda me një ish-zyrtar shqiptar që ka punuar në një nga administratat shumë afër Erdogan. Ai shpjegon me pak fjalë se armiqësia mes Erdogan dhe Gylen është armiqësi mes miqsh, miq interesash dhe pushtetesh. “Ata ishin shokë! Erdogan erdhi në pushtet nga qarqet dhe investimet gyleniste. Sigurisht që ata ishin më të shkolluar, sepse investimet e Gylenit kanë bazë shkollimin. Ndaj gjendeshin në krye të shumë sipërmarrjeve. Por ka një dallim thelbësor mes zyrtarëve gylen dhe mbështetësve në popull të Gylenit. Si të thuash, në Shqipëri, opozitarët që s’rrinë kurrë jashtë pushteti me ata që kur janë në opozitë nuk munden dot të sigurojnë as mbijetesën. Kështu ka ndodhur fiks me gylenistët! Ata sot janë të pabukë, por ka gylenistë sërish në pushtet. Madje i fundit u emërua në fundin e janarit në krye të dikasterit të Drejtësisë. Bëhet fjalë për një nga ithtarët më të mëdhenj të doktrinës dhe filozofisë gyleniste. Quhet Bekir Bozdağ. Në administratën e parë të Erdoganit ishte zëvendëskryeministër, më vonë ministër Drejtësie. U hoq dhe i rimor prapë. Pra nuk është e njëjta gjë, si për masat si për



INVESTIGIMI

personat me lidhje me pushtetin! Pra praktikisht Erdogan e ka ulur luftën me një pjesë të tyre”.

Lidhur me gylenistët që kërkon Erdogan në vendin tonë, ai thotë qartë se presidenti Turk e di çfarë kërkon. Ish-zyrtari thotë se gylenistët që morën pjesë në grushtin e shtetit nuk qëndrojnë në Shqipëri pasi ata kërkojnë vende ku kanë besim dhe shtet të fortë. Shqipëria, në optikën e tij, nuk ka asnjërin. “Pra, një gylenisti, flas nga këta që janë të kërkuar ndërkombëtarisht nuk ka çfarë i ofron Shqipëria, duke parë pafuqinë përballë Erdogan, sidomos me investimet që ai ka ndërmarrë së fundmi atje. Unë di që në fillime, para disa vitesh është dërguar një listë me emra. Nuk jam i sigurtë nëse ishin turq apo shqiptarë, por di që aty ka investime të të dy palëve. Erdogan, kërkon personat që drejtojnë bizneset gylene, dhe s’janë pak, por e para, ata kanë vite aty dhe e dyta shumë biznese të njohura tashmë janë me pronarë shqiptarë, që Shqipëria nuk ka pse ia dorëzon si ‘terrositë’ Turqisë, sepse ata s’janë terroristë edhe nëse janë njerëzit e besuar të fondacioneve të Gylenit”.

PIKAT KU THYHET ‘VËLLAZËRIA’ RAMA-ERDOGAN

Në një dalje publike dhjetë ditë pas vizitës së Erdogan në vendin tonë, kryeministri Edi Rama dha një përgjigje hermetike në lidhje me kërkesën e vazhdueshme të Erdogan për t’i dorëzuar gylenistët që gjenden në vendin tonë. Rama nuk tha asnjë fakt konkret, por u fsheh pas një përgjigjeje diplomatike kur shtoi: “Fjalët janë shumë të rëndësishme prandaj duhen dëgjuar siç thuhet. Parakusht vëllazërie është t’i thuash mikut të vërtetën, sado e hidhur të jetë ajo. Kjo lidhet me thënien e një të vërtete mbi çështjen, jo parakusht vëllazëria. Duhet të bëni diçka e thotë vazhdimisht, ne e dëgjojmë me respekt dhe nuk kemi ndenjur me duar të lidhura. Kemi pasur persona problematik në raport me shtetin shqiptar dhe kemi vepruar. Qasja në fjalë do të thotë që kjo është një organizatë që atë që e bëri atje, mund ta bëjë edhe këtu. Ne nuk kemi pasur të dhëna. Për elementë të caktuar që nuk paraqiten në rregull në raport me legjislacionin, patjetër”.

Por çfarë i ka kërkuar në 6 vite, Erdogan - Ramës? Në vitin 2016, ambasada turke në Tiranë i dërgoi një shkresë Ministrisë së Arsimit, që të ndalojë vendosjen e simboleve të Turqisë dhe flamurit në shkollat në Shqipëri, pasi ata pretendonin se disa prej atyre shkollave kanë lidhje me Gylenin. Pas kësaj shkrese, simbolet u larguan. Më pas Erdogan dha urdhër që shkollat e lëvizjes ‘Gylen’ të mbyllën. Rama refuzoi duke i bërë me dije se shkollat ishin të licensuara dhe përbushnin standartet. Pak më vonë, Erdogan kërkoi edhe mbylljen e disa medreseve si në Tiranë, Shkodër, Durrës, Kavajë, Elbasan,



Presidenti i Turqisë, Erdon dhe kryeministrisë i Shqipërisë, Edi Rama

Berat dhe Korçë. Në listë u tha se gjendeshin edhe kolegjet si: “Mehmet Akif”, “Hasan Riza Pasha” në Shkodër, Kolegjet “Turgut Ozal” në Tiranë dhe Durrës, Kolegji Gulistan, qendra e kurseve “Meridian”, Fondacioni i edukimit “SEMA”, shkolla në gjuhën angleze, “Memorial International School of Tirana”, Universitetet “Bedër” dhe “EPOKA” dhe qendrat kulturore, “Horizontet e Reja” dhe “Drita Islame”! Të gjitha këto shkolla thuhet se u listuan nga Erdogan si financime të armikut të tij dhe ato duhet të mbylleshin, ndërsa ende nuk dihen emrat e personave që janë mbyllur në zarf dhe janë dorëzuar në zyrën e shefit të qeverisë shqiptare.

Në muajin maj të vitit 2017, pra rreth një vit pas grushtit të shtetit, konkretisht në datat 24-25 maj, në vendin tonë u bë një takim mes prokurorëve të rajonit e më gjerë. Objekt i diskutimeve ishte lufta e përbashkët e krimit që gjenerohej përmes internetit. Në këtë takim mori pjesë edhe kryeprokurori Turk, i cili iu dha porosi homolëgëve të tij të Ballkanit për të kapur gylenistët që strehoheshin në vendet përkatëse. Ish-kryeprokurori shqiptar, Adriatik Llalla la të kuptohej se mund të gjendeshin persona të tillë të strehuar në Shqipëri, mbase edhe të fshehur pas bizneseve, por ai nuk dha emra: “Dyshimet janë se po. Dyshimet e autoriteteve turke janë se autorët e këtyre veprave penale të këtij grushti shteti mund të jenë edhe persona që fshihen pas bizneseve. Emrat nuk mund të bëhen publik që në këtë fazë. Të dhënat janë të plota, pritet vetëm verifikimi nga ana jonë. Në varësi të të dhënave që na vihen në dispozicion nga autoritetet turke, ne do të kryejmë hetime brenda kapaciteteve që kemi, pra brenda atyre hapësirave që ligji shqiptar e lejon”.

* * *

...Që prej asaj kohe nuk u fol më për takime konkrete mes institucioneve, por u fol gjerësisht për gylenistë, gylenizëm dhe për organizatën “FETO”, që Erdogan e ka pagëzuar si terroriste! Njohës të mirë të rrymës liberale të përndjekur tashmë nga Turqia, përfliteshin gjithmonë biznese që lulëzonin nën gylenizmin në Shqipëri. Gylenistët në Shqipëri, sipas pretendimeve të shtetit Turk, nuk janë turq, janë shqiptarë, që jetojnë, punojnë dhe kontribuojnë në vendin tonë. Turqit janë turq, janë të veshur me petkun e investitorit, e duket se pak rëndësi ka se kujt i përkasin erdoganizmit apo gylenizmit! Për sa kohë hedhin para dhe nuk bëjnë ‘sherre’ ata janë të mirë, të pranueshëm dhe vëllëzër pa parakushte..!



Fethullah Gulen



DHURO
PËR NJË BUZËQESHJE!

FUQIZIMI I SHOQËRISË DHE INOVACIONIT



E-mail: info@smile.al



Dogana Morinë

KOSOVË-SHQIPËRI

TREGTI E PENGUAR, INVESTIME TË BLLOKUARA

Një realitet i trishtë që duhet të ndryshojë, 90 marrëveshje që janë firmosur mes dy vendeve dhe investimet e mëdha strategjike ngecin; asnjë nga qeveritë nuk punon t'u vijë në ndihmë investorëve të mëdhenj; pse pengohet resorti “Mështenka” në Brezovicë si një hakmarrje ndaj një politikani si Veton Surroi



| Nga **FATOS ÇOÇOLI**

Në prag të 15 viteve të ekzistencës së shtetit më të ri evropian, atij të Kosovës, që nga themelimi i tij më 17 shkurt 2007, janë realizuar 90 marrëveshje bashkëpunimi të qeverisë sonë me atë kosovare (në nivel të kryeministrit, ministrave, doganave, drejtorëve të tjera qendrore, bashkive, etj.).

Bashkëpunimi ekonomik mes Kosovës dhe Shqipërisë ende vuan nga shumë moskuptime, mungesë informacioni dhe vullneti real mes të dyja palëve, përtej deklaratave butaforike patriotike. Nga të 90 marrëveshjet e deritanishme, të nënshkruara me qeverinë e Kosovës, një pjesë e mirë janë dakordësime në fushën e shkëmbimeve ekonomike mes të dyja vendeve.

Mirëpo, me gjithë deklaratat zemërdhënëse, historia e procedurave dhe pengesave

Trau mes Shqipëri-Kosovë



TABELA 1. TREGTIA SHQIPËRI-KOSOVË

KOSTO NJË KAMION 10 TON PËR NË KOSOVË

➤ Kosto tregtare (karburant, shofer, amortizim)	220 euro	(61%)
➤ Kosto dokumentash (Çert Vet Kos; Çert Vet Shqip; Agjenc Dog Kos Agjenc Dog Shqip; Autostrada, Skaner)	140 euro	(39%)
TOTALI:	360 EURO	

PROBLEMET TREGTARE ME KOSOVËN

- Kërkesat për noterizim të analizës fitosanitare
- Kosto për skanerin në doganë
- Çmimet referencë
- Kosto për tarifë rrugore
- Korrupsioni nga oficerët doganorë
- Mungesa e besimit te partnerët në biznes
- Akciza diskriminuese në sasi të alkoolit

TREGTIA E LIRË SHQIPËRI-KOSOVË EVITON:

- Biznesi nga të dyja anët e kufirit nuk do të detyrohet më të paguajë 35 euro për deklaratën doganore
- 10 euro për parking doganor në Shqipëri, 40 euro për parkim doganor në Kosovë
- Shumë taksa e kosto të tjera.
- Mbi të gjitha, nuk humbet kohë, orë të tëra pritjeje sa të marrë dokumentet.

burokratike dhe doganore me Kosovën është e trishtë dhe ende qëndron kokëfortë mbi traumën e dyja vendeve.

Edhe për një kamioncinë të ngarkuar me fruta e perime në vlerën 1 mijë euro, tregtari apo sipërmarrësi i Shqipërisë apo Kosovës duhet të paguajë 250 euro taksa e pagesa të tjera të detyrueshme.

Vetë praktika e derisotme e regjimeve doganore të të dyja vendeve tona, i detyron pronarët e kamioncinave të bëhen kontrabandistë me zor, nëse duan të bëjnë tregti!

“Ne eksportojmë në shumë vende të Bashkimit Evropian, por më shumë ka pengesa kur eksportojmë në Shqipëri sesa në BE”, deklaroi Bedri Kosumi, një sipërmarrës eksportues nga Kosova.

Sipas një studimi të ndërmarrë nga Qendra e Eksporteve e Shqipërisë, tarifët doganore dhe pengesat burokratike në pikat e kalimit kufitar janë arsyt e mosrritjes në nivelin e pritshëm të tregtisë mes dy vendeve. Qendra gjeti se për të eksportuar mallra nga Shqipëria në Kosovë dhe anasjelltas, praktika kushton minimalisht 250 euro. Këtu përfshihen deklaratat doganore, certifikatat e produktit, analizat e mallit, kosto e skanerit për Shqipërinë, kosto e parkingut doganor në Kosovë, por edhe në Shqipëri, si dhe taksa e Rrugës së Kombit.

ZGJIDHJA PËR PENGESAT TREGTARE

Qendra e Eksporteve e Shqipërisë propozon edhe zgjidhjen e këtij ngërçi, një program kompjuterik që duhet të zbatohet nga të dyja administratat doganore, i cili kushton vetëm 50 mijë euro. Ai regjistron momentin kur biznesi në Shqipëri, për shembull biznesi i vogël i fruta-perimeve, ngarkon kamionin ose kamioncinën e vet për të eksportuar drejt Kosovës. Ai automatikisht pret faturën ku shënon NIPT-in e sipërmarrjes Kosovë që do të marrë mallin. Programi realizon transmetimin online të faturës së regjistruar në Kosovë. Dhe kështu e dërgon informacionin drejtpërdrejt në Drejtorinë e Tatimeve të Kosovës. Dogana ka nevojë për një lexues vetëm për bizneset, që të lexojë bar-kodin e faturës për llogari të sipërmarrjes pritëse të mallit në Kosovë, si dhe

anasjelltas në Shqipëri. Kështu biznesi nga të dyja anët e kufirit nuk detyrohet më të paguajë 35 euro për deklaratën doganore, 10 euro për parking doganor në Shqipëri, 40 euro për parkim doganor në Kosovë, si dhe shumë taksa e kosto të tjera! Dhe mbi të gjitha, nuk humbet kohë, orë të tëra pritjeje sa të marrë dokumentet e kërkuara. Kjo është mirëfilli qasja “bashkë pa kufi”. Kaq e thjeshtë është. Dhe ka 14 vite që nuk zbatohet! Këto pengesa burokratike dhe pagesa të kripura doganore e kanë lënë potencialin e rritjes me herë të

Biznesi nga të dyja anët e kufirit nuk detyrohet më të paguajë 35 euro për deklaratën doganore, 10 euro për parking doganor në Shqipëri, 40 euro për parkim doganor në Kosovë, si dhe shumë taksa e kosto të tjera! Dhe mbi të gjitha, nuk humbet kohë, orë të tëra pritjeje sa të marrë dokumentet e kërkuara.

Pas kryerjes së investimit fillestar prej 4.5 milionë euro dhe realizimit të 150 shtretërve të parë, kompanisë i bllokohet investimi për 350 shtretërit e tjerë dhe vihet përpara sulmeve të një segmenti të administratës politike në Kosovë, saktësisht Ministrisë së Mjedisit. Në fund të vitit 2018, një inspektim i përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit të Kosovës i bllokoi punimet që po realizonin pjesën tjetër të investimit në resortin “Mështenka”

marrëdhënieve ekonomike mes të dyja vendeve tona thjesht potencial. Pavarësisht nismave nga të dy qeveritë tona në vitet e fundit, si sporteli i përbashkët në doganën e Morinës, apo zyra doganore e Kosovës në Portin e Durrësit, etj., si dhe marrëveshjeve të shumta të nënshkruara, kostot dhe burokracitë doganore qëndrojnë si Shpata e Damokleut mbi të ardhmen e marrëdhënieve tona tregtare dhe ekonomike, duke zbehur çdo nismë e lëvizje në nivel politik e qeveritar.

90 MARRËVESHJE, POR INVESTIME TË BLOKUARA!

Përfaqësues të prodhuesve në Kosovë kanë pohuar se autoritetet e Shqipërisë po i pengojnë bizneset nga Kosova që të jenë më të pranishme në tregun e Shqipërisë. Sipas tyre, prodhuesve nga Kosova ju paraqiten barrierat tarifore dhe jotarifore, si rasti i akcizës së birrës, pastaj procedurat e zhdoganimit në Shqipëri, pagesa e skanerit, noterizimi i analizave, mosmarrja për bazë e çmimit të faturës nga Dogana Shqiptare e shumë pengesa tjera, që sipas prodhuesve, po dëmtojnë konkurrueshmërinë e produkteve të Kosovës në Shqipëri.

Në tetor 2021, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) matën në një pyetësor qëndrimet e qytetarëve të Kosovës dhe Shqipërisë, përse u përket marrëdhënieve mes dy qeverive. Më shumë se 60 për qind e të anketuarve deklaruan se marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet dy qeverive nuk kanë pasur

ndonjë ndikim në jetën e përditshme.

Edhe nga ana e investuesve të Shqipërisë në Kosovë, megjithë fluksin e rritur në vitet e fundit, përpjekjet e tyre po përballen me probleme të mprehta. Kaluan tre vjet dhe në pikën turistike të Brezovicës në Kosovë, qëndron i bllokuar një investim i rëndësishëm nga Shqipëria, me vlerë

22 milionë euro.

Kompania “Stella Consulting”, ndër investuesit kryesorë në resortet turistike në Shqipëri, me një kapacitet 1 mijë e 350 shtretër të nivelit 4 dhe 5 yje, ju përgjigj thirrjes së qeverisë kosovare për investime të huaja në Kosovë dhe interesit të saj për të plotësuar gamën e projekteve në turizëm, me një projekt në resort malor.

Pas kryerjes së investimit fillestar prej 4.5 milionë euro dhe realizimit të 150 shtretërve të parë, kompanisë i bllokohet investimi për 350 shtretërit e tjerë dhe vihet përpara sulmeve të një segmenti të administratës politike në Kosovë, saktësisht Ministrisë së Mjedisit. Në fund të vitit 2018, një inspektim i përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit të Kosovës i bllokoi puni-

Resort turistik
në Brezovicë





Resorti "Mështenka" Stella Consulting,
investim i bllokuar

dhe ndërtimin në një zonë të ndaluar janë absurde. Realisht investimi nuk ndodhet në zonat e ndaluara për ndërtim, por brenda zonës së poshtme nën 1000 m lartësi mbi nivelin e detit, ku janë zhvilluar vila që në formimin historik të zonës turistike residenciale në Brezovicë, në kohën e Jugosllavisë së Josif Broz Titos, në vitet 80-të të shekullit të kaluar.

met që po realizonin pjesën tjetër të investimit në resortin "Mështenka".

Inspektimi i përgjithshëm, pasi verifikoi gjendjen e të gjitha ndërtimeve në Brezovicë, në një mënyrë shumë selektive dhe politike dhe pa asnjë argument ligjor, veçoi investimin e kompanisë nga Shqipëria, duke e bllokuar atë, pavarësisht paraqitjes së të gjitha lejeve ndërtimore nga kjo e fundit.

Këtu fillon kalvari i abuzimit politik me investitorin e huaj "Stella Consulting". Prej datës së pengimit politik (quhet i tillë, pasi nuk u paraqit asnjë dokument juridik, administrativ, apo ligjor që të justifikonte veprimin e ndërmarrë, pavarësisht se kompania investuese i kërkoi me insistim arsyet ligjore të tij), investimi i kompanisë, i bllokuar prej më shumë se tre vjetësh, tashmë po shkatërrohet çdo ditë në kuptimin teknik, financiar dhe moral. Strukturat e lëna pa mbaruar po dëmtohen në mënyrë të parikuperueshme. Dëmi teknik dhe financiar i shkakton nga bllokimi politik i investimit është i jashtëzakonshëm, pasi bankat, të kërcënuara nga shantazhi politik, kanë kërkuar kthimin e kredive.

Arsyeja politike e persekutimit dhe bllokimit të investimit nga Shqipëria qëndron në faktin se partner në kompaninë "Stella Consulting" është personaliteti i Kosovës, Veton Surroi, i cili ka qenë opozitë serioze e disa partive politike në pushtet në Kosovë dhe ka denoncuar sistematikisht korrupsionin dhe mungesën e ligjshmërisë në sjelljen e qeverive kosovare.

Pretendimet për shkeljen e lejes së marrë nga komuna e Shterpcës (që në fakt e mori një nënkontraktor lokal, kompani kosovare)

Bllokimi i punëve të kompanisë i kushton ekonomisë së Kosovës mbi 800 mijë euro taksa të munguara në vit dhe qindra vende pune. Nga ana tjetër dhe dëmi më i madh, bllokimi i investuesit nga Shqipëria është kundër intereseve të Kosovës, sepse dëmton rëndë imazhin e Kosovës, si një ekonomi ku mund të investohet dhe ku mbrohen investimet e huaja.

Sulmet dhe bllokimi i investimit prodhojnë demotivim të investuesve të huaj për të rrezikuar kapitalet e tyre në Kosovë, dhe për më tepër, në një fushë me rëndësi strategjike, siç është turizmi i Kosovës. Nëse investitorët pengohen, bllokohen dhe paragjyken, duke u dhunuar edhe verbalisht, atëherë edhe interesat ekonomike të qytetarëve të Kosovës linçohen, paragjyken dhe dhunohen. Kosova nuk mund të jetë një kurth për investitorët e huaj dhe sidomos ata shqiptar. Kriminalizimi i investitorëve të huaj për arsyen se ata gjenden me investimet e tyre në një kurth të tillë korruptiv të administratës lokale dhe kombëtare nuk është sulm ndaj korrupsionit por ndihma më e madhe që mund t'i bëhet atij. Ky është limiti i cili nuk duhet shkelur.

Qeveria e Kosovës e ka të gjithë kohën dhe mundësitë të riparojë imazhin e dëmtuar dhe të vendosë drejtësi, duke zhbllokuar investimin dhe lejuar investuesin nga Shqipëria të plotësojë 500 shtretër të nivelit 4 dhe 5 yje në Brezovicë. Investuesi shqiptar, edhe pse i sulmuar me pa të drejtë dhe në dëm të rëndë financiar nga bllokimi, është i vendosur ta përfundojë investimin si një investim që e çon përpara ekonominë e Kosovës dhe raportin ekonomik midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Sulmet dhe bllokimi i investimit prodhojnë demotivim të investuesve të huaj për të rrezikuar kapitalet e tyre në Kosovë, dhe për më tepër, në një fushë me rëndësi strategjike, siç është turizmi i Kosovës



| Nga FATOS ÇOÇOLI

Më 21 nëntor 2021, qeveria e Maqedonisë së Veriut i ngriu çmimet për karburantet dhe më 4 dhjetor 2021 ngriu edhe çmimet për produktet ushqimore bazë, deri në fund të janarit 2022. Me fjalë të tjera, vendosi një çmim tavan, duke e fiksuar atë në momentin kur mori vendimin (21 nëntor për naftën dhe 4 dhjetor 2021 për ushqimet bazë). Përtej këtij çmimi, asnjë subjekt ekonomik në vendin fqinj nuk mund të ngrejë çmimin, ndryshe përballet me gjoba të rënda deri në pezullim të aktivitetit.

Më 28 janar 2021, qeveria e vendit fqinj, duke parë përshkallëzimin e çmimeve të mallrave ushqimore dhe të naftës në botë, e shtyu ngrirjen deri në fund të shkurtit 2022.

Një çmenduri! Nafta në Shqipëri është pesë herë më e lartë sesa në botë! Qeveria rri dhe vështron e nuk merr asnjë masë. As kontrole të shtuara e as ndalim të abuzimit në treg. Tabelat krahasuese me rajonin dhe si e kanë zgjidhur fqinjët e Maqedonisë rritjen e çmimit të karburantit...

TABELA 1. ÇMIMET TAVAN PËR PRODUKTET BAZË USHQIMORE DHE KARBURANTET NË MAQEDONINË E VERIUT:

Buka e bardhë	29 denar= 57.37 lekë	në Shqipëri 100-120 lekë
Sheqer 900 gr	40 denar = 79.14 lekë	në Shqipëri 80 lekë
Vaj për gatim	66 denar= 130.58 lekë	në Shqipëri 200- 220 lekë
Qumësht me yndyrë 3.2%	52 denar = 102.88 lekë	në Shqipëri 150 lekë
Nafta për litër	66.5 denar= 131.57 lekë	në Shqipëri 192 lekë

I. PO NË SHQIPËRI? TEK NE ORTEK ÇMIMESH TË RRIURA. QEVERI INDIFERENTE

Në korrik 2021, me rritjen e konsiderueshme të kostove të transportit dhe të lëndëve të para






bujqësore, sidomos miellit e qumështit në tregjet botërore, nis kalvari i rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore jetike edhe për familjet shqiptare. Për periudhën gusht 2021-shkurt 2022, pra për vetëm gjashtë muaj, çmimet e shportës dhe të mallrave të tjera ushqimore bazë tek ne u rritën shumë fort, si në Grafikun 1 më poshtë:

GRAFIK 2

ÇMIMET E RRITURA NDJESHËM JANAR 2021-JANAR 2022



Sipas INSTAT, produktet ushqimore zënë
38% të shpenzimeve tona familjare.

Deri tani, qeveria jonë rri e vështron dhe nuk ka marrë asnjë masë. As edhe kontrollin e rriturës për të frenuar abuzimet në treg. Nga shumë OJF dhe qytetarë, në media, janë breshër denoncimet për bukën e shitur nën gramaturë edhe me çmimin e rritur, për qumështin dhe nënproduktet e paketuara të tij, shumica të shitura nën peshën standard.

Nëse institucionet shtetërore do të kishin kurajon të publikonin bilancin e gjashtë muajve të fundit në gjopa të vendosura në treg për mallrat ushqimore dhe naftën, ai do të ishte po i njëjti, në mos më i vogël se bilanci dhe shifrat e muajve janar-qershor 2021, përpara fillimit të ortekut të çmimeve.

II. NAFTA NË SHQIPËRI, MË E SHTRENTJA NË BOTË PËR FUQINË BLERËSE TË QYTETARIT, ME BARRËN FISKALE MË TË LARTË NË EVROPË

Rekordi historik i çmimit të naftës tek ne në ditët e para të shkurtit 2022, me 192 Lek/litër, tregoi edhe njëherë politikën pa kokë të çmimit të këtij malli jetik për popullatën, edhe duke qenë vend prodhues naftë. Në Evropë zëmë vendin e parë për barrën fiskale mbi një litër naftë pa TVSH.

Renditemi ndër 10 vendet në botë, me çmimin më të lartë në vlerë absolute të naftës për litër. Ndërkohë kur për fuqinë blerëse të qytetarit zëmë vendin e 109-të! Dhe jemi në “pole position”, kemi vendin e parë në botë për çmimin më të lartë të naftës për fuqi blerëse të qytetarit! Sa tregues i trishtë!

**TABELA 2. BARRA E TAKSAVE
MBI NAFTËN(PA TVSH)**

Në përqindje euro/litër naftë

Mali i Zi	0.44 euro/litër
Bosnje-Hercegovina	0.35 euro/litër
Maqedonia e Veriut	0.26 euro/litër
Kosova	0.36 euro/litër
Serbia	0.48 euro/litër
Shqipëria	0.63 euro/litër

ABUZIMI ME NAFTËN 1

Në Shqipëri grosistët e naftës reagojnë menjëherë nëse nafta pëson rritje, ndonëse kompanitë tregtare shesin naftën, të cilën e kanë blerë më parë me çmime më të ulta. Thënë thjesht, nafta që shitet sot në pikat e karburantit në Shqipëri është blerë të paktën 2 javë më parë në tregjet ndërkombëtare. Edhe pse duhej të kishin rezerva strategjike 3 muaj për naftën, grosistët tanë nuk e zbatojnë asnjë herë këtë detyrim ligjor.

Por edhe me vetëm dy javë naftë stok, çmimi naftës në Shqipëri duhej të ishte i pandryshuar, 180 Lek/litër, dhe jo 192 Lek sa është sot. Kjo, ngaqë dy javë më parë, çmimi i naftës në tregjet botërore ishte 87 USD fuçia dhe jo 90 USD, sa është sot. Pra, në tregjet

ELEMENTET E ÇMIMIT TË NAFTËS NË SHQIPËRI 2022

8 TAKSAT MBI 1 LITËR NAFTË



kur një kompani grosiste u penalizua me 6.7 milionë Lek (55 mijë euro) për abuzim me pozitën dominuese në tregun e ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm dhe të naftës në rrugë detare.

ABUZIMI ME NAFTËN 2

Qeveritë tona i janë qepur me taksa çmimit të naftës, si liane të harbuara një trangu plepi, duke e tharë sa rrezikon të rrëzohet përtokë. Janë tetë taksa që i shtohen çmimit të naftës tek ne. Më shumë nga të gjitha vendet e tjera evropiane! Qeveria të paktën të hiqte indeksimin e akcizës!

Vlera e produktit është vetëm 70 lekë, ndërsa 122 lekë në një litër naftë janë taksa, që qytetarët i paguanë jo vetëm për qeverinë, por edhe për koncesionarët privatë. Kjo është dhe arsyeja kryesore se pse Shqipëria renditet ndër 10 vendet me çmimin më të lartë të naftës në botë, në vlerë absolute. Nëse krahasohet sipas fuqisë blerëse të qytetarëve, Shqipëria është vendi ku karburanti kushton më shtrenjtë se kudo tjetër në planet.

Ç'DUHET BËRË?

PO SIKUR TË NGRIJMË DHE NE ÇMIMET?

Së pari dhe menjëherë, qeveria duhet të heqë indeksimin e akcizës së naftës me inflacionin, i cili e ka ngritur me 10 lek çmimin që nga 1 janari 2022.

Së dyti, edhe pse shumë vonë, t'i ngrijë tani çmimet e produkteve ushqimore bazë dhe të naftës. Ç'do të ndodhë? Asgjë. Do të ndihmohemi si qytetarë, njëlloj sikurse po u ndodh në këto tre muaj tejet të vështirë (dhjetor 2021-shkurt 2022) qytetarëve të Maqedonisë së Veriut.

ndërkombëtare çmimi i një fuçie naftë u rrit me 3 USD gjatë dy javëve të fundit.

Një fuçi naftë ka 158 litra. Nëse do të përllogarisim rritjen për litër bazuar në rritjen e çmimit për fuçi, rezulton se rritja e një litri naftë në botë është vetëm 0,018 USD ose 2.1 lekë. Bazuar në këtë llogaritje, në Shqipëri nafta u rrit me 10 Lek, pra me 5 herë më shumë se shtimi mesatar në botë!

Tregu i naftës në vend ka qenë vazhdimisht në qendër të kritikave dhe është hetuar disa herë për "marrëveshje karteli" mes grosistëve. Megjithatë, ndërhyrjet e autoriteteve nuk kanë dhënë ndonjëherë rezultat. Një hetim i Autoritetit të Konkurrencës për periudhën janar 2017-2020 përfshiu tre koncesionarë të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të karburanteve që vijnë nga jashtë. Asnjë rezultat i dukshëm. Asnjë gjobë.

Gjoka e fundit në këtë treg i takon vitit 2012,



Historia flet, tradita vazhdon!



Kantina Gjergj Kastrioti Skenderbeu - Durrës



kantinaskenderbeu

E-Mail: info@kantinaskenderbeu.al / Mob: 068 20 91 886 / Web: www.kantinaskenderbeu.al



Skenderbeu Bytca castle
wall paintings digitisation project

SKËNDERBEU

KALORËSI FISNIK I KRISHTERË, “PUSHTOI” EVROPËN ME BËMAT E TIJ

| Nga DR. DORIAN KOÇI

Epopeja e madhe e Gjergj Kastriot Skënderbeut, përveçse ndikimeve gjeopolitike që pati në rajon ka meritën se solli në vëmendje të Perëndimit sërish Arbërinë, nëpërmjet thirrjeve për ndihmë krijimin e aleancave dhe mobilizimin kulturor, moral dhe fetar ndaj osmanëve që po mundoheshin nëpërmjet pushtimeve të ashpra të asimilonin brenda perandorisë së tyre këto territore. Në Arbëri, ku bëhet rezistencë zbarkojnë vullnetarë dhe trupa ushtarake napolitanë, katalanë, gjermanë dhe anglezë të gjithë të përbetuar për të luftuar osmanët dhe për të mbrojtur Evropën dhe krishterimin. Edhe pse numri i tyre nuk është i përfillshëm për të ndaluar valën e pushtimit otoman, letrat dhe kancelaritë që përfaqësojnë, idetë dhe kulturën që sjellin bëjnë të mundur që ideja e Evropës në Arbëri dhe të një territori kontinuiteti me Evropën të konkretizohet nëpërmjet aleancave të ndryshme që ata i kërkojnë Papës së Romës

për të udhëhequr luftën kundër osmanëve.

JEHONA E MOTIT TË MADH NË POLONI

Jehona e Motit të Madh të arbërëve u ndie jo vetëm në Venedik, Mbretërinë e Napolit dhe vendet fqinjë, por edhe në Evropën Qendrore dhe gjermanike. Nuk është fort e qartë nga burimet historike nëse këto marrëdhënie diplomatike u shoqëruan me ardhjen e kontigjenteve ushtarake polake, çeke, hungareze apo sllovake për ta mbështetur rezistencën arbëre ashtu si Barleti përmend për gjermanët apo dhe britanikët, por e rëndësishme është se jehona e veprës dhe aksionit proevropian të Skënderbeut filloi të ndihej gjithnjë e më tepër në Evropën Qendrore dhe vendet gjermanike. Kështu afërsisht një shekull më vonë pas vdekjes së heroit kombëtar të arbërëve, në vitin 1569, në Poloni u përkthye dhe u botua në gjuhën polonisht vepra e Marlin Barletit: “Historia e jetës dhe e

veprave të Skënderbeut”. Pas gjermanishtes dhe portugalishtes, polonishtja ishte gjuha e tretë që kjo vepër madhore e Barletit përkthej në një gjuhë të huaj. Libri i Marin Barletit është i rëndësishëm jo vetëm për të lexuar jetën dhe aktivitetin e Skënderbeut, por edhe pse jep një vizion të qartë të idesë së Evropës, nëpërmjet panigjirikeve për shpëtimin e Evropës apo përshkrimin e gjallë të territorit të osmanëve dhe zakoneve të tyre. Çdo qytet apo ngjarje në libër trajtohet njëherë nëpërmjet traditës greko-latine, por dhe i bëhet jehonë kërkesës për një unitet evropian kundër forcës shkatërruese të osmanëve. Kjo traditë humaniste munda të vazhdojë të zhvillohet në pjesën veriore të Ballkanit, Kroaci dhe Slloveni të cilat nuk ranë nën sundimin otoman dhe si pjesë integrale të Perandorisë së Shenjtë Austriake zhvilluan një profil të qenësishëm evropian së bashku me kombësitë e tjera të Evropës Qendrore deri në Çeki, Sllovaki, Hungari e Poloni. Vepra e Barletit, e cila gjatë shumë vjetëve ishte për historinë e vetmi burim që hidhte dritë mbi veprat e përmendura të heroit Shqiptar dhe në të cilën gjejmë lajmin e letërshtëmbimit fiktiv midis Vladislav Varnjençikut dhe Skënderbeut, u përkthye në polonisht prej Ciprijanit nga Seraxa dhe u botua në Brest në vitin 1569. Kjo vepër mbante titullin shumë të bukur: “Historia e jetës dhe veprave fisnike të Gjergj Kastriotit, të cilin zakonisht e thërrasin Skënderbe” (polonisht: Historia e Zyëoice i zacnych sprawach Jerzego Kastyote, ktogo pospolicie Slanderbegien zoëia). Në parathënien e tij të gjatë, përkthyesi e motivon domosdoshmërinë e këtij përkthimi me këto fjalë: *“Që unë t’i tregoj popullit fisnik polak vlerën e madhe të kësaj historie dhe trimërinë e Skënderbeut i ndërtova atij në polonisht këtë përmendore të përjetshme sepse ai me trimëritë e tij mund të vlejë me të vërtetë si një shëmbull për ata popuj*

që humbën lirinë, që të dinë ta rifitojnë përsëri atë liri ndërsa për ata që nuk e kanë humbur, të dinë ta mbrojnë atë ashtu siç diti ai”.

Ciprian Baziliku e çmoi shumë lart kujtimin e Skënderbeut “i cili brenda një kohë të shkurtër jo vetëm që ia ktheu lirisë vehten e tij dhe gjithë popullin e tij, por që ai i tmerrshëm për turqit sa këta u detyruan t’i luten më në fund që të bashkohej me ta”. Gjithësesi jeta dhe vepra e Skënderbeut nuk është se ishin të panjohur në Poloni. Pesë vite më parë, më 1564, kronisti dhe humanisti polak Marcin Bielski botoi veprën: “Mbi Skënderbeun e Maqedonisë, Princin Shqiptar”. Kjo është është një nga veprat e para origjinale që u shkruan nga të huajt për Skënderbeun. Tregimi mbi heroin e famshëm kombëtar shqiptar Skënderbeun, që është një fragment i ngjarjeve historike të luftërave të popujve të Ballkanit kundër turqve osmanë, ka gëzuar një popullaritet të jashtëzakonshëm në Europën e shekullit të XVI.

Shekulli i XVI vazhdonte të ishte shekulli i ballafaqimeve të mëdha e konflikteve midis Krishterimit dhe Islamit, midis formacioneve shtetërore evropiane dhe Perandorisë Otomane. Pushtimi i Kostandinopojës në 1453, shuarja e rezistencës shqiptare pas vdekjes së Skënderbeut, pranimet e vasalitetit nga pothuajse të gjitha mbretëritë, principatat apo dhe qytetet sollën si rezultat pushtimin e të gjithë gadishullit Ballkanik dhe largimin e tij nga Evropa. Në këtë përballje për jeta a vdekje nevojitej një unitet i botës së krishterë që në të shumtën e rasteve u gjet dhe në evidentimin e figurave historike që kishin rezistuar ndaj pushtimeve otomane. Mes këtyre figurave evropiane sigurisht që shquante Skënderbeu, ndaj figura e tij gjeti pasqyrim jo vetëm në letërsi por edhe në vepra të tjera arti. Në vitin 1609, në qytetin e Gdanskut, në fasadën e një prej godinave më të bukura të qytetit që quhet “Godina e Artë” është vendosur basorelievi i Skënderbeut që, sipas Prof. Ferit Hudhrit është i vetmi basoreliev i tij që është gjetur deri tani në fasadën e një ndërtese. Në fasadën e kësaj godine, ndërtuar në vitet 1609-1618, në tre kate të saj janë vendosur 32 basorelieve të njerëzve më të shquar të njerëzimit duke filluar që nga lashtësia. Në qendër të kësaj fasade, në katin e tretë, në mes është vendosur basorelievi i Skënderbeut, bashkë me basorelievin e Heroit Kombëtar të Hungarisë, Janosh Huniadi.

Po kështu jehona e veprës së Marin Barletit përkthyer në polonisht vazhdoi të frymëzonte shumë historianë e letrarë polakë që në rezistencën arbërore gjenin një shembull që duhej të ndiqej nga popullsia e Evropës Juglindore që kërcënoheshin drejt për së drejti nga pushtimi otoman. Mbështetur në veprën e Marlin Barletit, për historinë e Shqipërisë dhe për Skënderbeun, në shekujt XVI deri në shekullin XIX, në Poloni janë botuar mbi 40 libra në gjuhën polake, pa përmendur numrin e madh të vjershave kushtuar Skënder-

Ciprian Baziliku e çmoi shumë lart kujtimin e Skënderbeut “i cili brenda një kohe të shkurtër jo vetëm që ia ktheu lirisë veten e tij dhe gjithë popullin e tij, por që ai i tmerrshëm për turqit sa këta u detyruan t’i luten më në fund që të bashkohej me ta”. Gjithësesi jeta dhe vepra e Skënderbeut nuk është se ishin të panjohur në Poloni

beut. Poetë të shumtë polakë kanë shkruar vargje për Skënderbeun si Krzysztof Warshewicki, Adam Czachrowski, Jan Jurkowski, Marcin Paszkowski, Samuel Twardowski, Wacław Potocki, Flangment Kamjeński, etj. Mes tyre shquan në veçanti humanisti Krzysztof Warshewicki. Warszewicki botoi një numër punimesh, duke përfshirë një vepër me poezi, dhe veprën e tij të vetme në polonisht, *Wenecya* (1572), një libër udhëzues për në Venecia; veprat e tjera të tij ishin në gjuhën latine. Studiuesi Arqile Teta na ka sjellë disa vargje në shqip nga vepra “*Venecia*” që përshkruan mometin kur Skënderbeu kthehet në Krujë.

*“Dhe u rrit Skënderbeu në derë të Muratit
Që bëri sa s’kish bërë për të tjerë
Ndërsa Ai i kërkoi ofiq pronat e të atit
Por Murati dinak hodhi dyshime ndaj tij
Atëhere Skënderbeu dërgoi lajmëtarë
Ta prisnin besnikët me shpata në brez
Në kohën e duhur u sul me ushtarë
E morri qytetin dhe Kruja u ndez
Epiri u zgjua, u derdh i harbuar nga
Murati sulmoi me tërbim duke gulçuar
Por nën muret e Krujës mbeti krahëthyer
Dhe hyri Murati në shpellën e Bitinisë
Nga dhembja çfilitur dhe turpi i marë
Dhe hyri natën, tinëz, gjakosur dhe i dërmuar
Pa krenari, tituj, lavdi dhe ushtarë”.*

JEHONA E MOTIT TË MADH NË ÇEKI DHE SLOVAKI

Pavarësisht faktit se në dokumentacion historik nuk ka gjurmë të kontakteve diplomatike të drejtë për së drejta të Skënderbeut me diplomacinë bohemiane, rreshtimi që kjo e fundit bëri në kuadër të Perandorisë së Shenjtë Romake me qendër në Vjenë në shekullin e XVI-XVII e më vonë bëri të mundur që jehona e aksionit politik dhe qendresës arbëre të ndihej në botën kulturore e politike të Bohemisë. Vepra më e rëndësishme e humanizmit për jetën dhe veprën e Skënderbeut me titull “*Historia e Skënderbeut*” e shkruar nga Marin Barleti në gjuhën latine u përkthye më pas edhe në shumë gjuhë të botës. Deri më tani nuk kemi të dhëna nëse ajo është botuar në gjuhën çeke por egzistojnë dy botime të rëndësishme në dy gjuhë që elita bohemiane i përdorte si gjuhë kulture: gjuhën gjermane dhe gjuhën polake. Në gjuhën gjermane kjo vepër u përkthye nga Johann Pinicianus (1478 – 1542) dhe pati dy botime në 1537 dhe në 1578. Skënderbeu paraqitej në botën gjermanike pas një

kontrasti të madh kulturor që kishte formuar ndarja e Europës në dy pjesë pas invazionit osman. Në vitin e largët të 1450, kur Johanes Gutenberg shpiku shtypshkronjën, Kruja, kryeqyteti i Shqipërisë në kohën e Skënderbeut po vuante rrethimin e saj të parë nga Sulltan Murat II. Ishte koha kur Skënderbeu me fitoret e tij mbi osmanët filloi të kthehej në shpresën dhe vullnetin e Evropës. Skënderbeu mbrojtje me sukses Krujën kundër tre rrethimeve të organizuara nga Murat II dhe Mehmet II, dy nga pushtuesit më të tmerrshëm të asaj periudhe, që udhëhoqën ushtritë më të fuqishme në botë. Por në të vërtetë Skënderbeu ishte më shumë se sa thjesht një komandant i talentuar ushtarak; ai ishte gjithashtu një njeri i Rilindjes Evropiane dhe Humanizmit që po niste të shfaqej në atë kohë në Evropë. Veprimet e tij ushtarake kundër osmanëve ishin njëkohësisht edhe veprime kulturore dhe politike.

Burimet e para në gjuhën çeke për epokën e Skënderbeut janë të mesit të shekullit të XVI. Bëhet fjalë për dy vepra dhe disa fragmente veprash ku përshkruhet rezistenca arbëre dhe figura e Skënderbeut. Është fjala në radhë të parë për dy monumente të datuara aty nga mezi i shekullit XVI, pastaj për shënime të shkurtër të fundit të shekullit XVI, siç i gjejmë tek

Daniel Adham Veleshlavini dhe në versionin bohem të J. Leunklavius e më në fund për një tregim më të gjatë që i përket Shqipërisë të një autori bohem, shkruar në fillim të shekullit XVII dhe botuar në vitin 1609. Arbërit dhe Skënderbeu përmenden në veprën “*Historia neh kronika turecka ad Machala Konstandina z. Ostrovive*” . (Historia ose kronika turke e Mihal Konstandin Ostrovicës) që u botua në vitin 1565 në Leitomishl dhe për herë të dytë në vitin

1581. Në këtë vepër mbi figurën e Konstantinit të Ostrovicës së Novobërdës, një pjesë e madhe i kushtohet edhe Gjergj Kastriotit dhe veprave të tij heroike kundër pushtuesit turk. Kostandin Mihali i Ostrovicës, historian e ushtarak është dëshmitar i rëndësishëm i dramës së pushtimeve osmane sidomos në Novobërdë (Artana e sotme në Kosovë) dhe rrethinën e saj. Kostandini me memoarin e tij ka krijuar



BURIMET:

- **Jan Rejhman**, Shqiptarët në Poloninë e vjetër, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike (15-21 nëntor 1962), Tiranë 1965, faqe 517-518
- **Marcin Bielski**, Mbi Skënderbeun e Maqedonisë, princin shqiptar, shtypshkronja "ILAR", Tiranë 2018
- **Leonard Zisi**, Hyrje në dy tregime polake për Skënderbeun, botimet "Flesh", Tiranë 2018
- **Tadeush Çekalski**, Shqipëria përshkrime etnografike, kulturore dhe fetare, Shtëpia Botuese Onufri, Tiranë 2013
- **Arqile Teta**, Shqiptarët dhe Skënderbeu në Poloninë mesjetare, "Albanica", nr. 97/2010.
- **JOSEF MACUREK (BRNO CSSR)**, GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU Shqipëria dhe vendet çeke. Studimet Historike, nr 21, nr 4. 1967, fq 42
- **Jahja Drancolli**, Skënderbeu në objektivin e historianit Novobërdas Kostandin Mihalit (1435-1501). Gazeta Shqiptari. 17 Nëntor, 2018.
- **Elsa Demo**, Kujtesa e shqiptarëve në kështjellën sllovaqe.

një vepër humaniste unike të këtij zhanri. Sipas burimeve që zotërojmë Kostandini ka lindur në Ostrovicë të Novobërdës rreth vitit 1435 në një familje minatorësh ose tregtarësh, andaj edhe shkollimin fillor do ta ketë mbaruar në vendlindje, Novobërdë. Ka marrë pjesë me një njësit të vogël vasalësh në rrethimin e Kostandinopojës në vitin 1453, ndërsa më pas e ndeshim në mesin e mbrojtësve të qytetit të Novobërdës, kur qyteti bie në duar të osmanëve (më 1 qershor 1455). Atëherë, në mesin e robërve ishte dhe Kostandin Mihalit, i cili qe dërguar për jeniçer, dhe mori pjesë në shumë ekspedita të sulltan Mehmetit II: në Arbëri, Hungari, Peloponez. Në Bosnjë, më 1463, ka komanduar me repartin e qytetit Zveçaj, ku dhe kapet si rob nga ushtria e mbretit hungarez Matej Korvin. Pas lirimit nga hungarezët, vihet në shërbim të planeve për krijimin e aleancës politike dhe nisjen e fushatës kundër osmanëve. Kostandin Mihalit do t'i humbin për një kohë gjurmët, por dihet se kishte ikur nga osmanët për t'u

kthyer në mesin e të krishterëve, ku dhe vdiq në Poloni pas vitit 1501. Mes viteve 1497 – 1501, shkruan "Kujtimet" e tij si memorandum politiko-historik, dedikuar mbretit polonez Jan Olbraht dhe mbretit hungarez Vladisav II. Dorëshkrimi i veprës më të njohur të tij nuk është ruajtur në original për këtë arsye ende ka mbetur e pandriçuar çështja se në cilën gjuhë është shkruar origjinali. Në bibliotekën Zamojski të Varshavës është ruajtur një kopje (transkript) në gjuhën polake nga shek. XVI. Dorëshkrimi zotëron 77 faqe. Janë ruajtur dhe kopje të tjera, si, ajo e Bibliotekës Kombëtare të Varshavës, të Peterburgut, Pragës, e ndonjë tjetër. Kopja e Pragës është botuar në gjuhën çeke në vitin 1565 dhe ruan këtë titull: "Hystorya neb Kronyka Turecká od Michaala Konstantina z Ostroëicze" ("Historia ose kronika turke nga Mihal Kostandini i Ostrovicës"). Aty ndeshim njoftime për inkursionet osmane në Hungari, Peloponez, dhe në këtë kontekst dhe për fushatat osmane në Arbëri, ku është spikatur roli i Gjergj Kastrioti-Skënderbeut përballë ushtrisë së sulltan Mehmetit II. Kjo vepër u fut thellë në vetëdijen e shoqërisë çeke vetëm pas vitit 1565, kur në Bohemi u përhapën informata me hollësi, jo vetëm mbi gjendjen e Turqisë por njëkohësisht edhe mbi Shqipërinë dhe përfaqësuesin e saj në shekullin XV, Gjergj Kastriotin – Skënderbeun. Dy burime të tjera interesante çeke pasqyrojnë qendresën arbëre kundër osmanëve në Bohemi. Kësaj radhe nuk ishte përkthime nga gjuhët e tjera por ishin vepra të humanistëve dhe historianëve çekë. Në shekullin XVI, Gjergj Kastriotit – Skënderbeun e ka përmendur historiani i famshëm çek Dhaniel Adhami nga Veleshslavini, i cili ka shfrytëzuar si burim historik veprën e Marin Barletit "Historia e Skënderbeut".

Me këtë rast ai vë në dukje trimërinë e jashtëzakonshme dhe forcën e qëndresës që duhet admiruar Skënderbeut dhe arbërëve kundër fuqisë turke. Katër vjet pas botimit të relacionit të Veleshslavinit njohuritë mbi historinë shqiptare në Bohemi na shekullin XVI i pasuroi përkthimi çek i kronikës turke autori i së cilës, J. Leuklavius, njihet edhe për punime të tjera të tjera historike në Evropë.

Një karakteristikë e veçantë e citimit, përmendjes dhe shkrimit të "Historisë së Skënderbeut" në literaturën e Europës Qendrore është kohezioni moral i aksionit të Skënderbeut si kampion i lirisë dhe Atlet i Krishtit dhe i katolicizmit apo dhe kontekstualizimi i këtyre cilësive të tij në historinë bashkëkohore kur janë shkruar veprat. Një vepër e tillë me aspekt humanist është dhe vëllimi në prozë kushtuar Gjergj Kastriotit – Skënderbeut nga Gjergj Bartoldi nga Bruksi i Bohemisë Veriore (i quajtur Pontanus ose dhe von Braitenberg – pas malit që gjendet afër Bruksit). Georg Bartoldi, i njohur dhe me pseudonimin letrar Bakalareus ishte me një

kulturë të gjerë humaniste. Ai ishte Profesor në Universitetin e Pragës, zëvendës abat dhe vikar i përgjithshëm i Kryepiskopatës së Pragës, autor i disa veprave poetike, prozaike dhe historike të drejtimit katolik, me të cilat pasuroi letërsinë latine që në fillim të shekullit XVII në Bohemi. Vepra për Skënderbeun i kushtohet Jarosllav Borita Martinicit, një nga luftëtarët e parë të besimit katolik në vendet boheme. G. Bartold von Braitenberg, Skënderbeun e Shqipërisë e krahason me Borita Martinicin. Në të dy këta krerë humanisti G. Bartold von Braitenberg sheh luftëtarë të njëjtë për besimin katolik për mbretërinë dhe atdheun. Bartoldi ashtu si dhe Dhaniel Adhami nga Veleshslaviniu bazua në veprën e lartpërmendur të Marin Barletit, nga e cila mori disa pjesë dhe formoi një të tërë.

Përndryshe vepra e tij e vogël është një farë prove retorike, një punim që t'i shërbente si shembull partisë katolike boheme në prapun e betejës pranë Malit të Bardhë, në luftën e saj për privilegjet politike dhe fetare. Në kushtimin e veprës së humanistit G. Bartold von Braitenberg ndaj Jaroslav Hrabě Bořita z Martinic mund të kuptojmë më tepër për imazhin e Skënderbeut dhe aksionit të tij politik në Bohemi. Në të shkruhet:

...Lavdija e Skënderbeut, kalorës kristianësh kundër egërsisë dhe mendjemadhësisë së turqve, i paepur në guxim dhe në armë Gjergj Kastrioti, i mbiquajtur Skënderbe, që është e njëjtë si me thënë Leka i Madh, mbreti i Epirit, u tregua njohës i të gjitha fshehtësive të tiranit (Sulltanit), shtrues i madh i armiqve dhe mbrojtës trim si edhe përhapës i mrekullueshëm i besimit kristian, i cili nuk qe vetëm shuplakë zotërues e fitues i tiranit që ai ta dinte, me të gjithë pabesinë muhamedane dhe turmën e vet, se Zoti sundon etj, dhe ka në dorë mbretëritë... Beslidhja e bërë prej te jatit të Kastriotit kundër, Sulltanit... Prij ... Skënderbeu i urtë dhe syhapur ... Barleti i përshkruan luftat e Skënderbeut në 13 libra ... Kjo vepër duhet lexuar nga të gjithë ndër shkollë ... Fitoret ... Skënderbeu vrau 3000 turq ... Skënderbeu lavdërohet në Itali si luftëtar i më i madh i mbarë botës."

Imazhi dhe ndikimi i Skënderbeut do të ndiheshin dhe më vonë në trashëgiminë kulturore dhe historike të Sllovakisë ku figura e Skënderbeut do të ishte një shembull rezistence ndaj invazioneve osmane po aq sa shembulli i një kalorësi fisnik të krishterë që bënte gjithçka për vendin e vet. Rreth 200 kilometër larg kryeqytetit sllovak Bratisllavë, në qytetin e vogël Zhilin ndodhet kështjella Bytca. Disa nga faqet e mureve të saj janë të mbuluara me afreske e piktura murale, që kanë për objekt heronj të rëndësishëm evropianë, historikë e legjendarë të periudhave të ndryshme. Mes tyre është përfshirë dhe figura e Heroit Kombëtar të shqiptarëve, Gjergj Kastriot Skënderbeu. Afresku i strategut, portreti i të cilit ngjan shumë me një hero të krishterimit, ashtu si dhe është identifikuar simbolikisht më vonë Kastrioti, ka përmasa më të mëdha se ato natyrale e ç'është më e rëndësishmja ai renditet krah luftëtarëve të tjerë legjendarë siç është Akili, apo historik si Aleksandri i Madh, e deri te Huniadi.



Martin Bielski.

500 + ZINC+ **D3** *DIRECT*

PËRTHITHJE MAKSIMALE

Rrit imunitetin

Lufton viruset

Zn

D3

C

- **funksionimin normal të sistemit imunitar**
- **mbrojtjen e qelizave nga stresi oksidativ**

Bustina të tretshme

Merret pa ujë

Shtesë ushqimore



PRINCI QË NGATËRROI BALLKANIN

Kisha Ortodokse mendon se eshtrat e Princit duhet t'i ketë në zotërim, serbët pretendojnë se është shenjt i tyre, ndërsa shqiptarët kishin vendosur t'i ruanin lipsanet në Muzeun Historik Kombëtar; derisa ia huazuan ato sërish Kishës, deri kur rinis sërish debati: Kujt duhet t'i besohen eshtrat e Shën Joan Vladimirit tani që Muzeu i nxorri nga FONDI?

| Nga LUELA MYFTARI

Eshtrat e Shën Joan Vladimirit, një shenjt i që respektohet veçanërisht nga shqiptarët dhe serbët ortodoksë i'u dorëzuan nga vetë drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, ministrja e kulturës dhe kryeministri Rama, manastirit të Elbasanit pak para Pashkëve Ortodokse, por njëkohësisht edhe pak ditë përpara zgjedhjeve. Ky është imazhi i pranverës së shkuar.

Ishte prilli i vitit 2021. Ngjarja shkoi në heshtje. Muzeu Historik Kombëtar nxirrte nga fondi i pasurive të veta, por njëkohësisht edhe nga një pasuri e shqiptarëve, një relikuar dhe për këtë nuk njoftoi asnjë nga gazetarët e kulturës.

Heshtja e institucionit që ia kishte dhënë lipsanet e Shën Joan Vladimirit i shtonte dyshimin kësaj ngjarjeje për më skeptikët e kësaj historie me shumë pikëpyetje. Si mund të dilte nga fondi i Muzeut një relikuar dhe gazetari i kulturës, që njoftohet e ndjek edhe sfilata mode të stilistëve të rinj në një institucion kombëtar, nuk lajmërohet? Disa muaj më pas, drejtori i këtij institucioni justifikohet që kjo nuk ishte një ngjarje e rëndësishme për t'u njoftuar. Dhe sidomos në rastin kur e gjithë kjo organizohej nga instanca më të larta.

Ndonëse gazetarët e kulturës nuk ishin aty, qëlluan dy xhirime që ngjanin si videoklipe zgjedhësh që vijnë të jenë si dëshmi e ngjarjes. Mediet shkruan pak atë kohë, por më së shumti lajmi u transmetua në Elbasan, ku beteja dhe sherret elektorale ishin më joshëse për t'u trajtuar se ky dhurim apo huazim. Atë kohë asgjë nuk ishte e qartë. Derisa një ditë, një nga drejtorët e Ministrisë së Kulturës na shpjegon se është pushuar nga puna, sepse nuk ka firmosur një marrëveshje, marrëveshjen për t'ia dërguar lipsanet e Shën Joan Vladimirit Kishës Ortodokse.

Dy lajme në një: Akuzat për pushim nga puna pa të drejtë dhe po ashtu një marrëveshje që nuk ishte njoftuar as nga Muzeu Historik Kombëtar dhe as nga Ministria e Kulturës. Nga po dilte kjo ngjarje për të cilën duket se kishin dijeni veç gazetarët në Elbasan dhe kjo në një kohë kur mesazhet politike ishin kryefjala e edicioneve informatike? Pushimi nga puna i historianit-drejtor Gjet Ndojt nuk dukej aq interesant sa ç'ishte historia e princit që vijonte të ngatërronte dynjanë. Ishte një histori për të cilën, ashtu si unë të gjithë do të donin të lexonin më shumë.



Dorëzimi i
lipsaneve në
manastirin e
fshatit Shijon
në Elbasan



ÇFARË JANË LIPSANET?

Nëse do të pyesnim fjalorin e shqipes për shpjegimin e termit lipsan, në gjuhë shkencore do të përkthehej si kufoma apo mbetjet e dikujt që nuk varroset, për t'u nderuar sipas një tradite tjetër. Në kultura të ndryshme ekziston edhe ruajtja e hirit që mbetet nga trupi i një njeriu që digjet. Në kulturën kishtarë, lipsanet nuk janë thjesht eshtrat e dikujt që ka humbur jetën. Kur një Shenjt, dishepujt apo njerëz të rëndësishëm të Kishës, ndaheshin nga jeta, eshtrat e tyre ruheshin në kuti të zbukuruar mirë bashkë me disa objekte të rëndësishme të personave në këto kuti. E gjithë kjo bëhej për t'u nderuar nga të gjallët që besonin në mrekullitë dhe mirësinë e këtyre shenjtoreve edhe pas vdekjes. Ato nuk ishin eshtra të njerëzve të zakonshëm që kryesisht varroseshin pranë të afërmeve, në pronat që zotëronte kisha, në të vërtetë janë eshtrat e ruajtura të një trupi që kishte lënë vepra të mira e profeci. Lipsane ka shumë në vendin tonë, kryesisht të ruajtura në muze apo kisha njëilloj si ikonostaset. Lipsanet e Shën Joan Vladimirit janë një shembull. Janë eshtrat e Princit që u kthye në Shenjt dhe që u vendosën në një kuti të zbukuruar nga Kostandin Shpataraku. Kutia që mban këto eshtra është një vepër arti. Ndërsa lipsanet janë vetë eshtrat e shenjtit. Kutia bashkë me lipsanet e Shën Joan Vladimirit janë dy objekte të fondit të Muzeut Historik Kombëtar.

Si mund të dilte nga fondi i Muzeut një relikuar dhe gazetari i kulturës, që njoftohet e ndjek edhe sfilata mode të stilistëve të rinj në një institucion kombëtar, nuk lajmërohet? Disa muaj më pas, drejtori i këtij institucioni justifikohet që kjo nuk ishte një ngjarje e rëndësishme për t'u njoftuar

Një princ ilir, besimtar i devotshëm, i vrarë me një kryq, një princ legjendar që u kthye në shenjt, që serbët e duan për vete, ortodoksit po ashtu, sikurse edhe shqiptarët; dhe që shekuj pas vdekjes, eshtrat e tij janë ende si molla e mëkatit, që të gjithë duan t'ja shohin shkëlqimin.

Aktualisht, lipsanet gjenden në kishën e fshatit Shijon të Elbasanit, një kishë që mendohet se e ka ndërtuar vetë princi, një kishë ku kanë qenë edhe më herët eshtrat e tij, e ku mendohet që shenjtja pasi ia prenë kokën me kryq, mori kokën në duar dhe udhëtoi drejt kësaj kisha në Elbasan që të prehej në këtë vend.

Sipas marrëveshjes që është nënshkruar atë ditë, ato ditë të pranverës së shkuar lipsanet nuk janë dhuruar, por janë huazuar për 5 vite në mënyrë që të ekspozohen apo nderohen nga besimtarët që vijnë nga çdo anë e Ballkanit për të festuar në Elbasan.



KUSH E KA TOPIN, MINISTRIA APO MUZEU?

Heshtja e institucioneve të kulturës për këtë ngjarje dukej si një nga hallkat e para dyshuese. Por, përse të heshtnin kur kjo marrëveshje nuk duket se ka probleme ligjore në vetvete? Pse heshtën për një huazim 5-vjeçar?



Ndodh që disa vepra të lëvizin nga muzetë për t'u ekspozuar diku, ashtu sikurse kanë mbërritur në Tiranë edhe shumë vepra të dala nga muze të huaj. Marrëveshja ishte një huazim me të drejtë rinovimi. Për pesë vite Kisha Autoqefale Ortodokse jepte sigurinë maksimale për mirëmbajtjen e tyre. Pra, ligjërisht gjithçka dukej e rregullt. Po pse iu fsheh kjo ngjarje gazetarëve të kulturës dhe u trajtua si një vizitë e Ramës dhe Taulant Ballës në manastirin e vjetër në Shijon të Elbasanit? Këtë nuk dimë ta themi, por pyetjet mund t'i bëjmë edhe sot. Sepse nëse drejtori i Muzeut Historik Kombëtar e quan të parëndësishëm këtë njoftim që ka menduar se me siguri do ta kishte bërë ministria, topi dukshëm pasohet në instanca më të larta. Por, çuditërisht as Ministria e Kulturës nuk ka një njoftim për këtë ngjarje. Është vetëm një gazetë dhe një televizion që gjendet shpesh pranë qeverisë në këto ngjarje (sepse siç duket vetëm ata janë njoftuar), që e raportojnë, një raportim që sot mbetet si dëshmia e ngjarjeve në të cilën gazetaret si unë u përfshytuan, por që shprehjen: "Dyshoj, pa jam" nuk ua shndërrojnë dot. Dhe në këto kërkime, njëllë si koleget e mia të interesuara për këtë histori joshëse të princit që e duan të gjithë, gjetëm disa materiale.

Muzeu Historik Kombëtar që e kishte kaluar topin te Ministria e Kulturës në fakt, ishte institucioni që ia "kishte hedhur" në letër këtë ide-propozim Ministrisë. Sipas këtij dokumenti të datës 25.03.2021 dhe me numër protokolli 1562, ka qenë vetë drejtori i Muzeut Historik Kombëtar Dorian Koçi që propozon t'i huazohen eshtrat e princit Kishës Autoqefale Ortodokse, pasi Hirësia e Tij Janullatus, ia ka bërë këtë kërkesë herë pas here. Kjo është e vetmja "marrëveshje" që ne gazetarët siguruam. Në këtë dokument firmosën: ministrja, Elva Margariti, sekretarja e përgjithshme Entela Çipa, Kozeta Angjeliu që prezantohet si drejtor në këtë shkresë, si dhe dy specialiste. Por jo Gjet Ndoj, i cili së bashku me vartësen e tij gjendet në listën e emrave që duhet të firmosë, por që nuk e ka bërë e që rezulton këtë janar i shkarkuar nga puna si drejtor në ministri. Se sa kjo ngjarje ka ndikuar këtë vendim, ai e rrëfen në një dalje publike.

**MOS HUMBISNI ULJET
E SEZONIT TË DIMRIT
DERI NË**




“U HOQA NGA PUNA SE NUK FIRMOSA MARRËVESHJEN”

Gjet Ndoj u shkarkua nga e detyra si drejtor në Ministrinë e Kulturës këtë fillimviti. Akuzon ministren Margariti. Dyshon dhe beson se shkak është marrëveshja e pafirmosur për lipsanet e Shën Joan Vladimirit

Gjjet Ndoj, historian, dikur edhe drejtor i Arkivit të Shtetit e deri këtë janar drejtor i përgjithshëm i politikave të zhvillimit në Ministrinë e Kulturës është shkarkuar nga detyra. Ishte po Ndoj, që njoftoi gazetarët për t'i shpjeguar se lirimi i tij nga detyra ndonëse kishte të shkruar një apo dy arsye të tjera zyrtarisht, nuk ishte krejt i drejtë. Sipas historianit, shkak është bërë një marrëveshje për kalimin e lipsaneve të Shën Joan Vladimirit apo thënë ndryshe e më saktësisht huazimi i eshtrave të shenjtë, nga fondi i Muzeut Historik Kombëtar drejt kishës ortodokse në Shijon të Elbasanit, një ngjarje që kishte ndodhur pranverën e vitit të shkuar e që historiani po e rikthente në vëmendje. Por, përse shkarkimi i tij erdhi në janar të vitit 2022, kur ngjarja për të cilën ai dyshon se është shkarkuar ka nisur thuhetse gjashtë muaj më parë? Në një intervistë, Gjet Ndoj shpjegon se kjo nuk është hera e parë që ai ka kërkesa nga Kisha Autoqefale Ortodokse dhe se ngjarjet nuk mund të jenë rastësi.

“Ministrja kishte bërë kërkesë që në mesin e dhjetorit, por kërkesa e saj mori përgjigje në janar. Mosmarrëveshje të vogla kemi pasur disa, por nëse do të flasim për arsyet e vërteta të pashkruara prej saj, në lirimin nga detyra, besoj vërtet se është për shkak të marrëveshjes për



Marrëveshja e huazimit

kalimin e lipsaneve nga fondi i Muzeut Historik Kombëtar drejt Kishës Ortodokse që kishte bërë kërkesën për t'i pasur këto lipsane. Unë nuk e firmosa atë marrëveshje”, sqaron historiani.

Gjet Ndoj, tregon se debati i kryer asokohe brenda ministrisë, bëhej për t'i kaluar këto lipsane jo vetëm për 5 vite, por marrëveshja është ndërtuar në mënyrë të tillë që të hapësirë që lipsanet të vijojnë të qëndrojnë aty, edhe pas një 5-vjeçari. Në të vërtetë, marrëveshja është firmosur me të drejtë rinovimi.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSIME DREGULLTORE DHE E PËRPUTHSIMËRISË PË
KULTURËN
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT
TË KUADRI DREGULLATOR

Tirane, më 25.3.2021

MEMO

Nr. 256/Pro.

Është Mbi kërkesën për kthimin e lypsanet të shpërndarë nga Vladimiri në muzeun e Shën Jo-

Drejtues: Zg. Elva MARGARITI, MINISTRI
Miratohet: Zg. Enxela CIFA, SEKRETARI PËRGJITHSHEM
Pranohet: Z. Gjet NDOJ, DREJTORI PËRGJITHSHEM
Konceptohet: Zg. Elira BANI, DREJTORI
Zg. Kozeta ANGJELI, DREJTORI
Zg. Sonda Kora, Përkthuesi
Zg. Enxela KOCILERE, Specialiste

Të shprehur

Në Ministrinë e Kulturës është paraqitur kërkesa e Mitropolisë së Shqipërisë të Elbasanit, Shqipëri dhe Librazhdit, protokolluar me nr. 941, datë 24.2.2021, mbi kthimin e lypsanet (redhancave) të shpërndarë nga Vladimiri, në muzeun e Shën Joani Shqipëri, Elbasan. Ky është një kërkesë e përsëritur e Mitropolisë së Shqipërisë të Elbasanit, Shqipëri dhe Librazhdit drejtuar Ministrisë së Kulturës dhe kështu me shprehjen e datës 23 shkurt 2021.

Referuar shkresës, Mitropoli thotë se lypsanet përbejnë trashëgimi dhe prandaj shpërndarë janë ortodokse shqiptare. Lypsanet duhet të jenë prandaj marrë me përveçse të shprehur nga Vladimiri, në muzeun e Shën Joani Shqipëri, Elbasan. Ky është një kërkesë e përsëritur e Mitropolisë së Shqipërisë të Elbasanit, Shqipëri dhe Librazhdit drejtuar Ministrisë së Kulturës dhe kështu me shprehjen e datës 23 shkurt 2021.

Referuar shkresës, Mitropoli thotë se lypsanet përbejnë trashëgimi dhe prandaj shpërndarë janë ortodokse shqiptare. Lypsanet duhet të jenë prandaj marrë me përveçse të shprehur nga Vladimiri, në muzeun e Shën Joani Shqipëri, Elbasan. Ky është një kërkesë e përsëritur e Mitropolisë së Shqipërisë të Elbasanit, Shqipëri dhe Librazhdit drejtuar Ministrisë së Kulturës dhe kështu me shprehjen e datës 23 shkurt 2021.

Duke qenë se objektet e kërkuara, "Kuti me lypsanet të shpërndarë", me numër inventar: MFK 5717 dhe Kuti nga IKRTK-ja 6313 dhe "Kuti argand e kështjës", me numër inventar: MFK 6226 dhe Kuti nga IKRTK-ja 325296, ndodhen në Muzeun Historik Kombëtar, regjistruar në RKPK si "objektet e kështjës", në pronësi të MFK, e konfirmuar nga IKRTK. MFK ngre një komision për hartimin e kërkesës.

Komisioni i ngre nga MFK konstaton se të shprehur për lypsanet e Gjet Vladimiri dokumentohen në Arkivin Qendror të Shqipërisë, Fondi 138, domi 3, fletë 11 dhe në arkivin: MFK Shqipëri, Shqipëri dhe shpërndarë. Toena, Tirane, 2004, faqe 127 dhe Jovan Georg von Hahn, Analiza shqiptare, Institut i Dialogut dhe e Komunikimit, Tirane, 2007, faqe 122.

Kërkesa e muzeut
drejt Ministrisë së
kulturës për t'ia
huazuar relikuaret
Kishës Ortodokse
Autoqefale

kabinetit nga ministria që me sa kuptova unë ishin të trysnuar nga shkresa. Ndërkohë unë sapo më ka ardhur ajo shkresë, kam bërë një shënimin përkatës dhe ia kam kaluar vartësës sime në ministri, drejtoreshës aty, që t'i kthehet përgjigje Hirisë së Tij Anastas Janullatos ku të sqarohet pamundësia ligjore për ta zhvendosur këtë fond. Pastaj kam pasur një debat me ministren Margariti që ta sqaroj se nuk ka shteg që një pasuri muzeore, kur bëhet pjesë e një database si fond muzeor, nuk mund të dalë nga kjo databazë. Dhe ky është një parim i përbotshëm. Megjithatë edhe pas këtij debati, në pamundësi për të gjetur shtegun ligjor, ata janë detyruar që të gjejnë një zgjidhje tjetër. Pri-jësi i Shkodrës, nga Kraja, nuk është as serb dhe asgjë tjetër që duan që ta nxjerrin

këto tani. Ata kanë gjetur një klauzolë për huazim 5-vjeçar që mund të rinovohet", sqaron Ndoj.

Ish-drejtori Gjet Ndoj pretendon se kjo është arsyeja e vetme e shkarkimit të tij nga detyra në Ministrinë e Kulturës pasi konflikt tjetër më të madh nuk ka pasur ndërsa sjell në vëmendje se edhe kur ai ishte në krye të Drejtorisë së Arkivave, ka pasur kërkesa për të kaluar disa dokumente origjinale në ngarkim të Kishës Autoqefale Ortodokse.

"Si drejtori i Arkivave para 5 vitesh, kam pasur kërkesa insistuese nga Kisha Autoqefale Ortodokse që kërkonin fondet, dokumentet dhe pasuri origjinale nga fondi i drejtorisë së Arkivave. Unë nuk kam pranuar edhe atëherë, që të nxirrja nga fondi një objekt a dokument, përveçse në rrugë digjitale. Mirëpo kërkesat vijonin të ishin për origjinalet. Atë kohë, nuk mendoja se ky mund të ishte një shkak për shkarkimin tim. Por tani kam filluar të besoj se edhe atëherë, jam shkarkuar ndoshta për të njëjtën arsye. Por, unë jam i ndjeshëm sa i përket trashëgimisë kulturore. Dhe ky është sërish një tjetër rast i ngjashëm. Unë nuk po flas për shkarkimin tim, unë dua të tregoj se sa me rëndësi është ta ruajmë trashëgiminë. Unë do vazhdoj betejën ligjore për shkarkimin tim, por lypsanet mbeten shqetësime", dëshiron ta mbyllë Gjet Ndoj këtë akuzë për shkarkimin e padrejtë po aq sa edhe për lypsanet.

"Unë nuk kam pranuar edhe atëherë, që të nxirrja nga fondi një objekt a dokument, përveçse në rrugë digjitale. Mirëpo kërkesat vijonin të ishin për origjinalet. Atë kohë, nuk mendoja se ky mund të ishte një shkak për shkarkimin tim. Por tani kam filluar të besoj se edhe atëherë, jam shkarkuar ndoshta për të njëjtën arsye"

"Ka pasur një debat brenda një grupi që siç duket e kishte thirrur ministria Margariti për të gjetur shtegun ligjor për të realizuar zhvendosjen e kutisë së zbuluar me lypsanet, të këtij fondi të jashtëzakonshëm unik, jo vetëm për trashëgiminë shqiptare. Aty kanë qenë 7 persona të ministrisë përfshirë drejtorin e Muzeut, drejtorë juridikë, pjestarë të

MES HISTORISË DHE LEGJENDAVE: I KUJT ËSHTË PRINCI SHENJTOR?

Shenjtori ka lindur në shek. X dhe ishte bir i Nemanit, që ka qenë mbret i Ilirisë dhe sundonte Malin e Zi, Dalmacinë, Bosnjen dhe disa krahina të Greqisë pranë Prevezës. Pas vdekjes së të atit, mbretërinë e trashëgoi Joan Vladimiri. Ai dallohej si një mbret besimtar dhe bamirës. Njihet si kontribut i tij, mbrojtja e Kishës nga herezia si dhe ndërtimi i disa vendeve të besimit ortodoks. Po ashtu Joan Vladimiri njihet edhe si nipi i mbretit Bullgar Simeoni i Ohrit (890 – 927), ndaj edhe sot në kufij të tjetër shtetërorë të gjithë do të donin ta kishin të vetin Joan Vladimirin.

Gojëdhënat e atyre që e njohin si shenjt Joan Vladimirin përcjellin se në një betejë me Samuelin, mbretin e Bullgarisë, Joan Vladimiri u zu rob prej tij dhe u burgos në kryeqytetin e Ohrit. Atje njihet me princeshën Kozara, që ishte njëkohësisht edhe bija e carit Samuel. Ajo ia admiron bukurinë dhe mirësinë që nga vizita e parë në ambientet ku ai mbahej i burgosur dhe i kërkon të atit martesën me Vladimirin. Samueli pranoi dhe e dërgoi Joanin përsëri në

mbretërinë e tij të mëparshme.

Me vdekjen e car Samuelit mbretërinë e tij e mori i biri, Radovan, por edhe ai u vra nga kushëriri i tij, Vladislavi, një pushtetar i pashpirt dhe lakmitar. Nga Mbretëria e Bullgarisë ai kërkonte t'i merrte kurorën edhe Joan Vladimirit dhe për ta gënjyer shenjtorin i dërgoi një kryq si shenjë besnikërie. Vladimiri në mirëbesim shkoi në oborrin e Vladislavit në



(majtas) Shën Joan Vladimiri, 1728, Kisha e Kryeengjëjve Mihal dhe Gabriel, Vithkuq, Korçe. (poshtë). George & John Tsetiri, Shën Joan Vladimiri, 1795, Kisha e Shën Nikollës, piktura murale, afreska, Vanaj, Lushnje

Hagiografia e tij e hershme mendohet të jetë shkruar diku midis viteve 1075 dhe 1089; pjesa më e madhe e të cilave në greqisht dhe sllave të Kishës u botuan fillimisht, respektivisht, në 1690 dhe 1802.



Ohër, ku u përball me tradhëtinë. Vladislavi u përpoq disa herë ta vriste, por sipas legjendave çdo shpatë që përdorte për ta vrrarë i thyhej. Atëherë mbreti Joan i tha: “Me kryqin që më tradhëtove mund të ma presësh kokën”.

Sipas një tjetër gojëdhënë, gjatë dyndjes së sllavëve në Ballkan e Arbëri, princi përshkonte shpesh rrugën antike Egnatia, ku kishte ndërtuar edhe kisha. Një prej tyre ndodhej në degëzimin e vijës Egnatia për në Petrelë, aty ku sot ndodhet fshati më emrin Shijon. Emri

i fshatit Shijon vjen nga bashkimi Shën-Gjon, (sepse mendohet që Krishtërimi atëherë i pandarë tërësisht në katolik dhe ortodoks, përdorte si emër si Gjon Vladimirin, po ashtu edhe Joan Vladimirin). Gojëdhënat tregojnë se një ngga këto ditët që princi Joan ishte duke udhëtuar përgjatë vijës Egnatia, ai ekzekutohet me urdhër të mbretit bullgar. Ata i presin kokën me shpatë dhe shkojnë t'i japin lajmin mbretit, ndërsa kali bashkë me trupin dhe kokën e prerë udhëton drejt manastirit në të cilin ai lutej gjithmonë. Sipas gojëdhënës, gjithnjë kali me trupin dhe kokën e prerë ka udhëtuar disa ditë për t'u ndalur më pas në manastirin që sot ndodhet në Shijon të Elbasanit. Pamja e rrallë dhe kthimi i Princit Joan në atë gjendje në kishë, mrekulloi popullsinë e zonës përreth, e cila pasi merr pjesë në varrimin e Joan Vladimitrit e shpall atë Shenjt, dhe ai bëhet Shën Joan Vladimiri për ortodoksit ose Shën Gjoni për vendasit. Edhe kishës i dhanë emrin e tij. Sot, ende kjo Kishë, njihet si manastiri i shën Joan Vladimitrit.

KATOLIK APO ORTODOKS? GJON APO JOAN?

Hagiografia e tij e hershme mendohet të jetë shkruar diku midis viteve 1075 dhe 1089; pjesa më e madhe e të cilave në greqisht dhe sllave të Kishës u botuan fillimisht, respektivisht, në 1690 dhe 1802. Një version i shkurtuar, i shkruar në latinisht, ruhet në Kronikën e Priftit të Duklit. Ndaj e vështirë të kuptohet sot pse shumica e shkrimeve të tij janë greqisht e sllavisht, po ashtu edhe ata që e nderojnë janë më të shumtë ortodoksë e serbë. Nëpër ikonat e sotme, Shën Joan Vladimirin e gjejmë si një monark me një kurorë dhe rroba mbretërore, me një kryq në dorën e djathtë dhe kokën e tij në dorën e majtë.



Manastiri i Shën Joan Vladimirit, 1940 dhe sot pas restaurimit



MANASTIRI QË I MBIJETOI TË GJITHA KOHËRAVE MBETET ENDE MAGJIK

Manastiri i Shën Joan Vladimirit është vendosur në afërsi të fshatit Shijon, gati 10 km larg Elbasanit. Kosiderohet si një ndër qendrat më të vjetra monumentale historike dhe fetare në Shqipëri. Ende nuk ka një moshë të saktë për këtë ndërtesë por dihet se në këtë vend ka ekzistuar një kishë, para se të rindërtohej nga Karl Topia në vitin 1381.

Manastiri ndodhet pranë vijës antike Egnatia pranë një degëzimi që të çon për në Petrelë dhe mendohet se është pikërisht kisha ku më 4 qershor të vitit 1016, në këtë vend u varros një Shenjt me origjinë sllave me emrin Joan Vladimiri (Gjon Vladimiri). Thonë se ky vend ka më shumë se 7 shekuj që pret besimtarë nga i gjithë Ballkani. Madje në kohë të caktuara të historisë Manastiri i Shën Joan Vladimirit përmendet si një ndër vendet që konkuronte me akademinë e Voskopojës, si strukturë. Në këtë manastir kanë punuar dhe jetuar personalitete të fuqishme të kohës, që kanë kontribuar për gjuhën shqipe, si Papa Totasi dhe Dhaskal Todri.

Thonë se eshtrat e këtij shenjt kanë qëndruar aty deri në vitin 1200, sepse atë kohë kisha pati dëmtime. Pas kësaj lëvizjeje lipsanet e shenjtorit kanë lëvizur në vende të ndryshme pasi të gjithë i lakmonin ato, ndonëse vetë Shën Joan Vladimiri kishte vendosur që me kokën e prerë të prehej në kishën e vogël që kishte ndërtuar vet, pra në Shijon të Elbasanit. Historianët tregojnë se lipsanet janë transportuar në fillim në Krajë të Malit të Zi. Aty kanë qëndruar deri në vitet 1215, pastaj ato u transportuan nga despoti i Epirit Mihal Engjëlli dhe u vendosën në Durrës dhe aty qëndruan deri në vitin 1381. Në vitin 1381 Karl Topia, zoti i Arbrit kontribui në rindërtimin e manastirit. Në atë vend u transportuan lipsanet e shenjtorit dhe qëndruan aty deri në vitin 1967, me mbylljen e manastirit, kur mendohet se në luftën e ashpër kundër besimit u mbyll edhe ky manastir.

Edhe pse ishte katolik, Karl Topia e rindërtonte duke e bërë 4 herë më të madh manastirin. Në hyrje të manastirit Karl Topia vendos stemën e tij dhe dedikimin e gdhendur në tre gjuhë, latinisht, greqisht dhe sllavisht. Në këtë mbishkrim thuhet “Karl Topia mbret i shqiptarëve e ndërtoi këtë manastir për lavdinë e tij”. Shën Gjoni shpallet Shenjt dhe çdo 4 qershor në manastir nisën të kryeshin ritualet fetare. Më pas në këtë vend filluan të zhvilloheshin panairët. Panairi i Shën Gjonit zgjaste një javë dhe frekuentohej nga pelegrinë që vinin nga i gjithë vendi dhe viset e Ballkanit.



**ZERO NITRATE
I PASUR ME MAGNEZ**



NË FORMATIN 19 L

**FURNIZIMI VJEN SË BASHKU ME PAJISJEN
PËR UJË TË FTOHTË DHE TË NGROHTË**

KONTAKT:

0697009900



www.qafshtama.com

KONTRABANDA E AR-it,

SI DOLËN JASHTË VENDIT NAPOLONAT E FLORIRIT

| Nga ERGYS ALUSHI

VLORË

Qypa të mbushur me monedha floriri të groposura nën tokë, pasuri e madhe e bejlerëve, agallarëve e borgjezëve shqiptarë të viteve të luftës, ka intriguar shpesh grupe të ndryshme edhe në vitet e demokracisë. Pas viteve '90, kishte familje të pasura që kishin ruajtur me fanatizëm napolonat e arit fshehur në thellësi të tokës. Shumë të tjera, besohet që janë zhdukur.

Qeveria e re e pasluftës nxorri "tatimin e jashtëzakonshëm të luftës" për t'u marrë bejlerëve, agallarëve e borgjezëve, arin e napolonat e floririt, që duhet thënë, ishte fshehur më së miri prej tyre.

Nuri Mehmeti në vitin 1984, në revistën e kohës "Në shërbim të popullit", në shkrimin me titull "Kur hidheshin themelet ekonomike të pushtetit popullor" shkruan ndër të tjera: "*Deri në fund të vitit 1948 u zbuluan 43.816.682 monedha ari, pa përmendur shufrat e stolitë e panumërta*". Ky është një tregues i sasisë së madhe të arit që është mbledhur në Shqipëri ato vite. Kjo e dhënë duhet të jetë më e madhe kur mëson po nga shtypi i kohës, se mbledhja e arit ka vazhduar edhe pas vitit 1948. Sasia e madhe e arit që gjendej në Shqipëri shpjegohet me faktin se ndryshe nga evropianët, borgjezia shqiptare, nuk e përdori ARIN për investime, por e fshehu, kryesisht duke e groposur në thellësi të tokës.


Sa më shumë rritej presioni i pushtetit popullor për të mbledhur ARIN që gjendej vendosur në qypa poshtë themeleve të shtëpisë, poshtë pemëve, apo buzë puseve në bahçet e vilave dhe shtëpive të borgjezëve, aq më shumë rritej edhe organizimi



i grupeve të ndryshme qytetarësh për ta kontrabanduar Arin shqiptar jashtë vendit.

Media e kohës së monizmit, në fillim vitet e para të pasluftës, "Bashkimi", "Zëri i Popullit", etj., raporton për arrestime të shumta grupesh të organizuara e individësh dhe procese të ndryshme të pushtetit popullor, procese që përfundonin me vendime e dënime të ashpra ndaj organizatorëve.

Të prekura e të dëmtuara nga realiteti i ri në vend, shtresat e pasura nisën organizimin për të kundërshtuar veprimet që merreshin karshi tyre. Përveçse panikut që mundoheshin të krijonin në popull nëpërmjet njerëzve të thjeshtë që i kishin ende në shërbim dhe sabotimeve në sektorë të ndryshëm, ata nisën të kryenin edhe **kontrabandën e arit**, si një mjet për të dëmtuar ekonominë që ishte në kolaps.



Kontranbanda e arit në vitet kur kishte vështirësi të mëdha ekonomike, zinte një nga vendet më të rëndësishme të veprimtarisë në kundërshtim me ligjet e nxjerra pas luftës. Synimi ishte i qartë: të dëmtoheshin sa më shumë të ishte e mundur financat e brishta të Shqipërisë së pasluftës. Metodat ishin të ndryshme, por qëllimi ishte një i vetëm: Lufta klasore që sapo kishte nisur. Kontrabanda e arit nisi të ushtrohej nga grupe të organizuara në të gjitha rrethet, por edhe nga individë, të cilët, sa zbuloheshin, gjykoreshin në mënyrën më të rëndë të mundshme.

Në Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Gjiro-
kastër, Shkodër, Korçë e në qytete të tjera,
media e kohës raporton për procese të bujshme
gryqsore të kontrabandës së Arit. Qëllimi nuk
është thjesht fitimi dhe pasurimi, por edhe as-
pekti politik, për të bërë lekun të pavlefshëm
e të papazueshëm.

GRUPET E KONTRABANDËS

Në vitet e para, kryesisht 1945-1946 pati kundërshtime të forta nga shtresat e borgjezisë që u shoqërua me arrestimin e burgimin e tyre në mënyrë masive.

I tillë ishte grupi i italianëve, i kryesuar nga profesor Venanzio Lozzi që në bashkëpunim me shqiptarë, dërgoi në Itali, arin e Simonçinit e të tjerë (Simoncini ishte kryetari i Komitetit të Asistencës për italianët). Grupet u gjykuan në Tiranë, Durrës, në Vlorë, Elbasan, Gjirokastrë, Shkodër, në Korçë e qytete të tjera.

Mallrat e fshehura i shisnin me çmime të larta nën dorë, duke zhvilluar tregun e zi. Por më shumë se çdo gjëje, i dhanë rëndësi floririt.

Këta njerëz arritën që 1 napolon ar
ta shisnin 25 – 40 napolona
letër. Grupi

Media e kohës së monizmit, në fillim vitet e para të pasluftës, “Bashkimi”, “Zëri i Popullit”, etj., raporton për arrestime të shumta grupesh të organizuara e individësh dhe procese të ndryshme të pushtetit popullor, procese që përfundonin me vendime e dënime të ashpra ndaj organizatorëve.

i Korçës, sipas raportimit të medias së kohës nga proceset e bujshme, kishte bërë kontrabandë 5 mijë napolona ari.

U zbuluan një grup prej pesë vetësh në Shkodër që përgatiste edhe vula false.

DEPONIME TË KOHËS PËR TATIMIN

"Që nga marsi i vitit 1945 – depononte Sami Queribashi (kryetar i organizatës Social-Demokrate) - që u tatova me 5 milion franga shqiptare, kam filluar të ndjej pakënaqësi karshi pushtetit dhe reformave të tij të rënda, si reforma agrare, e të tjerë...se nuk kishte liri, por diktaturë. Për të dal nga kjo gjendje doli nevoja e krijimit të një grupi. Në të bënë pjesë tregtarët e mëdhenj, të prekur nga tatimet e luftës, pronar të mëdhenj tokash e të tjerë..."

“Kishim bërë një lutje – depononte Profesor Caka, i tatuar me 15 milion franga shqiptare – që e përkthyeri anglisht dhe ia dërguam misioneve, duke kërkuar që ata të ndërhyjnë pranë qeverisë shqiptare për këtë çështje. Në lutje thuhej se të hollat që merrnin nga tatimet, shkonin për gjëra të kota, si për ushtrinë”;

(Marrë me shkurtime nga revista "Në shërbim të popullit", viti 1974)

KAPET KAMIONI NË GREQI, IU KTHEHET SHOIPTARËVE

Qeveria e sapodalë nga lufta e kishte të qartë se borgjezët e bejlerët, duke ditur vlerën e Arit për ekonominë kombëtare, i kthenin të gjitha fitimet në AR. Ndaj, për të ndaluar nxjerrjen jashtë vendit të Arit shqiptar, nxorri urdhëresa e rregulla të posaçme për të.

Sa më shumë shteti shtrëngonte masat, aq më shumë motivoheshin grupet e të pasurve për të gjetur mënyra dhe metoda për ta nxjerrë Arin jashtë vendit.

Media moniste e kohës (“Bashkimi”, viti 1946), raporton për një grup nga Tirana, me

**KUR HIDHESHIN
THEMELET EKONOMIKE
TE PUSHTETIT POPULLO**



Kjo është foto e arit e fshehur nga vëllezërit nga Durrësi që ishin pronarë të fabrikës së miellit. Ari ishte fshehur në murin e shtëpisë së tyre ndërtuar në Tiranë, në kryqëzim të rrugës së Barrikadave me atë “Bajram Curri”. Gjithashtu, atyre iu gjetën sasia të tjera ari të fshehura në një Pus brenda fabrikës dhe jashtë saj. Për nxjerrjen e tyre u punua gati një muaj për arsye se mungonin elektropompat e fuqishme për nxjerrjen e ujit. U përdorën gjithashtu makinat zjarrfikëse që ishin në atë kohë në Durrës si dhe polumbar nga porti i Durrësit.

inicialet A.C, F.B, e A.M që me anë të këmbimit të mallrave, e nxorrën arin drejt Greqisë.

Gjithçka u zbulua dhe u mor vesh kur në fund të vitit 1944, forcat greke të EAM kapën në një qytet grek pranë kufirit, një makinë të ngarkuar me Flori që kishte për destinacion Turqinë.

Floriri ishte i dy vëllezërve nga Durrësi që kishin në pronësi një fabrikë mielli. Sasia e kapur nga forcat greke, iu dorëzua çuditërisht një komande partizane që qëndronte në qytetin e çliruar të Korçës, raporton media. Dhe pas kthimit të kamionit të floririt në Shqipëri, menjëherë të dy vëllezërve që u vunë nën vëzhgimin e komunistëve, iu bënë kontrole të imtësishme. Në vitin 1948, atyre iu gjetën të groposura në Tiranë, në vende të ndryshme rreth 45 mijë napolona floriri të barabarta me 300 kilogramë ar.

GRUPI I ITALIANËVE

Italianët ishin ata që krijuan më shumë mundësi biznesi në kohën e paspushtimit. U vendosën në krye të fabrikave të ndryshme dhe në të gjithë sektorët. Shpesh, bashkëpunonin edhe me klasën e borgjezisë shqiptare, por në shumicën e rasteve, sidomos në Shqipërinë e mesme dhe të jugut, operonin të vetëm. Italianët e parë që kishin ardhur me biznese në Shqipëri, kishin arritur të grumbullonin sasira të mëdha të arit vendas. Ata mbetën në vend që nga lufta, dhe Arin e mbledhur, e dërgonin në Itali. Tirana e Vlora, e më pak Durrësi e Korça ishin vendet ku grumbullonin arin.

Media raporton për grupin e italianëve kryesuar nga profesor Venanzio Lozzi, në bashkëpunim me Shqiptarë dërgoi në Itali arin e Simoncinit. Profesori Italian shfrytëzoi

mjeshtërisht doganat e Vlorës e Durrësit, nëpërmjet korruptimit të punonjësve e që ishin deri diku jashtë kontrollit deri në ato momente. Raportohet se në Itali ka shkuar një sasi e madhe ari e napolonash floriri, por që në media nuk jepet sasia.

Venanzio Lozzi apo “doktor Losi”, siç njihej në Tiranë ishte një nga mjekët kirurgë më të mirë në Tiranë, i cili kishte ardhur në Shqipëri vetëm pak ditë pas pushtimit të Shqipërisë më 7 prill 1939. Ai u arrestua dhe u dënua me vdekje me pushkatim në verën e vitit 1946, me akuzën se kishte tentuar të nxirrte jashtë klufirit për në Itali një sasi të konsiderueshme ari të fshehur në barkun e një kufome, të futur në arkivol.

GRUPI I KORÇËS: SI E ZHVILLOI KONTRABANDËN

Korça ishte qytet ku biznesi vlonte e borgjezia ishte shumë e pasur. Tatimet e jashtëzakonshme të luftës nuk po iu pëlqenin pronarëve dhe tregtarëve të punishteve të qytetit që u organizuan në një grup nën kryesimin e tregtarit Dh.Z.

Fillimisht grupi bëri propagandë kundër tatimeve me arsyetimin se ishin shumë të rënda, dhe kalonin jo vetëm fitimet, por edhe kapitalin. Tregtarët pretendonin se nuk kishin fituar aq shumë dhe thoshin se komisionerët ishin të paafte të llogarisnin.

Për të mos dhënë tatim fitimet dhe për të mos lejuar shtetin t’u sekuestronte sipas ligjit atë që kishin, e fshehën mallin tek të njohurit e tyre ose në vende të fshehta, përgatitur enkas për këtë punë. Mallrat e fshehura i shisnin me

Qeveria e sapodalë nga lufta e kishte të qartë se borgjezët e bejlerët, duke ditur vlerën e Arit për ekonominë kombëtare, i kthenin të gjitha fitimet në AR. Ndaj, për të ndaluar nxjerrjen jashtë vendit të Arit shqiptar, nxorri urdhëresa e rregulla të posaçme për të.



HYGEIA HOSPITAL TIRANA

RADIOTERAPIA NË SPITALIN HYGEIA



**TEKNOLOGJIA E GJENERATËS SË FUNDIT & MË BASHKËKOHORE
NË TRAJTIMIN E KANCERIT, PËR HERË TË PARË, NË SHQIPËRI & RAJON,
VETËM NË SPITALIN HYGEIA**

- Kohë trajtimi e shkurtër & precizion shumë i lartë
- Kontroll në kohë reale e pozicionit të Tumorit
- Trajtim i Kancerit të Mushkrisë me Skaner 4D me precizion shumë të lartë
- Trajtim i Kancerit të gjirit me Skaner 4D pa prekur zemrën
- Radiokirurgji - Trajtimi me sukses i tumoreve të vogla të kokës & metastazave në 1 séancë të vetme, pa Kirurgji
- Trajtim i metastazave të Mëlçisë, apo edhe në çdo vend tjetër, për vetëm 3 ditë
- Mjekë Onkologë- Radioterapeut me eksperiencë ndërkombëtare



Tiranë Kashar Mëz KM 01 i Rugës dytësore
të Autostradës Tiranë-Durrës, Fushë-Mëz



+355 4 23 90 000



[https://web.facebook.com/
Hygeia.Hospital.Tirana.HHT/](https://web.facebook.com/Hygeia.Hospital.Tirana.HHT/)



www.hygeia.al

çmime të larta nën dorë, duke zhvilluar tregun e zi. Por më shumë se gjithçkaje tjetër, i dhanë rëndësi floririt. Paraja letër (kartmonedha) që grumbullonin nuk i kënaqte. Nuk kishin besim në qëndrueshmërinë e saj.

Prandaj ata vendosën që të shisnin vetëm me ar, të cilit, sipas tyre, jo vetëm nuk i humbiste vlera, por i rritej. Për ta realizuar këtë, ranë në marrëveshje me njëri-tjetrin dhe duke hequr me vete sekserët filluan të grumbullonin ar. Organizonin takime të fshehta dhe përdorën parrulla sekrete që të merreshin vesh me njëri-tjetrin.

Kur grupi i zbulua nga pushteti komunist, gjatë proceseve gjyqësore, treguan dhe mënyrën sesi arritën të grumbullonin Arin dhe si do ta bënin kontrabandimin e tij. Ata nuk përdoren shitjen e mallit për të grumbulluar ar, por Kartmonedhat i këmbyen me Ar. Të njëjtën gjë, bënë edhe ata që kishin Ar, duke blerë kartmonedha e duke shitur ar, e anasjelltas. Të gjitha këto këmbime nuk bëheshin nëpërmjet bankës, dhe kurse të caktuara nga shteti, por jashtë saj. Këta njerëz arritën që 1 napolon ar, ta shisnin 25 – 40 napolona letër. Grupi i Korçës kishte bërë kontrabandë 5 mijë napolona ar. Të nisur nga fitimet e mëdha, ata nuk u mjaftuan vetëm me grumbullimin e arit, por dhe e nxorrën jashtë shtetit duke blerë mall, të cilin e shisnin vetëm me flori, ose me këmbim malli. Shtëpitë e dyqanet e tyre u kthyen në qendra të kontrabandës dhe veprimeve të tjera në kundërshtim me ligjet, ku shprehej hapur qëndrimi kundër pushtetit komunist.

Organet e Sigurimit duke ndjekur veprimtarinë e këtyre grupeve, fokusuar kryesisht tek urrejtja që ata shprenin kundër Pushtetit Popullor, zbuluan ndër të tjera se ata bënin edhe kontrabandën e Arit. Masa e parë që u mor për kontrollin e monedhës ishte sulsazhimi dhe kishte dy qëllime kryesore: së pari, të kontrollonte gjendjen e lekut në prerje kartmonedha, sepse, siç dihet (shkruhet në media), pushtuesit kishin abuzuar në këtë drejtim dhe kjo kishte shkaktuar inflacion dhe, së dyti, duke vënë kufizime në sulsazhim, pakësoheshin kartmonedhat e tepërta dhe krijoheshin njëfarë stabiliteti. Kjo masë nuk dëmtonte aspak shtresat e varfëra e të mesme të fshatit e të qytetit, sepse sasia e hollave që u lihej ishte e mjaftueshme kundrejt të ardhurave dhe rezervave që mund të kishin.



Veprimtaria e këtyre grupeve u shtri edhe nësh-përndarjen e të hollave nësa më shumë njerëz që të sulsazhonin sa më shumë në kundërshtim me ligjin dhe “të shpërblenin” këmbyesat për “nderin” që u bënin. U zbuluan mjaft prej tyre. Shumica u zbulua pas spiunimit të qytetarëve dhe fshatarëve që i denonconin. Jo pak ndikuan edhe nëpunësit që bënin sulsazhimin dhe nga persona të ndërgjegjshëm që u ofronin rryshfete, por edhe organet e sigurimit dhe policisë nuk mbeteshin pas në këtë drejtim.

FALSIFIKIMI I VULAVE NË KARTMONEDHA NË SHKODËR

Grupe individësh punuan edhe për të falsifikuar vulat e sursazhimit. U zbuluan një grup prej pesë vetësh në Shkodër i cili përgatiti një vulë falso. S.Z. , i njohur si kundërshtar i komunizmit ra në kontakt me M.S., me punë piktor. Por organet e punëve të brendshme në Shkodër, u sinjalizuan se një grup njerëzish kanë bërë një vulë false dhe po sursazhojnë monedhën dhe i zbuluan në kohë. Përgatitja e vulës falso ju bë e njohur të gjitha rrethet dhe bankat filluan të ushtronin kontroll të rreptë mbi këtë.

ITALIANI FALSIFIKATOR NË TIRANË

Banka e Tiranës kapi një kartmonedhë me vulë false, por nga ekspertiza rezultoi se nuk ishte karakteristikat e asaj të Shkodrës. U vunë në dijeni organet e punëve të brendshme të cilat morën një seri masash dhe zbuluan se ishte përgatitur nga italian i Marcelo Serafini. Në vazhdim të masave për forcimin e monedhës ishte dhe ajo që u mor në 15 korrik 1946 për këmbimin e monedhës. Kjo masë ishte më e avantazhuar se sursazhimi dhe kishte pikësynim kryesor verifikimin dhe deri në një farë mase, kufizimin dhe kontrollin e kartmonedhës. Shtrësat e pasura e pritën përsëri shumë keq një vendim të tillë dhe u hodhën të gjithë kundër për ta sabotuar. Ata krijuan një gjendje alarmi duke prop-



SULSAZHIMI

4 profesorë ekonomie, vetëm 1 e njeh si procedurë

Për të përgatitur këtë dossier të mbledhjes së Arit të Shqipërisë, në shtypin e kohës haset gjerësisht fjala SULSAZHIMI.

Në kohën e sotme kjo fjalë nuk është e përdorshme dhe gazetarëve të revistës Newsbomb. al iu desh një kohë e gjatë për të kuptuar se çdo të thoshte kjo fjalë dhe si është konteksti që është përdorur ajo.

Pasi pyetëm shumë profesorë ekonomie të kohës së sotme, në katër kontakte, askush nuk e kishte idenë se pse përdorej kjo fjalë atëmot dhe çdo të thoshte.

Përgjigjen për këtë e dha vetëm profesor Llazi Balliu. Ky i fundit, deri në fillim të viteve 2000 ka shërbyer si drejtor i kontabilitetit dhe financave të ish-Banka e Kursimeve.

“Në atë kohë në qarkullim ishte franga shqiptare dhe franga ari shqiptare në kartmonedha. Dhe këto, gjatë luftës, u emetuan shumë edhe sepse një pjesë e ushtrisë gjermane paguhej me franga shqiptare. Në atë kohë, franga qarkullonte edhe në Kosovë, Maqedoni sepse kufijtë ende nuk ishin mbyllur hermetikisht. Kur ndërroi pushteti, gjëja e parë ishte kontrolli për karmonedhën ekzistuese në dy plane: për inflacionin dhe për shkak të ndryshimit tërësor të strukturës së drejtimit të shtetit. U kalua në shoqëri të kontrolluar. Kërkohej vënia dore të monedhës në qarkullim. Dhe mundësitë ishin të vogla për atë kohë. U mendua që të bëhej ajo që njihet si “sulsazhimi”, ose vulosja e gjithë kartmonedhave që do të hidheshin në qarkullim për t’u përdorur. Kjo zgjati për një periudhë të shkurtër kohore. Të gjithë njerëzit që kërkonin monedha duhet t’i çonin në Bankë dhe t’i merrnin të vulosura. Vulosja apo Sulsazhimi bëhej në shtypshkronjën e Bankës së Shtetit shqiptar. U arrit që të mblidhej një sasi e konsiderueshme e kartmonedhës. Një pjesë e asaj që nuk u paraqit në bankë, doli jashtë funksionit. Gjithë kjo procedurë zgjati deri në 1945. Sulsazhimi u bë në periudhë të shkurtër, monedhat e vulosura qarkulluan derisa u zëvendësuan në ‘47 me lekun që u printua në Jugosllavi. Kur doli leku i parë, u bë këmbimi i frangave: 1 frangë e re me pesë franga të vjetra; dhe më pas u bë këmbimi nga franga në lekë në raportin 1 frangë me 9 lekë”, sqaron Llazi Balliu për revistën Newsbomb.al.

aganduar “se si sursazhimi dhe këmbimi i monedhës ishin dy anë të një medalje që pasuronin shtetin dhe varfëronin popullin”; “se shteti grumbullonte paratë e popullit”, e të tjera. Edhe në këmbimin e monedhës, të pasurit përdorën po ato forma që përdorën për sursazhimin si dhënia e emrave fals, dhënia e parave për t’ja u këmbyer të tjerët me rryshfete, e të tjerë.

Të vjetrit tregojnë se kur është ekzekutuar në “Pusin e Mezinit”, toger S. H, një numër i madh burrash nga Vlora shkuan për ta parë nga afër të ekzekutuarin. Togerit ishte i njohur dhe i urryer në Vlorë, për dhunën që ushtronte në kërkim të mbledhjes së floririt, kryesisht në radhët e popullsisë çame



Shumica e zbullimeve në mashtrimin për këmbimin e monedhës u bënë nga populli, nga nënpunësit e këmbimit, të cilët ishin zgjedhur nga njerëzit më të besuar.

EKZEKUTIMI NË VLORË I TOGERIT HAJDUT TË FLORIRIT

Të vjetrit tregojnë se kur është ekzekutuar në “Pusin e Mezinit”,

toger S. H, një numër i madh burrash nga Vlora shkuan për ta parë nga afër të ekzekutuarin. Togerit ishte i njohur dhe i urryer në Vlorë, për dhunën që ushtronte në kërkim të mbledhjes së floririt, kryesisht në radhët e popullsisë çame.

Në vitin 1950, ai vrau shtetasin M. V kur ky i fundit ndodhej në kodrën e Topanasë. Pasi e vrau i kontrollonte xhepat se mos i gjente flori. Në vazhdim vrau myzeqarin V. Ll.

Nga torturat në paraburgim, togeri tregoi dhe u provua se kishte torturuar shtetasit A.B., I.B, M.B., B.Sh. Shtetasit I.B. i mori 400 napolona flori dhe nuk i dha ndonjë dokument. Edhe pse i morën floririn, e dënuan me një vit burg.

Në vitin 1947, shtetases N.S. e cila kishte mbetur e ve me një djalë 7 muajsh në gj, pas presioneve e dhunës së ushtruar për të nxjerrë floririn e fshehur, i morën të vetmen monedhë floriri që i gjetën në shtëpi. Rastet e shumta të dhunës deri në vrasje të këtij togeri, e detyruan pushtetin komunist ta dënonte me ekzekutim. Ai në vitet e mbledhjes së floririt, ishte kthyer në tmerrin e banorëve, kryesisht, të popullsisë çame në zonën e Vlorës.

KU U GRUMBULLUA ARI!

Deri në kohën kur u prishën marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, ari i grumbulluar shoqërohej në Bankë. Një ditë u dha urdhëri që ari të largohej nga Tirana dhe të dërgohej në Skrapar, diku në mal të Tomorit, në një vend sekret. Dëshmitarët e kohës tregojnë se thesari u transportua gjatë natës me një kamion ushtarak, ndërkohë që një tjetër makine e shoqëronte me roje të armatosur.

ROBERT

RADOJA

sot dhe dje!

Tirana është e ndryshme për çdokënd (me gjithë ndryshimin e saj në vite)... Ndonëse një nga qytetet ku çdo gjë ndryshon me sekonda “Pallatet Agimi” mbeten një nga lagjet më të bukura të tij (të paktën në këndvështrimin tim, pasi këtij qyteti s’i ka mbetur më asgjë retro)...

| Nga **SUADA DACI**

Ju do thoni pse gjithë kjo hyrje për “Pallatet Agimi”? Nuk kam aspak ndërmend t’ju flas për historikun e kësaj lagjeje të kryeqytetit, por për një nga personazhet më të dashur të artit shqiptar, i cili është banor i saj. Pianist, mësimezhënës, kompozitor e arranzhues muz-

ikor, kur përmendim të gjithë këto terma mendja të shkon vetëm tek një emër, Robert Radoja.

E takova profesor Robertin në një nga kafet më të veçanta në kryeqytet (kaloj aty çdo ditë dhe se kisha vënë re) të “Pallatet Agimi”, një qoshkë e vogël (alla franceze) mbushur plot me artistë, ku Radoja kalon paraditet e tij. “Ditën e nis duke bërë punët e shtëpisë, të cilat i kam bërë gjithnjë sepse më ka pëlqyer t’i bëj vetë gjërat e mia. Më pas vij tek kjo kafja që e kam afër me shtëpinë pasi më duket një vend tepër i këndshëm në Tiranë”...

A ka patur vende të lezetshme Tirana, e pyes unë?! Dhe Robert Radoja, i cili që prej vitit 1960 nuk u shkëput më nga Tirana thotë që po. “Tirana ka patur gjithnjë aktivitet. Ka patur disa lokale shumë interesante për kohën, si kafe Flora përshembull”, thotë ai. Unë insistoja ta ngacmojë duke i kujtuar që jo më larg se pak ditë më parë e hasa në një nga klubet e natës në kryeqytet. Mos vallë profesor Radoja frekuenton edhe jetën e natës?!

(Qesh) “Më 5 shkurt do të ishte 81 vjetori i Ferdinand Dedës dhe Eltoni është rritur me djalin tim të madh, kanë qenë të dy studentë për piano. Shkova tek Toni sepse më tha që kam hapur një lokal dhe ishte shumë bukur. Kjo ndodhi vetëm një herë nuk jam një frekuentues i jetës së natës.

PANDEMIA

Ama ai ka qenë që në fillim kundër kufizimeve të orareve për klubet e natës gjatë periudhës së pandemisë. “Nuk shpërndan mikrob muzika, muzika mbledh njerëz. Asnjë nuk i respekton rregullat madje as në botë, kështu që më duket pa sens që deri në orën 8 mikrobi nuk infektonte dhe pas orës 11 po. Mendoj që maska është i vetmi element mbrojtës, thotë Robert Radoja teksa tregon se periudha e pandemisë nuk ka qenë aspak e lehtë për të.

“Vjet në periudhën e festivalit ishim mbledh në komision 4 orë. Kur u ktheva në shtëpi pashë që nuk isha mirë, bëra testin dhe dola pozitiv mandej u shtrova në spital. Nuk e kalova rëndë, por ishte shumë i gjatë. Ndejta 1 muaj e gjysmë në spital”....

PIANO

E megjithatë loja mbi tastat e bardha i jep ende kënaqësi “Mjeshtrit të Madh”. Edhe pse i ka kaluar të 80-tat ai ka në dorë një projekt shumë të veçantë që e ka mbërthyer pas instrumentit që i kushtoi gjithë jetën... (Pianos)



“Është një kompozitor që quhet Muharrem Gurra, i cili është ndarë nga jeta në vitin 1981 dhe po përgatis të gjitha këngët e tij.

Ai ka realizuar mbi 270 këngë që ja dinë të gjithë dhe janë këngë të karakterit të Shqipërisë së Mesme. Që mos të humbin, jam duke i shkruar për kanto e piano dhe deri tani kam shkruar 65 këngë si “Qan lulja për Lulen”, “Qenke veshur me të bardha”, “Lule të Bukura ka Tirana”, shprehet Radoja.

FESTIVALI

Por si e sheh Radoja muzikën shqiptare sot?!
“Po shihja Sanremon dhe ata e ruajnë ende

tradietën. Italianët kanë një kthim tek kënga e tyre tradicionale që nuk bie ndesh me shijen e kohës, por mos harroni që kanë 600 vjet që kultivojnë muzikë, ndërkohë që pikësynimi ynë është të zbulojmë identitetin”.

Ishte festivali i tretë në Radio Televizionin Publik Shqiptar ai që Radoja do të merrte pjesë për herë të parë duke vazhduar deri në vitin 1989. Në vitin 1968 ai orkestroj këngën e Nikolla Zoraqit “Dhuratë për ditëlindje” që këndohej asokohe nga David Tukiçi.

“Me daljen e instrumentave elektronikë nuk ka më nevojë për piano. Sigurisht muzika me instrumenta të gjalla është më elastike dhe sipas mendimit tim këngën e kanë “dëmtuar” kantautorët. Kur një këngë është bashkëpunim mbledhen në të më shumë emocione, dije etj. Në kohën tonë ka patur disa rregulla që duheshin respektuar. Një njeri nuk mund të merrte më shumë se një ose dy këngë, sidomos pas vitit 1966 dhe kjo ndodhte për larmi, frymëzime e dedikime të ndryshme. Edhe ne që aranzhonim nuk mund të bënim më shumë se dy këngë. Sot këngëtari zgjedh me cilët kompozitorë dhe poetë do të punojë ndërsa më parë ishte i zgjedhur. E vetmja që kishte të drejtë të zgjidhte ishte Vaçe Zela. Ajo ishte absolute më e



“Proçesi i krijimit të një kolone zanore ishte i gjatë, ishte regjisori ai që organizonte gjithçka . Sot ka ndryshuar totalisht ideja, shoh filma turq që kanë muzikë gjatë gjithë kohës, ndërsa ne kemi patur muzikë në pika kyçe të filmit”

mira e kohës”, tregon Robert Radoja ndërsa sot vlerëson artiste si Elina Duni e Eda Zari.

KINEMATOGRAFIA

Por në karrierën e pianistit të njohur rol të rëndësishëm luajnë edhe muzikat e filmave artistikë dhe të animuar. Kompozimi i tij i parë në muzikën filmike do të ishte në vitin 1970 me muzikën e filmit “Guximtarët” e duke vijuar me të tjerë filma.

“Proçesi i krijimit të një kolone zanore ishte i gjatë, ishte regjisor ai që organizonte gjithçka. Sot ka ndryshuar totalisht ideja, shoh filma turq që kanë muzikë gjatë gjithë kohës, ndërsa ne kemi patur muzikë në pika kyçe të filmit”, tregon ai. I pyetur se si ishin marrëdhëniet e tij me kompozitorë si Kujtim Laro, Aleksandër Lalo, Limoz Dizdari, etj, ai shprehet se ishin të shkëlqyera dhe se nuk ndërhyenin aspak tek punët e njëri-tjetrit.

KUJTIMET


Por si arriti Radoja të bëhej një kompozitor i njohur, a ndikoi Shkodra në formimin e tij profesional. Profesor Radoja tregon gjithçka pa doreza dhe na bën pjesë të kujtimeve të tij.

“Mua drejt muzikës më kanë drejtuar prindërit. Në familje kishim një ndikim nga kultura italiane, sepse babai im kishte studiuar në Itali. Kishim një gramafon në shtëpi dhe unë aty e dëgjoja muzikën. Më pëlqente

muzika e Shtrausit. Shqipëria ka patur një elitë të kufizuar edhe pse ishte vend agrar. Rrugët kanë qenë të këqija por im atë shkonte me avion nga Shkodra në Tiranë. Shkodra ka patur aeroport ndërkombëtar. Mësueja ime e parë e pianos quhej Ida Melgushi, por atëherë s’kishte piano dhe unë përdorja një tjetër instrument muzikor siç ishte firzamonika, madje atë të Prenk

Jakovës. Pianon e kam filluar shumë vonë, në lice artistik nuk kam asnjë madje fotografi nga fëmijëria me piano.

Më kujtohet vetëm si vegim pasi kam qenë 4 vjeç kur është bërë opera në Shkodër, dhe sigurisht që ajo më ka tërhequr”, tregon me nostalgji Robert Radoja i cili ishte i vetmi nga



E lidhur me artin ishte dhe bashkëshortja e tij. “Ime shoqe ka qenë shumë e lidhur me muzikën saqë ja transmetoi edhe fëmijëve (Gjergjit dhe Trimit) njëri studioi piano ndërsa tjetri kitarë e violinë.

fëmijët që u mor me art pasi vëllai dhe motra e tij siç ai na rrëfen ishin të apasionuar pas sportit.

E lidhur me artin ishte dhe bashkëshortja e tij. Ndonëse mësuese frengjishteje ajo e kishte pasion muzikën.

“Ajo ka patur një zë shumë të bukur dhe këndonte në festivalin e 11-të me Suzana Qatipin, Dorian Ninin, Alqi Boshnjakun. Këngën e Krajkës “Kafe Flora Burra plot” ka qenë edhe Tatjana aty. Ime shoqe ka qenë shumë e lidhur me muzikën saqë ja transmetoi edhe fëmijëve (Gjergjit dhe Trimit) njëri studioi piano ndërsa tjetri kitarë e violinë.

Me gjithë çmimet dhe artin e pashlyer që i ka lenë dhe (po vazhdon) t’i lërë muzikës shqiptare Robert Radoja si kulmin e karrierës së tij konsideron punën me fëmijët.

“Puna me fëmijët ishte kulmi i karrierës time. Në vitin 1989 zhvillohej spartakiata sportive dhe bëhej edhe një manifestim. Unë përgatita një kor me fëmijë që rezultoi shumë i suksesshëm. Por jo vetëm kaq, puna me fëmijët me ka bërë të ndihem gjithnjë i ri”, tregon Radoja duke mos i patur problem vitet që ikin...

“Viti që lamë pas ka qenë një vit i vështirë, më ka ndryshuar (pak) jo vetëm mua por të gjithë botën. Ka patur më pak lëvizje, më pak marrëdhënie, më pak aktivitet rrjedhimisht. Megjithatë unë kam një miqësi të mirë ku mbledhem me ta dhe luaj në piano”...





PREKJE

GRUAJA HYJNORE

ME NGJYRA SI YJËSI QË VIBRON

Prekje - një fill emocioni. Ajo të thith butësisht duke qëmtuar në thellësitë e skutave të shpirtit, aty ku shpërthejnë afshe ngjyrash, lëvizjesh, ku si lastar hedh shtat një **Palimpsest** i ri ardhur për herë të parë nga Linda Guri



Një prekje e padukshme që mbështjell e pështjellon tiparin e shuar zazor, thënë dhe pa thënë...

E zhveshur nga frika, artistja shfaq sensualitetin, madhëstsinë hyjnore, universin e gruas, qenësinë e saj. Ngjyrat shpërthejnë, emocionojnë, frymëzojnë dhe jetojnë në metalin e ftohtë ku ato serviren, mes pluhurit mbulues, mes elegancës së plastikës, mes pastërtisë së ujit, si kodet që presin syrin t'i çkodojë...

- Unë jam Linda. Eja në eksperimentin tim!

Dua të të marr në botën time transparente, në prekje të shumëdëshiruar. Rilind në tonet e penelit tim. Ofsho! Kthehu enigmë, e butë dhe e fortë, sensuale dhe e frikshme, e sigurt në vallen e ngjyrave mes pluhurit e maskës plastike që të mbulon e të transformon derisa hapesh në metamorfozë shpërthimesh fluturake nën nuancat e brishta të nënvetëdijes.

Artiste e shumëdimensioneve, Linda frymëzohet nga njeriu dhe gjendja e tij, për të sjellë galaktikën në portretin e gruas, për ta shndërruar atë në ndjesi artistike, si antipod i formës materiale, si një dëshirë personale për të shkrirë talentet e saj. Zgjedh gruan, pasi vetëm përmes qënies komplekse mund të përcillen emocione të fuqishme: si një yjësi që vibron. Ajo të fton ta shohësh, të përtypesh, të përhumesh e të zhytesh me të.





për vizitorët që duan të shohin diçka ndryshe, për të parën herë, në Tiranën e zhurmshme.

LINDA: SI E BËRA ËNDRRËN, REALITET

“Mendimi për projektin është pak i gjatë. Pasi mbarova studimet e larta, kisha dashur gjithmonë një ekspozitë. Por nuk gjeja dot kohën. U mora me “make up”, në një trend për “make up artist” dhe u harrova. E lashë ëndrrën në sirtar për disa kohë. Ëndrra ime, gjithmonë ka qenë ekspozita e piktura. Më

pas, ardhja në jetë e Hebas, vajzës sime, mori kohën e saj... Por nuk u harrova. Shpejt e kup-tova që duhet t'i rikthehesha ëndrrës”, thotë autorja për këtë vepër të veçantë.

“Koncepti i ekspozitës nis me figurën e gruas. Unë aty qëndrova pasi mendova se gruaja do më jepte emocionet që unë doja të shprehja në portrete. Kësaj figure i shtova, kolore. Një pikturë e ardhur në një figurë reale. Për ta bërë konceptual artin tim, i shtova elementë jetësorë, uji, plastika dhe pluhuri. Të gjitha i ktheva në një element artistik” tregon Linda Guri.

“Modelja është vetëm një, Nikoli, është e preferuara ime. Dhe unë nuk eksperimentova në portrete të tjera.

Gysi, (fotografi) mendoj se ishte i duhuri për këtë projekt. Pa të, nuk do e sillja dot imazhin që doja. Kur kam shkuar në fillim tek ai për t'i prezantuar projektin, më tha: Linda, unë nuk bëj “Beauty” (qesh). I thashë se nuk është “Beauty”, është art e pikturë. Pastaj e pranoi faktin dhe tha “le ta provojmë”. Dhe u përfshimë në këtë projekt” tregon Linda.

IDEJA DHE REALIZIMI

I gjithë procesi është i ndërtuar mbi një portret real. Grimca zgjimi, vorbull ëndrrash, apo prekje dashurie, këto janë elementët që bëjnë konfuzë dhe vizitorët.

Teknika e përdorur, është një ndërthurje ndërmjet ngjyrave dhe plastikës, pluhurave, dhe ujit.

Janë përdorur këto elementë, pasi nëpërmjet transparencës së tyre mund të ruhen tiparet e portretit, marrëdhënia e ngjyrës që qëndron mbi portret si dhe krijimi i një gjendje dhe emocione të ndryshme shpirtërore tek secila prej tyre. Pra, një pikturë eksperimentale mbi një portret.

Dhe i gjithë ky proces qëndron i fotografuar dhe i printuar në një material metal.



POR ÇFARË ËSHTË KJO EKSPOZITË?

Prekje, takimi i dy gjendjeve; asaj fizike dhe shpirtërore, e cila jetëzohet falë tre elementeve që ndërlidhen më lëkurën e individit. Ky është realizimi i artistes Linda Guri, një ekspozitë ku parashtrohet portreti i një vajze që ndërvepron me ujin, plastikën dhe pluhurin mbulues.

Ekspozita “Prekje”, e shfaqur në sallonin e kryeministrit, është një bashkëpunim mes piktores Linda Guri dhe fotografit Ergys Zhabjaku, me plot 31 fotografi, një punë disa mujore që konkludohet në këtë projekt që synim ka shfaqjen e emocioneve të pastra. Ashtu si Linda pikturon në një telajo, këtë herë krijimin e ka bërë në portretin e qenies njerëzore, duke lejuar ngjyrat që të transmetojnë jetën.

Me ndriçimin e kuq dhe atmosferën e ngrohtë, ekspozita pret njerëz ta vizitojnë, së bashku me një video me një stalacion në një telhajo të zezë metalike, e quajtur Prekje. Fotografitë të japin mesazhe të ndryshme, përmes portretit të gruas.

Duke e zhveshur gruan nga frikërat, dy artistët kanë synuar të shfaqin sensualitetin, madhështinë hyjnore dhe universin e saj. Ngjyrat shpërthejnë mes elegancës së plastikes, pastërtisë së ujit dhe aftësisë mbuluese të pluhurit.

Ekspozita do të vijojë e hapur deri me 28 shkurt



NJË NDESHJE PËR KORNIZË

30 MIJË TIFOZË

QINDRA SPONSOR

MILIONA SY NGA “AIR ALBANIA”



Nga RETIN TOKA

Data shënonte 3 dhjetor i vitit 2020. Koha kishte kaluar pa kuptuar dhe 1 vit më parë, stadiumi “Air Albania” ishte inauguruar me ndeshjen kundër Francës. Në Federatën Shqiptare të Futbollit prisnin me kërshtëri përgjigjen nga UEFA. Ishte e treta herë radhazi që ishte tentuar të fitohej bileta për të organizuar finalen e Conference League. Të gjithë ishin skeptikë, veç presidentit Duka, i cili e dinte mjaft mirë përpjekjen e madhe që kishte bërë FSHF-ja duke lobuar sistematikisht për të marrë të drejtën për organizimin e kësaj ndeshje. Ishte ditë e enjte. Ajo pasdite do ta mbahet mend gjatë nga të gjithë sportdashësit shqiptarë e veçanërisht nga stafi i Federatës Shqiptare të Futbollit. Nga UEFA vjen drita jeshile. Komiteti Ekzekutiv i UEFA-s kishte fiksuar stadiumin “Air Albania”, si impiantin që do të priste finalen e Conference League. Ngjarje historike për vendin tonë që padyshim nuk mund të kalonte pa një falënderim nga presidenti Duka.

“Kjo është një ngjarje e rëndësishme për

futbollin, Tiranën dhe Shqipërinë! Për këtë duhet të ndihemi të gjithë krenarë. Është gjithashtu edhe një dhuratë e çmuar për Shqipërinë dhe shqiptarët, që më në fund mund të gëzojnë pas shumë peripecish të kaluara, që nga tërmeti e deri te pandemia Covid-19 që po përjetojmë. Urojmë që ky lajm t’i hapë rrugën lajmeve të tjera pozitive për shqiptarët. Dua të falënderoj administratën e FSHF-së për plotësimin e qindra formularëve, pyetësorëve dhe dosjeve për aplikimin, duke treguar profesionalizëm, seriozitet dhe përkushtim e duke bindur anëtarët e KE-së. Dëshiroj që t’i falënderoj të gjithë ata që besuan te ne. Por kjo është një ditë e madhe për të gjithë. Dëshiroj që të falënderoj me këtë rast, drejtuesit dhe anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s, për mbështetjen dhe besimin që na dhanë”, shkruhej ndër të tjera në rreshtat e presidentit Duka.

**“PROJECT LEADER”, PRESIDENTI DUKA
“GRADON” KEJDI TOMORRI**

Kejdi Tomorri është prej vitesh pjesë e administratës së Federatës Shqiptare të Futbollit. Pas dritës jeshile nga UEFA për finalen e UECL, presidenti Duka nisi menjëherë nga puna. Edhe pse data që do zhvillohet është 25 maji, kreu i FSHF-së kërkon të jetë gjithmonë një hap para në kohë. Kësisoj vendos që Kejdi Tomorri do të jetë ai që do të drejtojë dhe sistemojë gjithë punën për këtë sfidë



Armand Duka



Kejdi Tomorri

të rëndësishme për Shqipërinë. Zyrtari i FSHF-së është i lumtur dhe këtë s'e fsheh teksa shprehet:

"Roli si project leader duket si diçka shumë e madhe, por nga ana tjetër do realisht shumë punë. Është shumë e vështirë t'i organizosh të gjithë bashkë, t'i bësh të gjithë bashkë për vendim unanim. Megjithatë si çdo tjetër në jetë ka sfidat e veta dhe kënaqësitë e veta".

FINALJA E CONFERENCE LEAGUE, BASHKËPUNIMI QEVERI - FSHF

Është ende një rrugë e gjatë për të mbërritur te dy skuadrat finaliste. Megjithatë në Shqipëri ka nisur puna intensive për organizimin e asaj ndeshje. Federata Shqiptare e Futbollit po bashkëpunon ngushtë me UEFA-n. Gjithashtu qeveria e vendit tonë ka shprehur përkrahjen maksimale dhe këtë e tregon edhe Tomorri, i cili tregon se edhe Bashkia e Tiranës është angazhuar për të dhënë ndihmën e vet për këtë takim:

"Do të shtohet personeli në aeroport pasi "hyrje-daljet" do të jenë në një numër të konsiderueshëm. Po ashtu dhe avionët do duhen të shtohen. Po ashtu edhe Bashkia e Tiranës me transportin publik apo parkingjet që do të jenë të rezervuara gjitha për finalen".

"AIR ALBANIA", 3 MIJË STOLAT E HEQUR DHE NDARJA E BILETAVE PËR KLUBET


Finalja e Conference League ka bërë që dhe kapaciteti i stadiumit "Air Albania" të ndryshojë. Kësisoj, në atë ndeshje nuk do të jenë 22500 tifozë si-kurse është kapaciteti i këtij impianti, por 19500. Një pjesë e ulësve do të hiqen për t'u shndërruar në studio televizive. Gjithashtu edhe disa stola në tribunën qendrore do të hiqen për të shtuar vend për gazetarët duke qenë se kërkesa është mjaft e madhe. Sa i përket mënyrës se si do të ndahet stadiumi për dy klubet finaliste, UEFA ka një marrëveshje që i jep gjysmën e stadiumit. Por, duke qenë se është periudhë COVID-i është caktuar që 40 përqind e kapacitetit t'i takojë klubeve, respektivisht nga 20 përqind. E llogaritur ndryshe, secili klub do të marrë 4 mijë bileta për tifozët e vet. Mbesin 6 mijë bileta të cilat do të jenë të gatshme për t'u blerë në platformën e UEFA-s. Gjithashtu hidhet një llotari ku 85 përqind e tyre i shkon banorëve të vendit organizator. Pra, rreth 5 mijë bileta do të jenë të gatshme për tifozët shqiptar. I gjithë procesi do të jetë në mënyrë transparente pasi llogaritet që kërkesa të jetë 10-fish më e madhe se finalët e tjera.



UEFA
**EUROPA
CONFERENCE
LEAGUE™**

TIRANA

FINAL 2022



25 MAJ 2022

21:00 "AIR ALBANIA STADIUM"

SPONSORAT, MARRËVESHJA ME UEFA-n

Ndryshe nga ndeshjet e tjera finale, ky lloj kompeticioni ka sponsorat e vet. Pra nuk mund të afrohen sponsora të tjerë. Në ndeshjen finale të Conference League do të jenë marka të njohura në tregun botëror si "Hankook", "Biween", "Hieneken" etj. UEFA i jep mundësi atyre të shfrytëzojnë pjesën e jashtme të stadiumit ose disa pjesë të brendshme të cilat nuk ndikojnë në organizimin e ndeshjes për të shfaqur produktet e tyre, reklamat e tyre si dhe për të bërë promocion, PR. Në këtë kompeticion ekskluziviteti është i sponsorave të UEFA-s. I gjithë stadiumi, brenda dhe jashtë do të "brand"-ohet me logot e Conference League.

AKOMODIMI, TRE HOTELET FITUESE

Si në çdo event të tillë madhështor, rëndësi



euro pas portave. Ndërsa më e shtrenjta do të kapë vlerën e 250 eurove ku përfshihet edhe katering-u. Të gjitha biletat do të jenë online në platformën e UEFA-s. Siç e cekëm më lart, 8 mijë të tilla do të ndahen për dy klubet që do të jenë finaliste. Ndërsa pjesa tjetër do të shortohet e do të jetë në mënyrë krejt transparente duke qenë se kërkesa është shumë e madhe. Secili prej të interesuarëve që

blen biletën online, automatikisht lidhet dhe me agjencinë që i mundëson fluturimin drejt Shqipërisë. 19 mijë e 500 tifozë është e garantuar që do të jenë atë ditë në impiant ku dy skuadrat finaliste do të kenë në dispozicion nga 4 mijë bileta secila, ndërsa në Tiranë pritet të mbërrijnë për një ditë të vetme, rreth 30 mijë persona, pasi përveç interesit të tifozerive të skuadrave në mënyrë të drejtëpërdrejtë, një numër të konsiderueshëm vendesh në impiant do të kenë dhe një pjesë e biletave që do të shiten online dhe ku mendohet se do të ketë rreth 2500 persona të tjerë, me pasaportë të Bashkimit Europian, ndërsa dhe vendet e rezervuara për sponsorët zyrtarë në impiant do të jenë mbi 1200.

AEROPORTI DHE TRANSPORTI URBAN, DY PROBLEMET E KONSTATUARA NGA UEFA

UEFA ka vizituar disa herë brenda një periudhë të shkurtër vendin tonë për t'u njohur nga afër me problematikat e mundshme para finales së Conference League. Një grup pune prej 60 vetësh kanë mbikëqyrur detajisht jo vetëm stadiumin "Air Albania", por edhe aeroportin bashkë me transportin urban në kryeqytet. Pikërisht këto të dyja janë parë si problem për shkak të kapacitetit të limituar të tyre. Megjithatë drejtuesit e aeroportit "Nënë Tereza" kanë vendosur që një ditë para dhe në ditën e ndeshjes të bllokojnë thuajse gjitha fluturimet e tjera, në mënyrë që të ketë hapësirë për uljen e avionëve që do të vijnë me tifozë për këto sfida. Paralelisht dhe Bashkia e Tiranës do të vendosë në dispozicion 90 autobusë të posaçëm që do të bëjnë falas transportin e tifozëve nga aeroporti deri në "Fan Zone" apo dhe në stadium.

PARASHIKIMI I FRIKSHËM, 90 MILIONË EURO TË ARDHURA

Finalja e Conference League padyshim do të jetë një vitrinë e jashtëzakonshme për Shqipërinë. Sytë e 60 milionë njerëzve në mbarë globin do të jenë të drejtuar nga Tirana, ku do

Të gjitha biletat do të jenë online në platformën e UEFA-s. 8 mijë bileta do të ndahen për dy klubet që do të jenë finaliste. Ndërsa pjesa tjetër do të shortohet e do të jetë në mënyrë krejt transparente duke qenë se kërkesa është shumë e madhe

e madhe i kushtohet dhe pjesës së akomodimit. Për këtë finale, hotel "Sheraton" dhe hotel "Hilton Garden In" do të presin dy klubet që do të arrijnë në këtë super event madhështor. Në fakt, nuk ka pasur një marrëveshje, por është paracaktuar që në momentin e parë kur Federata Shqiptare e Futbollit ka bërë aplikimin për të organizuar këtë finale. Ka qenë përcaktuar dhe hotel "Plaza", por ka qenë UEFA që e ka ndërruar. Në të do të akomodohen të gjithë zyrtarët e institucionit të futbollit europian. Pra kanë vendosur të lënë për klubet dy hotelet e sipërpërmendura, ndërsa te "Plaza" do të qëndrojnë vetë të gjithë zyrtarët e UEFA-s.

BILETAT, 30 EURO PËR TË QENË NË "AIR ALBANIA"

Interesi është i madh për këtë finale të Conference League që zhvillohet për herë të parë në historinë e futbollit. Po gjithashtu vëmendje të madhe kanë marrë edhe çmimet e biletave. Duke qenë se për shqiptarë do të jenë në dispozicion rreth 5 mijë tifozët, a do mund të përballohen çmimet e tyre për shkak të nivelit të jetesës? Përgjigja është "Po", pasi për të ndjekur këtë sfidë bileta do të kushtojë 30

WWW.ALBSIGINVEST.AL

ALBSIG
PENSION

0%

Tarifë Hyrje/Dalje

Hyrja dhe dalja nga Fondi i Pensionit ALBSIG është **FALAS**.

1,000
Vlera minimale **lekë**

Vlera minimale me të cilën mund të filloni investimin tuaj në Fondin e Pensionit ALBSIG është 1,000 lekë.

100%
Transparencë

Anëtarët pajisen me një **përdorues dhe fjalëkalim**, të cilin mund ta përdorin për të monitoruar online në çdo kohë llogarinë e tyre personale.

MË SKANO



 **ALBSIG
INVEST**

ALEKSANDËR CEFERIN NË TIRANË DHE NJË 'PËRPLASJE' QË U EVITUA SHUMË SHPEJT

"Shqipëria do të presë finalen e Conference League, në datën 25 maj të vitit 2022", ky ishte lajmi që mori jehonë në mbarë botën duke bërë që shumë njerëz të kërkojnë në hartë se ku binte ky shtet. UEFA i besoi për herë të parë vendit tonë organizimin e një kompeticioni të tillë. E pikërisht ky event që është mjaft i rëndësishëm jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për institucionin e futbollit europian, solli në vendin tonë presidentin Aleksandër Ceferin. Zhurma e krijuar para zgjedhjeve për kreun e Federatës Shqiptare të Futbollit detyroi atë të mbikëqyrte nga afër situatën. Siç e parashikon edhe statuti i UEFA-s, politika përjashtohet kategorikisht nga futbollit dhe çdo ndërhyrje e saj sjell pasoja të rënda. Kishte lexuar nëpër media deklaratat të ndryshme të kryebashkiakut Erion Veliaj i cili shprehej: "Zgjedhjet e FSHF-së nuk do të zhvillohen. Në finale dua t'iu ftoj të jemi të bashkuar për të shpartalluar këtë bandë mafioze. Unë erdha në 2002 kur Duka e mori mandatin për herë të parë. Ndërrova 6 punë, më dolën thinjat dhe ky do mandatin e gjashtë. E gjithë FSHF-ja është kthyer në agjenci sigurimsash dhe jo si do luajnë futboll".

Natyrisht që për presidentin Ceferin kjo ishte një deklaratë me peshë që ndikon drejtëpërdrejtë në zgjedhjet e FSHF-së duke kr-



**NEWS
BOMB**
SPORT

të ndjekin nga televizori finalen e Conference League. Në një parashikim të thjeshtë të bërë nga ekspertë të ekonomisë, por edhe nga UEFA rezulton që në kryeqytet të zbarkojnë për këtë ndeshje rreth 30 mijë qytetarë. Sipas analizës së bërë, një person mesatarisht do të shpenzojë rreth 3 mijë euro. Në një llogaritje të thjeshtë rezulton që kryeqyteti të gjenerojë plot 90 milionë euro vetëm në ditën e finales së Conference League. Punë e mrekullueshme nga Federata Shqiptare e Futbollit që lloboi pambarimisht për të marrë këtë finale që në fund të ditës përkthehet në miliarda lekë për vendin tonë.

DY "FAN ZONE", PIKAT E TAKIMIT TË TIFOZËVE

Si në çdo finale, por veçanërisht të kësaj

rëndësie, Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Futbollit kanë vendosur të organizojnë dy "Fan Zone". Këto do të jenë vend-takimi për shumë tifozë që do të duan ta nisin finalen pikërisht nga aty. Ato do të kenë një kapacitet prej afro 4 mijë mbështetës që mund të zgjedhin ta shohin aty supersfidën. Një "Fan Zone" do të ngrihet te "Pedonalja", ndërsa tjetri te diga e "Liqenit Artificial". Këto do jenë një pikë vend-takimi për tifozët, por edhe një mundësi e jashtëzakonshme biznesi, pasi do të kenë një kapacitet prej 4 mijë vetësh.

"PALLATI I KONGRESEVE" ME QIRA, KËRKESA E VEÇANTË E UEFA-S

Për finalen e Conference League, UEFA ka kërkuar nga Federata Shqiptare e Futbollit

ijuar pasiguri dhe për zhvillimin e finales së Conference League. Kësisoj vizita në Shqipëri u bë e domosdoshme. Mbërriti, takoi menjëherë Armand Dukën dhe më vonë kryeministrin Edi Rama që i premtoi se politika nuk do të ndërhynte në futboll. “Tymi i bardhë” doli nga kryeministria dhe këtë e konfirmoi dhe i pari i qeverisë: “Takimi sot me Presidentin e UEFA-s s’mund të ishte dot më i mirë për qëllimin e përbashkët të zhvillimit në Tiranë të finales së parë europiane në histori, si dhe të realizimit të një procesi të besueshëm për të gjitha palët e përfshira në zgjedhjet e reja të FSHF”.

Logjika ishte e thjeshtë. Nëse një vend nuk arrin të garantojë një ambient për zgjedhje të rregullta, si mund të pretendohet zhvillimi i një finaleje të një rëndësie të tillë? Para se të largohej, kreu i UEFA-s dha një mesazh të qartë: “Pata një takim me Kryeministrin Rama, ne ishim të pak të shqetësuar për situatën sipas raportimeve që kemi lexuar në media. Jam i kënaqur që ramë dakord me Kryeministrin, që futbollit duhet të vendosë për futbollin. Pasi kemi lexuar artikujt në media ne ishim pak të shqetësuar për finalen e UECL, por fola me Presidentin e FSHF-së dhe me Kryeministrin, me të cilin ramë dakord se nuk do të ketë ndërhyrje politike në zgjedhje, që futbollit do të vendosë për futbollin dhe kjo është ajo që duam. Nëse gjërat do të jenë kështu dhe unë kam shumë besim në fjalët e Kryeministrit, atëherë zhvillimi i finales së Conference League këtu është i sigurt. Tani do të shohim përpara, sepse është finalja e parë e UEFA Europa Conference League në histori”.

Sakaq presidenti Armand Duka duket i qetë. Ka besim në aftësitë e gjithë atyre që punojnë në institucionin e futbollit në vend se do t’ia dalin më së miri të organizojnë një finale të një rëndësie të tillë. Nuk ka preferuar të flasë për zgjedhjet në krye të Federatës Shqiptare të Futbollit, pasi është i bindur se do të jetë vota mjeti që do të japë verdiktin përfundimtar duke i dhënë fund dhe zhurmës së krijuar. Kohë më parë, kreu i FSHF-së kishte thënë: “Do të kem përballë një komentator (Dritan Shakohoxhën). Unë do të vazhdoj të punoj si ditën e parë”.

akomodimin e 500 personave në ditët para finales dhe dy ditë pas saj. Bëhet fjalë për vullnetarë, për njerëz të stafit të UEFA-s, partners, sponsora dhe për këtë qëllim është biseduar me drejtuesit e Pallatit të Kongreseve ku do të bëhet edhe një marrëveshje. Kësisoj do të jetë në dispozicion të UEFA-s, pra do të merret me qira nga data 15 maj deri në datën 27 maj.

VULLNETARËT, “LUMË” KËRKESASH NË FSHF PËR FINALEN E CONFERENCE LEAGUE

Federata Shqiptare e Futbollit ka vepruar ndryshe për këtë finale të Conference League. Jo vetëm të punësuar, por edhe vullnetarë do të jenë aty për të dhënë kontributin e tyre në mbarëvajtjen e këtij eventi madhështor. Këtë e tregon edhe project leader, Kejdi Tomorri i cili

shprehet se janë surprizuar nga numri i madh i kërkesave. Fillimisht e kishin menduar të vështirë, por tashmë gjithçka është ndryshe: “Në fillim kur lançuam programin e vullnetarëve nuk besuam se do të kishim kaq shumë kërkesa duke qenë se vullnetarizimi shihet si diçka e kohës së komunizmit. Por, çuditërisht kërkesat janë të larta. Pasi të bëhen aplikimet, do të bëhen dhe disa filtrime sepse jo çdo njeri që ka aplikuar mund të marrë pjesë. Realisht kemi qenë shumë të habitur nga kërkesa e madhe e vullnetarëve për të qenë në këtë event”, tregon Tomorri.

UEFA CONFERENCE LEAGUE, AKTUALISHT NË FAZËN “PLAY OFF” TË 1/16-VE

Aktualisht UEFA Conference League ndodhet në fazën e 1/16-ve. Janë 16 skuadra në garë për të mbërritur në finalen e madhe që do të organizohet pikërisht në Tiranë. Ndeshjet e para të këtyre ekipeve u zhvilluan në 17 shkurt. Ndërsa pas katër ditësh do të luhen takimet e kthimit. Ekipet që luftojnë në këtë fazë “Play-Off” janë: PSV, Maçabi Tel Aviv, Midtjylland, PAOK, Marseille, Qarabag, Celtic, Bode Glimt, Fenerbahçe, Slavia e Pragës, Rapid Wien, Vitesse, Leicester, Randers, Sparta Praha, Partizan Beograd. Ndërkohë skuadrat që kanë dalë të parat në grup nuk përballen në këto raund. Ato janë Lask, Gent, Roma, Az Alkmaar, Feynoord, Copenhagen, Rennes dhe Basel. Ndeshjet e 1/8-ve do të luhen në datat 10 dhe 17 mars, ndërsa çerekfinalet në 7 dhe 14 prill. Gjysmëfinalet që do të përcaktojnë më pas dhe finalen e madhe të 25 majit, zhvillohen në datat në 28 prill dhe 5 maj. Të gjitha këto sfida, përfshirë dhe finalen luhen në orën 21:00.

FINALJA E CONFERENCE LEAGUE, KATAPULTIM PËR FUTBOLLIN SHQIPTAR

Zhvillimi i finales së Conference League në Shqipëri i jep tjetër dimension vendit tonë në arenën europiane. Një shtet i vogël, me një ekonomi shumë më të ulët se sa Italia, Gjermania, Franca etj arrin të organizojë një finale të madhe europiane. E ky fakt gëzon dhe “project leader”, njeriun që po punon ditë e natë për të bërë gjithçka si duhet për këtë finale. Për revistën tonë, Kejdi Tomorri shprehet: “Finalja i jep një dimension tjetër vendit tonë në skenën europiane dhe mendoj se do të ndikojë në zhvillimin e futbollit në vend sepse kjo finale, ky organizim do të tregojë se paçka se jemi vend i vogël, paçka se nuk kemi të ardhura si vendet e tjera të mëdha, tregojmë që edhe ne mund të organizojmë një finale. Dhe do ta organizojmë në mënyrën më perfekte. Të paktën në zhvillimin e futbollit në vend mendoj se do të ndikojë, edhe nga ana e infrastrukturës sepse qeveria ose bashkitë besoj se do të sensibilizohen nga kjo gjë dhe do të investojnë më tepër në infrastrukturë”.



SHKURT E SAKTË!

Nga **SUADA DACI**

Jemi zyrtarisht në muajin e dashurisë por edhe muajin më të shkurtër (sa qejf do marrim rrogën shpejt)... Dhe siç po thoja (se kur flasim për paratë e humbasim gjithnjë fillin) shkurti është pikërisht muaji ku mund të eksperimentojmë me veshjet tona.

Nuk ka rëndësi nëse nuk është shumë ngrohtë, fustanet përgjatë këtij muaji mund t'i vishni kur dhe si të doni, fustane sportive, sensuale, "vintage" e si t'ju dojë qejfi juve...

Edhe e dini pse ju them si t'ju dojë qejfi sepse në 2022 nuk ju duhet të sakrifikoni në emër të modës për të qenë sa më ngrohtë dhe stil, pasi trendet e këtij viti janë pikërisht të tilla. Ngrohtë, bukur dhe stil... Sidomos në këtë muaj që i kushtohet modës së pasarelave por edhe streetstyle-it (ku për mendimin tim bëhet moda e vërtetë)...

Më falni por çfarë doni më shumë nga jeta...



FUSTANE ose këmisha ME JAKA

Jakat e mëdha të Harry Styles kanë tashmë momentin e tyre. Fustanet apo këmishat me jaka të mëdha tani mund t'i vishni jo vetëm nëpër evente por edhe në përditshëmri jo më kot edhe Guçi apo të tjera brande botërore i kanë bërë pjesë të koleksioneve të tyre. Në opinionin tim janë ideale për njerëzit që kanë një punë zyre...





BLUE JEAN Baby



FASHION BOMB

Kot ta zgjasim bota do të ishte shumë kot pa xhinse... jo më kot e kanë cilësuar si veshjen e pakohë...



KTHEHU PAS NË SHKOLLË (e kemi fjalën për fundet e kolegjit)

Janë tepër të bukur dhe shumë të kombinueshëm. Të gjatë, treçereksh, të shkurtër, nuk ka rëndësi, me rëndësi është që t'i vishni sepse do të dukeni shumë stil... Aaaa dhe nëse keni ftohtë.. Proveni të vishni dhe geta të trasha do dukeni super stil.



VESSHJET E MALIT

vishi dhe
në qytet

Këtu vjen momenti im i preferuar... Xhupat më të trashë si dhe çizmet më të ngrohta mos ruani vetëm për një udhëtim në Dardhë, Brezovicë apo Kolashin por edhe për në qytet... Me to do të dukeni shumë bukur

Pantallonat

BERMUDA

Këto pantallona do të bëjnë kthimin e tyre më të fuqishëm në 2022. Këto lloj pantallonash fillimisht kanë qenë më shumë të përdorura nga meshkujt, por ato kanë transformuar edhe veshjet e grave. Në 2022 stilistët kanë krijuar stile dhe modele të ndryshme të këtyre pantallonave...



AKSESORËT

janë shumë
të rëndësishëm

Mos anashkaloni kurrë aksesoret tuaj. Ata janë shumë të rëndësishëm. Edhe pse mund të keni një golf gjigand ai do të dukej shumë interesant nëse sipër tij do të vendosim një varëse interesante apo rruaza...



Bëj bashkë **NUANCAT E NJËJTA**

Tonalitet e të njëjtës ngjyre do ta bënin një veshje tuajën tejet interesante. Nëse deri tani nuk keni guxuar, është momenti i duhur për të eksperimentuar me look-un tuaj...



Aa dhe mos harroni **ÇORAPET E BARDHA**

Kanë që gjatë vitit 2020 dhe duket se do të jenë në modë edhe përgjatë 2022. Çorapet e bardha me këpucë duken perfekt, pikërisht në ditët kur nuk ka shi dhe kur nuk doni të vishni çizme apo uggs-a...



MIKSO sportiven me klasiken

Një bluzë sportive të palestrës mund ta bëni bashkë më një fund apo pantallona lëkure. Shoqëruar me këpucët / çizmet e duhura kjo është veshja më fantastike që mund të krijoni këtë periudhë...






© COPYRIGHT

Nga KADRI VOKOPOLA

KINOFJALËKRYQ



HORIZONTALE

2. Ernesto_Guevara.
3. Kanë gjuhë përvëluese.
7. Inicialet e Diderot.
9. Një... e shkruar në dollar.
11. Dino Buzzati.
13. Një gjuhë në Afrikë.
16. Fillojnë ngadalë.
18. Ente Autonome Berat.
21. Bulba i Gogol.
22. Inicialet e Einstein.
23. Kultura pa kura.
24. Gjysmë postim.
26. Aktorja në foto.
32. Kinnear aktor.
35. Aktori në foto.
36. Një hit i famshëm i Los Del Rio.
38. Mbyllin një pistar.
39. Një buall i Tibetit.
40. Inicialet e Bean aktor.
41. Ndërmarrje Urbane Autonome.
42. Është art i të folurit.
45. Qe miku i Orestit.
47. Të fundit në tender.

48. Kufizojnë rastet.

49. Bel i Maupassant.

50. Rinia pa kufij.

52. Nuk bëhet me lepuj.

53. Inicialet e Adjani.

54. Brian i ambient music.

56. Film i Alan Parker.

59. Connery që qe aktor.

61. Oliver regjisor.

62. Emri i Vivaldi-t.

63. Është edhe ajo tjetër e medaljes.

VERTIKALE

1. Salk i vaksinës së poliomielitit.
2. Kështu fillojnë ceremonia.
4. Kështu fillon lidhja.
5. Në fund të pritjes.
6. Gjysmë tatimi.
7. _ es Salaam.
8. Siliqi që qe poet.
10. Mund të shmangë bllokun në voleyboll.
11. Janë të dërguar në kongres.
12. Roy, replikanti te *Blade Runner*.
14. Është lloj komedie.
15. Fise pa fre.

17. Charlie, *The Bird* i saksofonit.

19. Gerard aktor skocez.

20. Wayne që qe aktor.

24. Kanë këngë për kapituj.

25. Është xhakëtë koloniale.

27. Copland që qe kompozitore.

28. Headey aktore britanike.

29. Inicialet e Lennon.

30. Pak narkotike.

31. Kështu thirret Sylvester Stallone.

32. Nuk duhen përsëritur.

33. Purviance që qe aktore.

34. Antoni, që u mbiquajt Arkitekti i Zotit.

37. Michael aktor.

40. Qytet termal belg.

43. Është edhe ai i veprimeve.

44. Opera e Mascagni-t.

46. Banfi aktor komik.

51. Zanicchi këngëtare.

52. _Paulo qytet në Brazil.


53. McKellen aktor.

55. Ndezur në aparaturë.

57. Mbyllin kuvendin.

58. Markë pistolette.

60. Ente Autonome.



MOJ E BUKURA SHQIPËRI!

HORIZONTALE

1. Shkroi *Neveria*.
8. Në krye të betejës.
9. Mund të jenë detare të tilla.
12. Punuar pa zanore.
14. Roja pa çifte.
15. Foto 1.
17. Raymond i *Perry Mason*.
19. Miuccia stiliste.
20. Foto 2.
26. Inicialet e Altman që qe regjisor.
27. British thermal unit.
28. Një rrugë në Paris.
29. Kështu fillon drejtimi.
30. Foto 3.
33. Është djaloshi.
35. Është mosha e të rriturit.
36. Nota e diapazonit.
37. Inicialet e Proust.
39. Në fund të ndeshjes.

40. Aktori që interpretoi Bilbo Baggins.
42. Inicialet e Pasteur.
44. Eli këngëtare.
46. Santa_ në New Mexico.
47. Redding që qe këngëtar.
49. Një toke si Gaza.
50. Elia që qe regjisor.
53. Në fillim të vitit.
54. Gertrude që qe shkrimtare.
56. Lettieri që qe aktor.
57. Mund të jenë barok dhe liberty.
58. Foto 4.

VERTIKALE

1. Simboli i kallajit.
2. Sigla e bankomatit.
3. Qendër kurimi.
4. Është numri 1.
5. Është hapi në parakalim.
6. Ente Ekonomike Përmet.
7. Gide që shkroi *Imoralisti*.
8. Eno i *ambient music*.
9. Qyteti i Kastriotit.
10. Mund të jetë i kondicionuar.
11. Era e ftohtë e Provansës.
12. Kark që qe filozof dhe epistemolog.
13. Amundsen që qe eksplorator.
16. Janë vendet në podium.
17. Është krua.
18. Fund janari.

21. Baggins, Hobbit i *Zoti i unazave*.
22. U shkrua nga Ivan Gonçarov.
23. U shkrua nga Ernesto Sabato.
24. Ente Urbane.
25. Ishin letrat e Shën Palit.
30. Një harresë e përkohshme.
31. Në të del ajo që boie në sy.
32. Lëndë Helmuose Luftarake.
34. Mbarojnë fare.
37. E famshmja Curie.
38. Një djalë mbreti.
41. Një mund të skadojë.
43. Pierre Souvestre.
44. Ashire që kërcente tip tap.
45. Me të nxjerrin tapë.
48. Një lloj njeriu/.
50. Inicialet e Spacey Aktor.
51. Pacino aktor.
52. Unë dhe ti.
54. Ekstremit në sirtar.
55. Në krye të tabelës.





HARD SUDOKU

				6				4
			3			9		2
7		9			2		8	
	4	2						
	1						6	3
6							4	
		8	9					
9		3		8	6	7		
	5				7			

MESATAR SUDOKU

8			6			2		3
	3	5						1
1				2				
6		9	4					
	1					5	2	
		8		6	2	7		
					4	8	7	
9				7		6		
								2

I LEHTË SUDOKU

	8	4				2		
						6	1	
3								
8			7	9				
					4	1		
	9	6	8			4		
			2			3		
		5					6	
7	2		4	8				



KURIOZITETE

PËRSE FUORISTRADA LEGJENDARE AMERIKANE QUHET JEEP?

Kamionçina e famshme e ka origjinën e saj që pas fillimit të luftës së dytë botërore, kur ushtria amerikane e pa të nevojshme të kishte një mjet të tillë të përmasave të vogla, me të katër rrotat aktive dhe që të mund të përdorej gjërësisht në terrene të vështira. Prototipi i parë u prezantua në vitin 1940 nga Bantam Car Company i propozuar si General Purpose (Vehicle) pra mjet për përdorim të përgjithshëm dhe emri Jeep në fakt është pikërisht shqiptimi i inicialeve G. P. (General



Purpose). Por janë të shumtë ata që mendojnë se termi Jeep u huazua edhe nga një personazh i famshëm i ciklit të kartonave me Popeye-n, që quhej pikërisht Eugene dhe Jeep me aftësi për të bërë gjithçka. Aq shumë u impresionuan nga paraqitja e makinës në terren ushtarët, sa filluan të quanin Jeep, duke evokuar pikërisht personazhin e famshëm, që ishte krijuar nga Elzie Crisler Segar që në vitin 1936.

**PSE ORËT E
REKLAMUARA
TREGOJNË
GJITHMONË
ORËN 10 E 10?**

Në fakt në përgjithësi, në orët e reklamuar akrepat janë të pozicionuara në mënyrë të tillë, që të tregojnë pikërisht orën 10 e 10 minuta dhe kjo e ka shpjegimin e vet. Kur bëhet fjalë për publicitetin do të thotë se i bëhet reklamë markës së orës, dhe jo formës apo pamjes së jashtme të saj. Dhe duke qenë se logo që tregon markën e orës zakonisht është vendosur në qendër të fushës, pak më poshtë dymbëdhjetës, vendosja e akrepit të vogël te dhjeta dhe të akrepit të madh te dyshi, pra (dhjetë e dhjetë) është më i përshtatshmi për të nxjerrë në pah markën e orës, gjë që i intereson më shumë prodhuesit që është edhe reklamuesi i markës.



PËRGJIGJET

PËRGJIGJE KINOFJALËKRYQ



PËRGJIGJE MOJ E BUKURA SHQIPËRI!



PËRGJIGJE HARD SUDOKU

2	8	1	7	6	9	3	5	4
5	6	4	3	1	8	9	7	2
7	3	9	5	4	2	6	8	1
3	4	2	6	7	5	1	9	8
8	1	7	2	9	4	5	6	3
6	9	5	8	3	1	2	4	7
1	7	8	9	5	3	4	2	6
9	2	3	4	8	6	7	1	5
4	5	6	1	2	7	8	3	9

PËRGJIGJE MESATAR SUDOKU

8	7	4	6	1	9	2	5	3
2	3	5	7	4	8	9	6	1
1	9	6	3	2	5	4	8	7
6	2	9	4	5	7	3	1	8
4	1	7	9	8	3	5	2	6
3	5	8	1	6	2	7	9	4
5	6	1	2	3	4	8	7	9
9	4	2	8	7	1	6	3	5
7	8	3	5	9	6	1	4	2

PËRGJIGJE I LEHTË SUDOKU

6	8	4	1	3	7	2	9	5
2	7	9	5	4	8	6	1	3
3	5	1	9	6	2	7	4	8
8	4	2	7	9	1	5	3	6
5	3	7	6	2	4	1	8	9
1	9	6	8	5	3	4	2	7
9	6	8	2	1	5	3	7	4
4	1	5	3	7	9	8	6	2
7	2	3	4	8	6	9	5	1

DASHI



Të lindurit e kësaj shenje do të jenë nën ombrellën e një sërë jvshë pozitivë, ku spikasin Marsi e Afërdita të cilët do të ekzaltojnë në maksimum cilësitë tuaja më të mira. Në planin sentimental gjatë kësaj periudhe do të keni mundësi të zbutni ndonjë raport disi të tensionuar me dikë, ndërsa në aspektin profesional pragmatizmi juaj do të sjellë rezultatet e dëshiruara. Edhe në planin fizik parashikimet janë nga më të mirat, por kujdes me dietën.

BINJAKËT



Aftësia juaj për t'u përshtatur situatave gjatë kësaj periudhe do të bëjë që t'ia dilni mbanë me sukses në momente jo shumë të favorshme që pjesërisht vijnë edhe për shkak të një situatë jvore jo shumë pozitive për ju. Në aspektin profesional duhet të tregoheni më shumë konkretë e më pak entuziastë për të evituar hapa të gabuar që mund të rëndojnë ekonominë tuaj. Në planin sentimental mbështja e Jupiterit është domethënëse, por kontrasti i Saturnin mund t'ju bëjë të dyzuar.



LUANI

Janë një numër planetësh që gjatë kësaj periudhe do t'ju vënë në provë, duke filluar nga Urani "i rëndë" e deri te Saturni "i akullt", të cilët do e vështirësojnë aktivitetin tuaj. Megjithatë falë karakterit tuaj të papërkulur, do t'ia dilni mbanë pa ndonjë problem. Në planin sentimental është pikërisht krenaria juaj karakteristike ajo që do t'ju ndihmojë të shuani mosmarrëveshjet me partnerin, ndërsa, me përjashtim të ndonjë nervozizmi të çastit, gëzoni shëndet të mirë.



PESHORJA

Një kuadër jvori i qëndrueshëm bën që të ndjeheni mjaft të sigurtë gjatë gjithë kësaj periudhe me Plutonin dhe Marsin që ju bëjnë autoritarë e shumë luftarakë; dy elementë themelorë për t'iu imponuar kundërshtarëve tuaj. Në planin ekonomik parashikohen zhvillime interesante dhe nëse do të dini të shfrytëzoni situatat e favorshme mund t'i ktheni në suksese domethënëse. Një lidhje e re duket në horizont në planin sentimental, ndërsa shëndeti i mirë.



BRICJAPI

Parashikohet një situatë mjaft e favorshme për ju, pasi do të jeni nën ndikimin pozitiv të katërshes, Uran-Neptun-Jupiter e Dielli. Nëse do të vijoni të mbështeteni në racionalizmin tuaj karakteristik dhe, mbi të gjitha, do të dini të frenoni egoizmin që shfaqet hera-herës mund të arrini rezultate të shkëlqyera. Një periudhë mjaft interesante e pse jo edhe shumë e bukur në planin sentimental, ndërsa probleme të vogla të shëndetit do të jenë kalimtare.



DEMI

Edhe ju që i përkisni kësaj shenje do të keni mbështetjen e disa platenëve, me Mërkurin në krye, i cili bën që kreativiteti juaj të jetë vazhdimish në rritje, ndërsa nga ana tjetër Jupiteri e Saturni stimulojnë dëshirën tuaj për të bërë më të mirën shoqëruar edhe me një ndjenjë protagonizmi, që gjithësesi duhet mbajtur nën kontroll. Do të jeni të pazezistueshëm në dashuri, por edhe të papërmbytur në shpenzime. Ju këshillohet të bëni më shumë aktivitet fizik.



GAFORRIA

Pritet një periudhë mjaft interesante për ju, pasi kuadri jvori është mëse pozitiv për ju, sidomos pas dobësimit të ndikimit të Mërkurit, frenues për iniciativat tuaja. Duket se Dielli do të dominojë në këtë periudhë disi të ftohtë, duke sjellë në shpirtin ngrohtësinë që ju ka munguar në planin sentimental. Do të jeni të favorizuar edhe në planin ekonomik, vetëm se duhet të jeni më sistematikë e më pak konfuzë në zgjedhjet tuaja. Shëndeti mirë, pavarësisht ndonjë problemi të vogël.



VI R G J Ë R E S H A

Për të lindurit e kësaj shenje parashikohet një muaj vërtet i mirë, me një numër planetësh si Marsi, Afërdita e Mërkuri në harmoni, që ndikojnë pozitivisht në shumë aspekte. Megjithatë, duhet të bëni kujdes sepse entuziazmi që shpesh ju përfshin mund t'ju bëjë disi kaotikë (ndoshta edhe për shkak të Neptunit në kontrast me planetën pozitivë). Gjendja mjaft e mirë në planin ekonomik nuk do të thotë që të lëshoni dorën me shpenzime. Mirë dashuria e shëndeti.



AKREPI

Një situatë e paqëndrueshme jvore natyrisht që përkthehet edhe në një periudhë relativisht të gjatë të karakterizuar nga ulje e ngritje të vazhdueshme për ju që i përkisni kësaj shenje. Për fatin tuaj të mirë Merkuri pozitiv në shenjë do t'ju sjellë stimujt e nevojshëm për të gjetur ekuilibret e duhura. Marsi e Afërdita në kontrast me tyre reflektojnë në njëjtin gjë në fushën sentimentale, prandaj grindjet e vockla e pajtimet mund të jenë frekvente. Më shumë kujdes me dietën.



UJORI

Një kuadër jvori jo shumë i favorshëm nuk do të thotë të pranoni ato që ju "rezervon" qielli, prandaj përvishni mëngët e përballini vetë me situatat në të cilat mund të ndodhni. Megjithë ndikimin e tij të zbehtë Mërkuri do të stimulojë fantazinë dhe aftësitë tuaja krijuese. Komunikueshmëria juaj le pak për të dëshiruar duke bërë që të komplikohen artificialisht raportet me partnerin apo familjarët. Një ushqim i ekuilibruar me një dietë normale janë garanci për shëndetin tuaj.

HOROSKOP BOMB

SHKURT 2022

Kuadri jvori ku spikasin Marsi-Afërdita e në mënyrë të veçantë Mërkuri, është tejet pozitiv për ju përgjatë gjithë kësaj periudhe. Ndonjë vështirësi e vogël në planin profesional do të kalojë me lehtësi, ndërkohë që një ofertë joshëse në këtë drejtim mund t'ju tundojë së tepërmi. Marrëdhëniet me partnerin duket se do të përmirësohen ndjeshëm dhe kjo falë gatishmërisë suaj për t'i lënë mënjane mosmarrëveshjet. Formë e mirë psikofizike është një avantazh i madh.




PESHQIT

Pritet një situatë jvore kryesisht e qetë për shumë prej jush që i përkisni kësaj shenje me disa planetë që tranzitojnë në shenjë, por me një ndikim deridiku të kufizuar, ku spikat Mërkuri. Megjithatë në planin ekonomik parashikohet një periudhë rimëkëmbjeje për financat tuaja. Një raport diskret në planin sentimental mund të kthehet në një lidhje të re, por duhet të hiqni dorë nga kurioziteti i tepërt sepse mund t'ju prishë punë. Kujdes me sëmundjet e stinës.



SHIGJETARI



ABONOHU TANI!

REVISTË E PËRMUAJSHME POLITIKO-KULTURORE



ANALIZA
INTERVISTA
INVESTIGIME
KULTURË
SPORT
DOSJET
E KRIMIT
ARGËTIM
POLITIKË

PËR TË BËRË ABONIMIN KONTAKTONI:

POSTA SHQIPTARE:

☎ Cel: **+355 68 50 80 753**

REDAKSIA NEWSBOMB.AL KONTAKT:

☎ Cel: **+355 69 67 32 020**

✉ E-mail: **abonime@newsbomb.al**



newsbomb.al

193 033 FOLLOWERS



newsbomb.al

42.2k FOLLOWERS



NewsbombAl

2,909 FOLLOWERS